

ANDON N. MARA

85H-32

M 32



# BRUSSI ZJARRTÉ

TREGIME

891.983-32

1~132

ANDON N. MARA

S

# BRUMI I ZJARRTË

(Tregime)

~~21885~~

SHTEKA E SHTIELE  
GUROMAST  
2617

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## LETËR QË PËRTEJ DETIT

Sa të hapej udha, — udha e Amerikës — kaq kish hall e Risto Nilos. Pastaj... he! pastaj, nuk do t'ja dinte fare! Hoqi q'hoqi, vojti q'vojti, gjashtë vjet, si jo tjetër njeri në botë, por tani sa të merte një letër... Kaq ish puna. Pas letrës, dhe para do t'i vinnin dhe çdo gjë do të rregullohej. E dinte ajo q'burrë kish. Ai mendonte, atij i digjej zemra pér shtëpinë, prandaj dhe kish marrë atë rrugë të largët e të shkretëtë të mërgimit.

E Ristos do të hiqte qafe edhe fajdexhiun, që nuk i ndahej dita-ditës, gjatë gjithë atyre vjetve. Huān ai nuk ja kish dhënë në tym. Ristoja kish një copë shtëpi, prandaj fajdexhiu e kish mendjen të fjetur. Pastaj, priste që, kur të mbaronte lufta, Ristoja të dërgonte dollarë të hekurosur, se në luftë njerëzia fitojnë shumë. Kështu kisha bërë fjalë me të Ristos.

Dhe kjo priste, priste plot shpresa të mëdha, priste me besim. E po, djalli ta merrte, de! Oj! Mjaft i ish lutur njërit e tjërit, mjaft i ish nxirëjeta e saj dhe e fëmijëve kaq vjet! Tani do ta ngrinte ca kokën edhe ajo, do t'u dilte me sy hapur të tjerëve, do të mblidhte mendjen dhe do të komandonte shtëpinë.

Këto shkonte ndër mend e Ristos, pér këto trete-shin larg ata sytë e saj të zez, të cilët, në bebëz, sikur ndriçoheshin nga një shkëndijë e vogël. Atëhere, ajo shkonte me émbëlsi dy fëmijët, Ndreçin dhe Pandin, dhe u thoshte:

— E, ju bëftë nëna, do të marrim letër nga babai, do të marrim dhe para, e nëna do t'ju veshë e do t'ju mbathë, do t'ju bëjë si pëllumba...

— Po kur do të marrim letër, moj mëmë, kur?..

— e pyeste atë Pandi, i cili sapo i kish mbushur të gjashtat.

— Do të marrim, do të marrim, bir... Ja, mund të na e sjellë postieri nesër...

...Të hapej udha! Kjo kish qenë ëndrra, e vazhdueshme e së Ristos. Kur dëgjonte se puna e Gjermanisë kish marrë erë, ajo gjëzohet dhe mendonte se kish afruar dita aq e pritur.

Dhe ja, një ditë bota buçiti se edhe Hitleri, me gjithë Gjermaninë e tij, kish ngrënë kokën. Luftës i kish ardhur fundi.

Nuk mënoi dhe rruga e Amerikës u hap. Letrat mund të vinin. Të vonuara prej dy a tri muajsh, por, sideqoftë, po vinin.

Të Ristos nuk e mbante vendi. Ajo e kish mendjen te porta. I dukej sikur shpërndarësi do të trokiste nga çasti në çast dhe do t'i thoshte:

— Na, moj e Ristos, letër nga Bostoni, nga Ristoj... Shyqyr që e paske shëndoshë!..

Sa herë hapej porta, sa herë dikush trokiste në të, ajo kujtonte se ish shpërndarësi, prandaj ngríhej me vrrull dhe nxitonte me gjysmë frymë. Herë-herë, edhe kur dëgjonte këmbë në rrugë, asaj i shkonte ndër mend se mund të ish postieri, hapte portën dhe zgjatë kokën jashtë.

Tërë ditën e ditës, hynte e dilte nga dhoma në oborr. Shpërndarësi plak kalonte dhe ajo thërriste:

— E, xha Tilo, më solle ndonjë letër?...

Por, gjer ahore, xha Tiloja kish tundur gjithnjë kokën duke thënë:

— Jo, jo, nuk kam...

— Kështu i ish përgjegjur atë ditë, kështu të djesmen e kështu edhe më parë. Po bëheshin pesë a gjashtë muaj.

Të Ristos zuri ta hajë brenga. Si qëndronte puna? Kaq kohë që ishin hapur udhët e të mos merrte ende një letër nga i shoqi! Mos ishin vonuar letrat, vallë? Apo mos kishin humbur? Se, ku dihet, udhë i thonë!

E kthente këtej, e vërtitte andej, nga të gjitha anët. Por nuk ja gjente dot fillin.

Një ditë i erdhi në shtëpi fajdexhiu, zoti Janaq Kani. Ai trokiti në portë, pastaj hyri në oborr dhe bëri drejt shtëpisë. E Ristos e pa nga dritarja e sobës dhe u ngrit e doli te praku i derës.

Janaq Kani, me një shkop në dorë, çak-çuk, me kokën të përkultur mënjanë, bëri nga ajo. Ai ngriti systë dhe tha:

— C'bën, e Ristos?.. Ku je?..

— C'të bëj, zoti Janaq! Ja, këtu jam... — iu përgjegj ajo, duke e vështruar me kujdes.

Zoti Janaq dukej i plakur shumë. Ai qe kërrusur, dhe sikur mezi mbahej në këmbë. Në trup kish një pallto të vjetër.

C'është e vërteta, ai i kish dhënë së Ristos ca para, dhjetë a njëzet napolona kartë gjithsejt. Po me njëmijë e njëqind bela. Nja dhjetë herë i kish vajtur e Ristos në shtëpi, i kish puthur këmbë e dorë, po ku dëgjonte ai! «E ku janë vaftet për të dhënë borxh tani! Pastaj, se mos kam dhe unë!..», kështu i ish përgjegj sa e sa herë. Mezi i ish mbushur mendja që t'i jephte ato që i dha. Po dhe ato, vetëm si kish vënë e Ristos gishtin në një të shkruar të gjatë. Kush e di ç'thuhej atje. As e kish marrë vesh mirë, megjithëse zoti Janaq kish llomotitur ca fjalë. Ajo kish futur të hollat në gji dhe kish ikur, duke falendëruar dhe uruar njëqind herë.

...Plaku hyri në dhomë, u ul në një karrigë dhe mbështeti të dy duart mbi shkopin e tij. Pastaj, foli:

— Kam ardhur për borxhin, moj e Ristos. Të kam thënë dhe nja dy herë të tjera...

— E di... — ja bëri tjetra. — Po, siç të kam rrëfyer, nuk kam marrë as haber nga Ristoja e jo para... Jam në merak të madh...

— Por mua më duhen para, moj ti! Kur kisha, nuk t'i kurseva; t'i dhashë me grusht dhe ta preva litarin; tani e dua borxhin, ashtu siç kemi bërë fjalën. I kam të shkruara të gjitha, dhe ti ke vënë gishtin.

— Ashtu është, ashtu...

— Hë, de! Prema litarin ti tashti. Jam në të keq. Qeveria e këtyre m'i mori të gjitha, na më bëri në mall e në gjë!... — dhe ai hapi pëllëmbën e dorës së dja-të. Pa më kërkon dhe flori. Ku t'i gjej unë?! Prandaj, më jep ato që më ke, të mbaj shpirtin me bukë.

— Të të jap, po çfarë të të jap, o zoti Janaq! Të thashë...

— Ç'më duhet mua! Unë dua borxhin! Shit plaçkat e shtëpisë dhe kthema!

— E ç'të shes tan! Shikon ç'më ka mbetur?!

E Ristos vështroi rrëth e rrötull dhomës, ku nuk kish veç dy karriga, një tryezë të vjetër e një fletë shkorse prej lecke të tretur. Ajo vazhdoi:

— Gjërat më të mira që kisha, i shita për kafshatën e gojës. Ç'do të më bënин vetëm ato që më dhe zotrore!

Zoti Janaq u ngrit i zemëruar, përpoqi shkopin në dysheme dhe bërtiti:

— Nuk di unë! Të bësh derman e të më lash borxhin. Ndryshe, do të ankohem! Ndonëse këta janë komunistë, atë që më detyrohesh duhet të ma njoin se e kam të shkruar me senet. Dëgjove? borxhin e dua!

Atij iu ngërdhesh fytyra, dhe, nëpër buzët gjysmë të hapura, iu dukën disa dhëmbë të florinjtë.

Pastaj, diç i ra ndër mend, u duk sikur u zbut dhe iu kthye së Ristos:

— A i ke bërë letër tët shoqi?

— I kam bërë...

— E po si, nuk ke marrë përgjigje?

— Di dhe unë?! Më zuri veshi sikur ka ikur nga ai vend...

— Ku ka vajtur?...

— Ku ta di unë?!

Janaq Kani u mendua një copë herë.

— Dëgjo këtu — i tha pastaj gruas.

— Urdhëro...

— T'i bëjmë edhe një letër...

— Po ku t'ja dërgojmë? ..

— Në adresën e parë. Nuk dihet...

— Si të them...

— Kështu do ta bëjmë. A ja ke adresën?

— E kam aty në musandër.

Dhe e Ristos mori që andej një zarf të gjatë mbi të cilin ish shënuar adresa e të shoqit në Amerikë. Janaqi, duke marrë zarfin në dorë, tha:

— Po, po, t'i bëjmë një letër...

— Po kush t'ja shkruajë? Unë nuk di...

— Do t'ja shkruaj vetë, ja, tani!

Ai u ul, nxori nga xhepi i brendshëm i zhaketës një fletë letre, një stilograf dhe u vu të shkruajë. Herë-herë, pyeste të Ristos, por në të shumtën e letrës e shkroi vetë. Në fund, e palosi dhe e futi në xhep, duke thënë se do ta hidhte vetë në postë.

Janaq Kani iku. E Ristos mbeti e kredhur në mendime. Mendime dhe brenga! Nuk po merrte vesh ç'po bëhej i shoqi. Nuk po i vinte asnjë para. Fajdexhiu po i kërkonte borxhin dhe ajo për këtë ndjente një turp, një turp të madh!

Ish tretur dhe ish venitur ata gjashtë muaj si jo tjetër herë. Ndonëse nuk ish më shumë se dyzet vjeç, dukej shumë më e madhe. Fytyra i ish holluar e zgjatur, kockat e mollëzave i kishin dalë, faqet i ishin futur, buza i kish zënë një gjatë të murmë, vetëm sytë e saj, që tani dukeshin më të mëdhenj se dikur, ruanin gjallërinë e mëparshme. Megjithatë dobësi të zbetë, tiparet tregonin se ajo fytyrë kish qenë e bukur e plot freski.

Si iku fajdexhiu, së Ristos i lindi një shpresë, sikur do t'i vinte përgjegjja e letrës që i kish shkruar ai. Nuk ish çudi, ndofta do të kishin humbur rrugës letrat që i dërgonte Ristos dhe ai priste të merrte prej

saj... Po kësaj radhe, çdo gjë mund të shkonte mbarë.

Kjo shpresë sikur i dha fuqi së Ristos. Mbi fytyrë iu duk një dritë. Ajo ktheu sytë nga dy djemtë e saj që po rrin në kënd. Pandin e kish zënë gjumi, të shtrirë në krah. Ndreçi, më i madhi, kish një libër në duar dhe ish dhënë pas leximit të tij.

Së Ristos i gufonte zemra, kur shikonte dy djemtë e saj. Ata po rriteshtin dhe ishin të mbarë, të urtë e të dëgjuar. Sa ja donte zemra t'i shikonte të shëndetshëm, të veshur e të mbathur mirë. Në atë çast, tek i dukej se kësaj radhe do t'i vinin letër e para nga i shoqi, gëzimin më të madh e ndjente përfëmijët e saj.

\* \* \*

Me këtë shpresë ajo rrojti edhe dy-tre muaj të tjerë. Hë të vijë letra sot, hë të vijë nesër, por as këtë radhë nuk doli gjë në shesh.

Ditët po kalonin shpejt e shpejt. Dhe bashkë me ditët, me javët, me muajt, filluan të tretën edhe shpresat e së Ristos, filluan ta mbytnin mendimet përsëri. Me psherëtima binte e ngrihej nga shtrati, pa mbyllur sy tërë natën. Mendja i shkonte në njëmijë të liga. Mallékonte veten, që t'i thahej gjuha e t'i shkurtoheshin ditët, por mendja gjithnjë në një vend i rrihte. As punë i zihej me dorë, as i bënte zemra përgjë tjetër. Bënte c'bënte, vente tek e Thomos, atje në lagje, e cila kish një cupë mësuese dhe një në Boston, në Amerikë. Me të Thomos, donte sikur të qante hallin, sikur të merrte vesh ndonjë lajm prej saj. E pyeste atë në i kish ardhur letër, në shkruante gjë e bija pér Riston. Por as nga e Thomos nuk nxirrte gjë. Letrat e së bijës ishin të rralla, dhe as e kish zënë ndonjë herë Riston në gojë. Largohej nga e Thomos me shpirt më shumë të lënduar.

Mërgimi! Sa i hidhur që është! Mirë kanë thë-

në: bukë e kripë e në vend tënd. U ndanë gratë nga burrat, u ndanë djemtë nga nënët, u ndanë, po dhe nuk u panë më. I hëngri mërgimi! Prisnin lajmin e tyre, por u erdhi mandata.

Tri mandata të tilla erdhën në lagjen e së Ristos: së Kolë Renxos iu vra djali në luftë me Japoninë, Rufkës i vdiq burri nga veremi, Limes i shtypi të shoqin riaqina.

Së Ristos, kur dëgjoi gjithë këto, iu ngjethën mishrash. Bobo! Ç'ish kjo lemeri! Iu bë gjaku ujë. I dukej sikur edhe atë një e keqe e tillë po e priste.

Tani, sa herë trokiste porta, sa herë i therriste njëri, i ngrinte zemra. Kur shikonte fëmijët e saj, kur përcillte djalin e madh për në shkollë, i vinin lotët në sy, i ngjante sikur ata ishin jetimë.

Një natë, u hodh gjer tek e Thomas. Me gjysmë zëri duke mbërthyer duart mbi gjunjët, i hapi zemrën:

— Po ç'është kjo, moj e Thomas?! Kaq kohë, dhe s'kam marrë asnjë fjalë nga burri! E, si thua ti? Nuk do të jetë mirë; më duket xheç do të ketë!..

— Jo, moj budallaçkë — ja priti tjetra. — Ç'janë këto që thua! Mirë, dhe mirë fare do të jetë, po kushti si ngatërrohen letrat...

— S'e di, s'e di, moj e Thomas! Po dëgjo se ç'më ra ndër mend: të më shkruajë Neta një letër, t'ja dërgojmë sat bije në Boston, e ajo të kujdeset e ta shkoqitë punën.

— Pse jo?! Ja, Neta këtu është dhe ta shkruan që tanë.

E Thomas i foli së bijës. Ajo nisi të shkruajë. Të bijën e së Thomas, që ish në Boston, e Ristos e njihte mirë, e kish si motër, si të thuash. Donte, pra, t'i shkruante asaj gjerë e gjatë, t'ja shkruante një e nga një të gjitha plagët e zemrës, sikur të çmallëngjej me një njeri të largët, me një njeri që rronte atje ku ndodhet edhe i shoqi.

I tregoi Netës ç'të shënonëtë në krye e çfarë në

fund. Filloi që nga dita kur ai kish ikur në Amerikë, se që atëhere nisnin brengat e saj. Shpirti dhe ata që e kishin parë me sy, e dinin ç'kish vuajtur. Dy vjetët e parë, nuk kish marrë asnjë pesësh. Pastaj, ai i kish dërguar nga pesëdhjetë dollarë në mot. Ç'të bënte më parë me ata pesëdhjetë dollarë? Pa, si u mbyllën udhët, gjashtë vjet e ca, prapë gjë prej gjëje nuk i kish ardhur nga Amerika. Deshi s'deshi ish shtrënguar të hynte borxh, të shiste plaçkat e shtëpisë, të rronte si mos më keq, të shikonte fëmijët e saj me rrecka në trup. Kish dashur ta nxirrte djalin e madh nga shkolla e ta futte në ndonjë punë, por ai ish i vogël fare dhe nuk bënte për gjë. E ku tregoheshin e ku mbaroheshin hallet e saj! Por ja, tani që shpresonte të shihte një ditë të bardhë, nuk po dinte ku ish e ç'bëhej i shoqi. E lutte dhe e uronte, pra, që t'i shkruante ku ndodhej, a ish mirë me shëndet, pse nuk kish dërguar letër...

Përgjegjen e çupës të së Thomas ajo e priste si ujët e pakët. Ish e pamundur të mos i shkruante. Pra, çdo gjë do të dilte në dritë...

\* \* \*

Një të hënë, aty nga ora dhjetë e mëngjezit, së Ristos i erdhi në shtëpi e Thomas me një plakë tjetër të lagjes. Dy gratë hynë dhe ndenjën në dhomë. E Ristos u gëzua kur i pa, por dhe u çudit se ç'ish ajo e ardhur në atë orë!

U përshëndoshën me njëra-tjetrën. E Thomas dhe plaka tjetër po e shikonin në sy, herë-herë ulnin kokën e nuk nxirrnin zë. Së Ristos i dukej se ato sikur ishin të ndryshuara në fytyrë. Zuri të vështronte herë njëren, herë tjetrën. Prite të flisnin ato.

E Thomas e theu akullin:

— A i bëre punët, moj e Ristos?

— O, ç'e do, dhe ti, sikur na mbeten! Unë s'kam

mend në kokë, gjersa të marr një letër nga Ristoja. Më shkon mendja në të liga...

U hodh plaka:

— Mos u sëkëlldis se do të marrësh vesh... Po, doemos, njerëz jemi e s'na dihet...

— U! qoftë larg. Sikur të më ngjasë ndonjë e keqe, jam për në lumë! — thirri e Ristos.

— Posi! posi!.. — vazhdoi plaka. — Ti ke dy djem si pëllumbë... Ja, për pleqtë do të çajmë kokën!..

— Si kuvendon kështu, moj teto e Ndrios, unë s'e kam ndonjë plak! Pastaj, ç'i ke këto që po më thua? .. Pse kini ardhur në këtë vaft? Mos kini marrë vesh gjë, ë?

— Ja, unë si plakë, të them të bëhesh trime, të mbledhësh djemtë, se Riston e...

«... e ndjeu Perëndia», deshi të thoshte plaka, por nuk arriti dot. E Ristos lëshoi një klithmë të llah-tarshme, sikur i ra njeri me thikë. Ajo i kish kuptuar të gjitha.

Shtëpia filloj të tundej nga vaji dhe kuja. E Ristos ra në gjunj, çthuri leshtrat dhe nisi t'i binte kokës me të dy duart. Dy gratë iu lëshuan ta mbanin, duke i thënë «Mblidh mendjen, moj! mblidh mendjen!», po ku e mbanin dot!

U mbush shtëpia nga gratë fqinje që kishin marrë vesh gjëmën. Ato zunë të rregullonin shtëpinë.

Kuja më e madhe u bë kur u kthyen dy djemtë nga shkolla. Ata hynë në dhomë dhe mbetën të ngirrë kur panë gjithë ata njerëz dhe atë vajtim. E Ristos ja thirri edhe më keq. I hoqi fëmijët pranë saj dhe i pushtoi me krahë. Djali i madh nuk e mbante mend, i vogli as e kish parë fare të atin. Ristoja vajti e la eshtrat në Amerikën e mallëkuar! Nuk i gëzoi fëmijët e tij, nuk u gëzua as vetë. Nga t'ja mbanin tani, si kishin mbetur në të katër udhët? O, kur nuk i kish rënë zjarri asaj së mallëkuare Amerikë që i kish ngrënë të gjithë burrat!

Duke parë e dëgjuar nënën e tyre, dy djemtë ja plasën edhe ata të qarit.

\* \* \*

E Ristos u bë gjysmë njeriu. Ajo nuk e rrëfente dot mynxyrën që i kish rënë në kokë. Vetëm në një gjë i shkonte gjithnjë mendja: si nuk i ish përgjegjur e bija e së Thomos. Piste të mësonte se si dhe kur kish ngjarë e keqja e të shoqit. E vërteta është se e bija i kish shkruar së Thomos për vdekjen e Ristos, por vetëm dy fjalë. Prandaj nuk dihej gjë më shumë.

Letra e dytë nga Bostoni nuk vonoi. Së Ristos ja solli një mbrëmje Neta dhe ja lexi. Për të parën herë, pas vdekjes së të shoqit, e Ristos mbajti lotët, ngri-ti kokën, zbuloi veshët, të cilët ja kish zënë shamia dhe nuk i shpëtoi gjë nga sa thuhej në letër. Ja, se ç'shkruante e bija e së Thomos:

«... A, moj e gjorë! E keqja që të gjeti, nuk ësh-të e pakët. Edhe mua kaq m'u prish gjaku, kur më thanë se Ristoja mbaroi, sa s'ta tregoj dot! Më shumë se e kisha parë këta vjetët e fundit, që ish tretur e kish mbetur kockë e lëkurë. Lëngoi motmot e ca në atë konak, ku rronin pesë-gjashtë veta dhe më dy jave qershori dha shpirt».

Këtu, e Ristos ja plasi vajit. U binte gjunjëve me të dy grushtet dhe buza i dridhej.

Letra, më poshtë, vazhdonte kështu:

«Po ti të bëhesh e fortë se s'ke ç'bën. S'je e para, as e fundit. Ah, sa plagë ka hapur kjo Amerikë e shkretë! Shpérndahen njerëzia si zogjtë e korbit në anën e anës, dhe pandehin se do t'i gërryejnë paratë me lopatë! Po ai që ka ardhur këtu, e di ç'është Amerika. Ú bie bretku burrave në punë, që në pikë të mëngjezit e gjer sa bëhet natë e madhe. Pështyjnë gjak për të nxjerrë bukën e gojës! Kështu është Amerika,

po, po kështu është! Ata që s'e kanë parë, nuk e dinë. Unë do të isha njëmijë herë e lumtur, po të kisha ndenjur aty. Mirëpo kështu e kisha fatin...»

Dhe si mbaroi letra, e Ristos qau e qau, pa i puhuar lotët.

...Kur shkoi Neta, ajo ra në mendime. Fëmijët domin bukë, shtëpia donte njëren e tjetrën; ai kish ardhur e kish kërkuar borxhin... Po zakoni i kësaj vdekjeje që i kish rënë në kokë? E donte puna, e donte shpirti i të vdekurit, e donte nderi që ajo t'ja bënte të gjitha të ndjerit, ta kujtonte e ta nderonte. Zinë duhej ta mbante për tre vjet, ashtu siç kish hie, të mbyllej në shtëpi e të mos shikonte prakun e portës, të bënte të ndarat e të gjitha të tjerat. Po, po! Të gjitha duheshin, nuk mund të turpërohej përpëra botës!

Por si? Me çfarë?!

Së fundi mendoi ta nxirrte djalin e madh nga shkolla e ta fuste në ndonjë punë. Ai diçka do të sillnë shtëpi. Pastaj, mendoi të shesë dhe plaçkat e shtëpisë. Njërsë velenxë, jorganit të nusërisë dhe ca gjërave të pajës do t'u binte në kokë.

\* \* \*

Në të tilla mendime ish ajo, kur, të nesërmen, u hap dera e dhomës dhe hyri brenda një grua e gjatë, e thyer në moshë. E Ristos i hodhi një sy dhe u mblodh pranë në kënd. Gruaja, që erdhi, ish e Mitit, e atij që e kishin vrarë Gjermanët. E ve, me një djalë në Ushtrinë nacionalçlirimtare dhe me një çupë që, siç thoshnin, ish komuniste e punonte në qytet. Kështu kish mbetur e Mitit, por nuk ish mbyllur në shtëpi pas vrasjes së të shoqit. Shumë veta në lagje e kishin mbajtur nëpër gojë, kishin thënë njëren e tjeterën për të, por e Mitit nuk kish dashur t'ja dinte.

— E Mitit foli e para:

S'u ndodha këtu, moj Frosinë, kur erdhi lajmi.

Prej dy javësh kishim dalë nëpër fshatra për konferanca. Të rrrosh vetë me djemtë dhe të mos mërzitesh fare. Të mirat dhe të ligat për njeriun janë. Tani duhet të tregohesh trime dhe t'u bësh ballë të gjithave. Me të qara e me të rrahura nuk fiton gjë. Po s'u bëre e zonja t'i vësh gjoksin shtëpisë, e liga s'ka të sur...

— E Ristos, nëpër lotët, i tha:

— Lermë, moj e Mitit, se mbeta si mos më keq! Plaga ime nuk ka shërim.

— Ç'janë këto fjalë?! Ti ta mbledhësh veten, se sot nuk mbetet njeriu rrugëve si një herë.

— Po si jo?! — vazhdoi e Ristos. Ja, shtëpia do; të ndarët do; zija tre vjet duhet mbajtur... Ku të gjej unë për të gjitha këto?! Nuk kam nga t'ja mbaj!.. Do të nxjerr djalin nga shkolla, do të shes plaçkat e shtëpisë...

— Uuu!.. — ja preu e Mitit. Punë janë këto, moj Frosinë?! Të rrish kaq vjet brenda si qyqe! Mos u bëj e marrë! Pastaj, dhe ca të ndara! Ç'na duhen këto?! Ç'fitim na sjellin?! Prish para kot së koti! I vdekuri me të vdekurit, i gjalli me të gjallët. S'mund t'u heqësh fëmijëve kafshitën nga goja e t'u ndash botës grurë e më the të thashë. Mendje dhe kjo!.. Dhe për djalin të të vijë keq, të mos e nxjerrësh nga shkolla. Esh-të gjynah! Pse ta humbasë shkollën? Ai duhet të mësojë, të bëhet i zoti për vete, për ty dhe për të gjithë. Sot erdhi koha që njerëzit të mësojnë, të bëhen të ditur, të mos mbeten qorra siç kemi mbetur ne, se kësh-tu na e do e mira.

E Ristos u trondit nga këto fjalë. Ajo mbeti e hesh-tur, në mendime... Por, pas pak, pëshpëriti, me vësh-trimin të tretur diku:

— Shtëpia do bukë, moj motër... Dhe zakonet që kemi gjetur, nuk i lemë dot kollaj...

— Pse të mos i lemë dot? — tha tjetra. — Pse, duke ndenjur brenda do ta nderosh burrin?! Jo, jo, moj ti! Na ka gënjer mendja... Secili dhembjen e dashu-

rinë i ka në zemër. Unë e di se ç'më kushtoi dhe ç'plagë m'u hap, kur më vranë Mitin. Por nuk u mbylla në shtëpi. Nuk mund të mbyllesha, jo. Dhe nuk bëra ndonjë turp. Njeriu është i turpëruar dhe i qeshur, kur bën ndonjë të keqe, kur vjedh, kur gënjen, kur shet nderin...

E Ristos përsëri heshti dhe përsëri ra në mendime. Ajo bluante në kokë fjalët e së Mitit.

Pas pak, pyeti:

— Po ç'të bëj, thua ti?

— Unë them të mos heqësh as djalin nga shkolla, të mos shesësh as plaçkat e shtëpisë. S'ke nevojë të arrish gjer këtu, po të përveshësh krahët dhe t'i hysh punës.

— Si?


— Ja, kështu, si punojmë të gjitha ne. Posi! Nuk jemi një e dy. Për gratë sot janë hapur punë kudo; dhe ato që punojnë janë të nderuara. Pse të mos hysh në kooperativën e leshpunueseve? Atje ke plot shoqe. Punën mund ta bësh fare mirë dhe të marrësh shpërbirim që ta mbash shtëpinë si duhet dhe me nder. Punë nuk është turp, apo jo? Përkundrazi, është gjëzim dhe fatbardhësi për ne gratë që sot na përkrahin partia dhe qeveria...

...Atë natë, gjersa u gdhi, së Ristos i zienin në vesh ato që i kish thënë shoqja e saj. Herë i dukej se ajo kishte të drejtë, herë i kthehej mendja. U vërtit e u rrrotullua në shtrat, pa marrë një vendim.

\* \* \*

Kaluan ditë. Kaloi një javë, kaluan dy. E Ristos tani kish tjetër brengë. Të njëjtat gjëra kthente e rrrotullonte ajo në mendje njëmijë herë. Donte të gjente një rrugëdalje.

E Mitit i vinte herë pas here dhe i fliste, i jepte e i merrte që t'ja mbushte mendjen për të hyrë në punë. Ajo i përmendte kaq e kaq gra të lagjes, që kishin



zënë punë në kooperativën e leshpunueseve, që merrnin rrrogë dhe që kishin hedhur tutje të këqiat dhe vuajtjet e një kohe.

Një ditë, e Mitit i erdhi bashkë me të Thomas. E Ristos ndjeu një kënaqësi kur i pa, sikur i priste, sikur ua kish nevojën. Zemra ja donte.

E Mitit ish e çelur si gjithnjë. I buzëqeshi së Ristos dhe tha:

— Hajde, kam ardhur që të më japësh përgjegje. U bënë kaq ditë që po jap e marr me ty. Duhet të të jetë mbushur mendja, medoemos. Hë, mos më rri kështu, po më jep fjalën!.. Ndryshe do të zemërohem...

— Mirë të thotë — ndërhyri dhe e Thomas. — Mbushe mendjen tani. Nuk ke ç'bën tjetër. Ti do t'u bëhesh fëmijëve edhe niënë edhe baba.

— Folë, moj e Thomas, a nuk kam të drejtë?

— Shumë mirë e ke. Edhe unë jam kail të hyj në kooperativë. Veç që jam plakë e s'më bëjnë duart...

E Ristos e kuptonte se këto fjalë i thuheshin me përzemërsi. Si pa dashur, i qeshën sytë dhe tha:

— Më rrofsh, moj e Mitit! Në këto ditë të helmuara, ti m'u ndodhe si motër e shkuar motrës. Nuk do të ta harroj tërë jetën!

E Mitit dhe e Thomas ndenjën ndonjë orë e ca e folën mbarë e prapë me të Ristos.

Si ikën ato, e Ristos e ndjeu veten të zënë ngushtë. A kishin të drejtë ato? Vallë, ashtu ish?

Çfarë duhej të bënte ajo? A duhej të humbiste në mes të katër rrugëve, apo duhej t'i vinte gjoksin shtëpisë? Prej kujt prisnin tani fëmijët? Prej kujt tjetër, veçse prej saj?

... Natë tjetër pa gjumë. E Ristos u dogj në rrobat e shtratit dhe u qullos në djersë. Një lëmsh iu mblohdh në grykë.

Ndaj të għdir, e kaploi pakëz gjumi. Ish lodhur shumë...

Dy të goditura të dorezës së hekurt të portës e zgju-an të Ristos. Ajo hapi sytë dhe mezi u përmend. Nuk

kish fjetur më shumë se dy-tri orë. Por veten e ndjeu të çlodhur.

Doli në oborr. Një fllad i freskët i ledhatoi fytyrën. Syri i zuri ca agulice e ca manushaqe, që kishin çelur. Ishin ditët e para të prillit.

Hapi portën. E Mitit e përshëndeti plot gjallëri.

— Mirë mëngjezi! Si m'u gdhive, moj motër?

Së Ristos i tingëlluan shumë të këndshme këto fjalë. Ajo u përgjegj:

— Mirë. Ti si u gdhive? Eja brenda.

Në dhomë, e Mitit i tha:

Si je sot? Nga fytyra më dukesh mirë...

Tjetra nuk foli. I zuri shoqes së saj dorën dhe ja shtrëngoi fort. Kjo e pa në sy, disi e habitur. E Ristos vazhdonte të heshtte. Por sytë i kish të gjallë e si të lagur.

Pas pak, ja tha:

— Vendosa, moj motër, vendosa...

E Mitit, e gëzuar, ja pat:

— Hë, hair të bëhet...

— Vendosa të hyj në kooperativë...

Tjetra nuk e përbajti dot gëzimin, i hodhi krahët dhe i shtrëngoi supet.

— Të lumtë, të lumtë! Kjo është punë!

— Dua të hyj sa më parë, po, sa më parë! Shtëpia tanë pret vetëm nga unë. A më qasin që nesër?..

— Posi, moj! Ja, u nisa të vete të merrem vesh. Atje ka punë boll... Pastaj, si mos të të qasin ty... Ja, shkova të flas dhe ta mbaroj këtë punë.

E Mitit dukej më e gëzuar se tjetra. E shtrëngoi edhe një herë në krahët e saj, pastaj e puthi në buzë.

— Shpëtove, moj motër, shpëtove! — i tha.

— Duhet, duhet të shpëtojmë, e dashur mitevicë...

Të dy gratë mbetën ashtu të pushtuara dhe gjithë shtëpia dukej e mbushur prej një gëzimi që nuk ish ndjerë kurrë brenda atyre mureve.

## DREJT QAFËS SË MALIT

Pasi hëngrën mëngjezin, partizanët e kompanisë, që kish qëndrimin në pallatin e madh mbi kodrën në jug të Tiranës, kishin ca kohë të lirë. Disa djem e vajza nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, që ishin njo-hur e miqësuar rishtas, u mblodhën në një cep të kop-shtit të gjerë. Ata u sheshuan në lëndinë. Ai mëngjez rëntori ish i freskët, me një qiell të rimtë pa asnje re. Nga maja e Dajtit dielli po e përkëdhelte me rrezet e tij të para kryeqytetin e çliruar prej nja dy ditësh.

Partizanët, disa këmbëkryq, vajzat me këmbët mble-dhur, ndonjëri me pushkën mbi gjunjë, prisnin tregimin e shoqes së tyre, Lenit, një vajzë shtatgjatë, e plotë, flokëverdhë. Sytë e saj, në ngjyrë të qiellit, ishin shumë të ëmbël.

Zëri i vajzës jehoi shtruar e me kumbim:

«Nga shtëpia që kishim në fshat kishin mbetur vetëm gurët; nga plaçkat, hiri i tyre. Si zbritëm nga pylli, babanë e gjetëm të shtrirë në oborr me një plumb në ballë. Katër burra kishin vrarë atë ditë italiane. Shtëpitë i kishin zhuritur të gjitha. Nuk patëm ku as si t'i qanim të vrarët. I varrosëm ashtu, pa qivur.

Një javë e kaluam te një mik në Lisnik, dy orë larg fshatit tonë. Më shumë nuk kishim si qëndronim atje. Duhej t'i bënim derman kokës. Unë isha më e madhja e fëmijëve. Sapo i kisha mbushur të shtatëmbëdhjetat. Pas meje, vinte vëllai, që ish tre vjet më i vo-

gël, pastaj vinin motra dhe vëllai tjetër, njëra nëntë e tjetri shtatë vjeç. Nëna vendosi të zbrisnim në qytet, ku kishim një kushëri. Ajo shpresonte që ne të dyja të gjenim ndonjë punë atje.

Kushëriri ish dhe vetë i këputur, por na mbajti në shtëpinë e tij të vjetër, gjersa të mund të rregullonim ndonjë gjë e të zinim me qira një dhomë. Ish verë, kohë lëmi, dhe mundëm të pajtoheshim për të korrur në tokat e një pronari. Nxorëm bukën e gojës. Punuan edhe në vjeshtë për të mbledhur misrat e për të vjelë pemët. Por punët e bujqësisë mbaruan. Po vinte dimri. Ishim pa plaçka e pa zjarr, vetëm me rrobat e trupit. Si do t'ja bënim?

E shoqja e kushëririt i tha një ditë nënës se avokat Vangjel Maneshi kërkonte një vajzë për shërbysese. Isha eçhe unë në dhomën përdhese, kur ajo ja tha. Nëna ngurroi, nuk donte që unë të veja e të punoja në dyert e botës. Por, në fund, duke menduar gjendjen tonë, pranoi:

— Ç'thua, moj bijë? — m'u drejtua ajo.

— Do të vete, nëno, — iu përgjegja. Duam të hamë, duam të rrojmë, dhe ti s'na e del dot me ndonjë punë që bën poshtë e përpjetë. Pastaj, si do ta ngremë shtëpinë? Ne s'kemi as vatër...

Nëna pshëretiu dhe tha:

— Ashtu është, moj bijë, po unë s'do të të lë të më robtohesh atje, në mes të njerëzve të huaj. Ti je në vaktin tënd. Sa të marrim pak veten, pa duhet të të gjejmë shokun.

Unë ula sytë dhe nuk fola.

Fillova punën në shtëpinë e avokatit. Ky ish i dë-gjuar në tërë qytetin. Merrte përsipër gjyqet më me rëndësi. Kish miqësi dhe marëdhënje me qeveritarët. Nga i ati, që kish qenë pronar e fajdexhi, kish trashëguar një pasuri të madhe. Të ardhurat e tij nga gjyqet, arat, vreshtat dhe dyqanet e lëshuara me qira ishin të shumta. Ish i martuar, kish, veç nënës së gruas, një vajzë pesëmbëdhjetë vjeç dhe një teto.

Të them të drejtën, kur hyra herën e parë në shtëpinë e tij, u mahnita. Ish një ndërtesë madhështore, në mes të një oborri e kopshti të gjatë e të gjerë. Brënda të lozta mendja nga qilimet, mobiljet, pasqyrat e gjithë stolinë e tjera që kish. Ato nuk i kisha parë as në ëndërr.

Më priti shërbyesja një grua moshëthyer. Unë veja si ndihmëse e saj. Ajo më paraqiti te zonjat. E shoqja e avokatit ish një grua e shëmtuar, tërë dhjamë, me një ballë të ngushtë. E éma, një plakë e shkurtër, gungaçë, me një sqep e me ca sy si të kukumjaçkës. Tetoja, që ish e motra e babait të avokatit, një grua e moshuar e pamartuar, ish e gjatë dhe e thatë, me flokë krejt të bardhë, fytyrë bardhoshe, faqe me penjëza të kuqe. Kurse vajza e avokatit ish një trashaluqe me fytyrë të rrumbullaktë si bukë e papjekur.

Ndërsa gjithë ato salltanete më kishin tullavitur, për ato gra, që më priten ftohtë e pa kokëcarje, ndjeva neveri. Para syve të mi hapej një botë tjetër, një jetë, që ndryshonte si nata me ditën nga jeta jonë. Kisha dëgjuar të flisnin për të pasurit; edhe në fshat kishim njerëz me kamje, me toka e bagëti, por ç'po shikoja tanë ish diçka përrallore. Dhe tekxa e shoqja e avokatit po më udhëzonte mbi detyrat që do të kisha, unë po qëndroja e hutuar në mes të dhomës dhe mendjen e kisha gjetkë, te varfëria jonë, te hallet tonë të mëdha.

I hyra punës që ditën e parë. U mora me çdo gjë, me çfarë kish e nuk kish ajo shtëpi e madhe. Shërbyesja e vjetër më shpjegonte, më tregonte njérën e tjetrën, më ndihmonte. Ajo kish vite të tëra që punonte atje, kish parë e njohur shumë gjëra të asaj familjeje të pasur: dinakëritë, fitimet dhe kopracinë e fajdexhitut plak, horllëqet e të birit që kur ish në shkollë e pastaj kur doli avokat, huqet e mërzitshme të plakës, sqimat e tetos, zemërnghushtësinë e gruas, tekat e vajzës së llastuar. Marga, kështu e quanin shërbyesen, ish një grua e pakët, që i kish kaluar të pesëdhjetat. Mbi kokë i kishin rënë një sërë fatkeqësish. I kish vdekur i

shoqi, pastaj, fëmijët njëri pas tjetrit. Kish mbetur pa njeri në botë. Jeta i ish ndrydhur në shtëpinë e avokatit. Banonte në papafingon e saj. Siç duket të zezat që kish hequr ja kishin thërmuar zemrën për jetë dhe ja kishin kyçur gojën. Ajo rrallë fliste. U bindej pa zë urdhërave të zonjave e të zotërisë, dinte dhe i kryente si me sy mbyllur punët e ndryshme. Megjithatë, pasi fillova punën atje, ajo sikur gjeti njeriun që prishte, që ta kish shok e t'i lehtësonte ca brengën e thellë. Herë-herë, më thoshte ndonjë fjalë, më tregonte për njërin e për tjetrin nga të shtëpisë, më zbulonte të kaluarën dhe shpirtin e tyre; më përmendte edhe të zezat e saja. Por të gjitha këto i thoshte shkurtazi, me ndonjë fjalë, me një përgjegje të prerë, me ndonjë rënkim a me një ofshamje. Pastaj, mbyllej përsëri në botën e vet, nuk hapte gojë dhe vazhdonte punët, e nënshtuar ndaj fatit të saj.

Mbresë të veçantë më la edhe avokati. Ai sikur plotësoi vargun e njerëzve me tipare të përbashkëta të asaj familjeje. Erdhi e hyri si një tufan, në kohën e drekës, dhe prishi qetësinë disi të mistershme që kish shtëpia në mungesë të tij. Nga fytyra i përngjiste s'ëmës, kish një pamje prej hutini; kokën e kish tullaç, shtatin mesatar, shpatullat të ngushta, këmbët më të gjata në përpjesëtim me kurmin. I kish kaluar të dyzet vjetët.

— Oh! kjo është çupa jonë! — ja bëri ai posa më vuri re. — Shumë mirë! Shumë mirë! — vazhdoi, duke folur shpejt. — Duket vajzë e zgjuar. Do të të vijë ca vështirë në fillim, — m'u drejtua mua, — por do të mësohesh, do t'ua marrësh anën punëve, kam besim për këtë — përfundoi duke më goditur me pëllëmbë në shpatullë dhe shkoi e u ul në kolltukun e tij pranë vatrës.

Nuk më pëlqeu fare ky njeri; e përbuza dhe u pendova që kisha hyrë në këtë shtëpi. Por nuk hoqa dorë se kisha në sy nevojat e shumta të familjes sonë.

Netët e para fjeta në shtëpinë tonë, te kushërirri.

Por, pastaj, punët e ndryshme në mbrëmje ose në mëngjëz, për të cilat duhej të ngrihesha herët bashkë me Margën, nga ana tjetër, ndalimqarkullimi, që fillonte shpejt, më detyruan që disa herë në javë të flija në shtëpinë e zotërisë. Vendin e fjetjes e kisha në papafingon e Margës. Kjo flinte në një krevat prej dërrase, unë shtroja ca vjetërsira përdhe. Para se të na zinte gjumi, kuvendonim për punët që kishim, dhe, herë-herë, Marga hapte zemrën e më tregonte diçka nga ato që ruante në thellësitë e shpirtit të saj.

Pas nja dy muajsh, me ndonjë lek që mblođha unë dhe me ndonjë kursim të nënës, blemë ca plaçkurli na e ndonjë orendi, xheç na dha dhe kushërirri, prandaj vendosëm të gjenim një dhomë, të strehoheshim atje e t'i hiqeshim qafe kushëririt, që na kish mbajtur kaq muaj. Zumë me qira të ulët një dhomë karakatinë dhe futëm kokën atje. Na u duk sikur fituam ndonjë gjë të madhe.

Nënës i rrihte mendja gjithnjë tek unë dhe më thoshte:

— Ta kam merakun, moj bijë. Shpirti ma di përkëtë të flamosur punë ku vajte hyre... Sa të të dalë kësметi... Kur do të vijë ajo ditë!..

Unë mundohesha ta qetësoja, ndonëse edhe mua, më shumë se asaj, nuk më mbante vendi në shtëpinë e avokatit.

— Mos e prish gjakun, nënë, — i thoshja unë. — Nuk jam keq. Punët nuk më lodhin. Margën e kam. Është grua që s'ja gjen shoqen.

— E di, moj bijë, e di... — tundte kokën nëna dhe nxirrte një psherëtimë të thellë. Pastaj më thoshte se duhej të futej në punë edhe Nasi, vëllai i madh.

Në qytet, zura miqësi me disa vajza. I njoha ato pak kohë pas ardhjes ose, më mirë, ishin ato që m'u afrouan; veçanërisht njëra m'u bë si motër. Ato rrinin me mua, bisedonin, më qanin hallin, më flisnin përluftën, për grushtet që hanin gjermanët nga Ushtria e Kuqe. Pastaj më morën në një mbledhje të rinisë; Unë

u kisha treguar se edhe në fshat pata marrë pjesë në mbledhje, u kisha folur edhe për partizanët, që vinin në fshatin tonë, që mblidhnin popullin e i mbanin konferenca. Shoqet bëheshin kureshtare dhe më pyesnin shumë për partizanët se nuk kishin parë.

Kur hyra në punë në shtëpinë e avokatit, më posítën të kisha mendjen, të vëzgoja ç'bëhej atje, me cilët jepte e merrte ai, mbasi dihej që kish të bënte me gjermanët.

Kështu ish. Ai kish kryer studimet në Gjermani. Marga më kish treguar se me italianët nuk kish pasur shumë miqësi. Ish njohur me oficerë e zyrtarë të ndryshëm, por në shtëpi nuk para i vinin. Bënte fitime me anën e tyre, mirëpo nuk ja kish fortëndë të rrinte me ta. Kurse për gjermanët vdiste. Java shtatë, ata tetë do t'i vinin në shtëpi e do t'ja shtronin. Avokati, grave të shtëpisë, ndonëse ato nuk merrnin erë nga gjëra të tillë, si edhe miqve të tjerë me të cilët mblidhej kohë më kohë, u thoshte me mburrje kryeneçi: «Hitleri ka lindur për të shpëtuar botën! Fitorja përfundimtare do të jetë e Gjermanisë naziste! Komunizmi do të zhdukjet nga faqja e dheut!»

Një natë, siç kish hedhur disa kupa dhe ish bërë çakérqejf, tek po shpija gjellën në tryezën, ku ish shtruar me miqtë e tij, duke më lëshuar në fytyrë një afsh rokie, më tha:

— A nuk është e vërtetë se Hitleri do ta pushtojë tërë botën?

Unë nuk i fola dhe u mbusha tërë mllef.

— Folë, e dashur froinlain,<sup>1)</sup> folë! — vazhdoi dhe përfundoi: — Ti je fshatare dhe nuk di nga këto punë; por do ta shikosh se ai do të bëhet fyhreri i gjithë botës!

Më erdhi t'i hidhja pjatën në kokë dhe të ikja. U largova nga dhoma dhe nuk hyra më atë natë.

Në një mbledhje të organizatës së rinisë, u fol mbi shtimin e radhëve partizane. Pas kapitullimit të

---

1) Gjermanisht: zonjushe.

Italisë fashiste, më shumë të rinj e të reja po hidhesin nga qyteti në mal. Në mbledhjen tonë, dolën vullnetarë dy djem e një vajzë. Kjo ish shoqja ime e ngushtë. Me krijimin e brigadës së katërt, hyri në radhët e saj dhe u vra gjatë operacionit të parë.

Në atë mbedhje nuk vendosa dot të jepja fjalën. Megjithatë, gjatë ditëve që pasuan, duke kryer pa zemër e me urrejtje punët në shtëpinë e avokatit, mendja më fluturonte tek ata, që ishin bashkuar me partizanët, te luftëtarët, që na vinin në fshat, te lajmët që mësonin mbi fitoret e tyre. Marga më vështronë të ndryshuar dhe më thoshte:

— Çfarë ke, moj çupë? Sikur nuk të shikoj mirë. Ke ndonjë hall?

— Jo, moj Margë, — ja ktheja unë. — Më mërziten këto grinjaret e shpirtkatrancët dhe ai turibufi, që nuk durohet.

— Ke të drejtë, moj çupë, — vazhdonte Marga — ke të drejtë. Je e re, dhe këta tani janë tèrbuar më keq.

Plaka gungaçe kërkonte t'i shpija herë këtë, herë atë. Orë e çast, do të më thërriste e do të më udhëzonte. Duhej t'i shpija edhe poçen, se nuk i mbahej ujët. Tetoja, nuk ish e kënaqur nga asgjë, donte të gjente qime në të bardhën e vezës. «Këtë nuk e ke fshirë mirë; atë nuk e ke vënë në vend; derën e përpogoje shumë kur dole jashtë», e plot gjermëre të tilla do të dëgjoje prej saj tërë ditën. Avazin ja mbante edhe e shoqja e avokatit, e cila mundohej të paraqitej e zgjuar dhe e ditur, por ish një budallaqe me gjithë rroba. Ajo i kish sjellë atij njëmijë flori, prandaj ai e kish marrë.

Një ditë, e bija e llastuar e avokatit, që donte përherë t'ja shpija unë rrobat e këpucët pér t'u veshur, duke marrë fustanin nga dora ime, ja bëri:

— U! ma paske ndohtur, moj korbë!

— Çfarë të kam ndohtur?! — u habita unë.

— Fustanin! E shikon këtë? Të plaçin sytë! — dhe më tregoi një njollë të vogël në një kind.

— Jo, nuk ta kam ndohtur unë — i thashë. — Sa-

po e mora nga dhoma matanë dhe po ta jap. Nuk kisha ku ta ndohtja.

— Ti ma ke ndohtur, ti, shtrigë! — nisi të klithë e të përpjekë këmbët. Pastaj thirri të ëmën: Mama! mama! ma prishi fustanin e ri kjo kolera!

E éma, duke dëgjuar klithmat e së bijës, rendi e çakarrosur.

— Ç'ke, moj bijë, ç'ke? — pyeti e llahtarisor, sikur të kish ndodhur ndonjë e keqe e madhe.

— Ja, shiko si ma ka bërë, shikoo! — ulëriti e bija, duke qarë.

— Të rëntë pika, të rëntë! — m'u drejtua tjetra.

— Mos u rrëmbe — i thashë. — S'kam ndonjë faj.

— Ke, pos! — Çupa nuk ma kish fustanin kështu.

Ja ke fëlliqur fustanin që ja bleva kaq para! T'u shoftë pisha!

— Zonjë, vajzës nuk ja vë fort veshin për fjalët e rënda që më thotë, se aq ja pret mendja. Por ty nuk të ka hie të përdorësh sharje e mallëkime. Dhe sidomos kur nuk kam bërë asgjë të keqe.

— Mbylle gojën, urupkë! — më kërcëlliti dhëmbët.

Në këtë kohë, erdhi avokati. Duke dëgjuar thirrjet, edhe ai e humbi mendjen. E shoqja i tregoi ç'kish ndodhur dhe ma ngarkoi mua fajin.

— Nuk e njollosa unë — i thashë. — Pastaj, nuk është dhe ndonjë gjë që s'ndreqet. Një pikë është; mund të pastrohet lehtë.

Atij nga inati i dridhej maja e hundës së kthyer. Më shfryu:

— Ik! Dhe të hapësh sytë mirë! Nuk dua të bësh dëme dhe të sjellësh shqetësimë në shtëpinë time! Dil jashtë!

U trondita shumë. Vrapova në papafingo, u ula mbi shtratin e Margës dhe qava me hidhërim. Ajo erdhi, më gjeti ashtu dhe u shqetësua. I tregova ato që më kishin punuar. Mbeti e pikëlluar e shkreta dhe më tha:



Drejt qafës së malit

— I kam hequr edhe unë këto, moj shpirt! I kam hequr! As që numërohen dot të mijat, se unë erdha qilimi këtu dhe po e ngrys jetën... Ajo heshti dhe fshiu një lot me pëllëmbën e dorës.

Ajtë natë, nuk më zuri gjumi. Kisha rënë në kurri, me sytë drejt tavanit, por në dhomën pus të errët nuk shquaja gjë; vetëm dëgjoja frymëmarrjen e rëndë të Margës; mendoja ngjarjen e ditës; zieja përbrenda nga zemërimi. M'u forcua bindja se kisha të bëja me njerëz shpirtligj, se të tillë ishin gjithë ata të sërës së tyre, tregëtarët kamës e nëpunësit pasanikë.

Më shkoi ndërmend të ikja nga ajo shtëpi, të ikja sa më parë. Nuk mund t'i duroja dot. Jo vetëm sjellja, por edhe pamja e tyre më mundonte. Mirëpo ku të veja? ku? «Në mal!» Këtë gjë vendosa të bëj, këtë rrugëdalje gjeta vetëm. Jeta në qytet ish shumë e turbullt, e mbështjellë me një tym mbytës. Edhe sikur të ikja nga avokati, kushedi prapë ç'mund të ndodhë, si mund të vinte puna, si mund të ngatërrohej çështja me nënën, dhe përsëri mund të mbaroja në dëren e ndonjë pasaniku tjetër a ta lidhja fatin me ndonjë, me të cilin nëna ëndërronte të më martonte. Jo, jo! Unë duhej të shkoja në mal, te partizanët, siç kishin shkuar dy djemtë dhe ajo vajza e organizatës sonë. Ata kishin shpëtuar nga halle si këto të miat. Atje ata nuk kishin njeri mbi krye, nuk u shfrynte dhe nuk i cfilite njeri. C'gjë e madhe! Nuk kish si bëhej ndryshe. Si mund të ëndërrrohej kjo gjendje e padurueshme? C'duhej të bënim që të ishim të lirë e zotër, të mos kishim gjermanët dhe avokatët me shokë, nga të cilët hiqnim të zitë e ullirit? Ne duhej të ngriheshim e t'i shtronim nën këmbët tonë ata; duhej të luftonim! Po! të luftonim! Tjetër rrugë nuk kish.

Reeth këtyre u vërtitetën mendimet e mia tërë atë natë. Thua jse ndaj të gdhirë më rrëmbeu pak gjumi. Por, të nesërmen, nuk munda të veproja ashtu si kisha gjykuar natën. Edhe për disa kohë vazhdova të punoja në shtëpinë e avokatit.

\* \* \*

Për vitin e ri u preqatit një festë e madhe. Prej disa ditësh më parë, nisëm punët; e kthyem shtëpinë së prapthi në të gjitha anët, gatuamë embëlsira, stolisëm pemën e festës. Tetoja buzëpërdredhur na rrinte më këmbë, na urdhëronte e na hiqte vërejtjen. Trashaluqja e avokatit, si kopan pa bisht, vinte vërdallë, sikur xheç dinte e donte të jepte mendje si duhej të bëhej njëra e tjetra. Plaka kurriżdalë na hante shpirtin, nga ana tjetër, me kérkesat e saja të mérzitshme, kurse vajza nuk na linte të qeta me sorollatjet nëpër shtëpi dhe me tekat e saj.

Më 31 dhjetor, shtëpia ndritte nga pastërtia; ndërsa në mbrëmje llamburiti nga dritat. Avokati pati shumë miq për festë. Pesë ishin oficerë gjermanë, njërin prej të cilëve, me një qelq në syrin e djathë, e thërrisin «Her major»<sup>1)</sup>. Të tjerët ishin burra e gra nga qeveritarët vendas, ballistë e tregëtarë. Çfarë nuk bënë atë natë! Filluan nga muhabetet dhe të qeshurat, nga lojërat me letra, nga këngët gjermanishtë e italishtë; ç'nuk hëngrën e ç'nuk pinë, kërcyen, pastaj u tërbuan, filluan të klithin e të shajnë me fjalë të ndyra. U bë një gjë aq e pështirë, sa nuk i shikoja dot. «Kur do të mbarojë kjo lemeri?», thosha me vete, «kur do ta thyejnë qafën?»

Në mesnatë, u fikën dritat. Errësira në dhomë mbajti një copë herë. Gjatë kësaj kohe, gratë zunë të thërrisin, disa të gajaseshin nga të qeshurit, të tjerat të vinin kujën. Siç dukej, burrat e tyre apo dhe të tjerët që kishin pranë, i trazonin, i puthnin, i pickonin. Diçka e tillë ndodhë, se u bë një trazirë rrëth tryezës dhe nëpër qoshet e dhomës, ku ishin ulur disa. Kur u shojtën dritat, unë u ndodha pranë tryezës, mbasi sapo kisha shpënë embëlsirat. Tek po matesha për t'u larguar, në errësirë, dikush më zuri për dore dhe më tërhoqi ndaj vetes. Ish një nga gjermanët, se xheç po llomotiste në gjuhën e tij, qeshte dhe mundohej të më

---

1) Gjerm: Zoti major

përqafonte. U bëra zjarr nga mëria që më pushtoi. Mundohesha të ikja, mirépo ai ma kish shtrënguar dorën si me darë. Desha të thërrisja, por më erdhi turp, zëri më ngeci në fyt. Me shumë vështirësi iu shkëputa dhe dola jashtë, para se dritat të ndizeshin përsëri. Në kuzhinë gjeta Margën dhe i tregova ç'më kish ndodhur. I thashë se nuk mund të hyja më në atë dhomë. U ngjita në papafingo. Atyre u shërbeu vetëm Marga gjersa shkuan aty nga ora tre, se, veç gjermanëve, edhe të tjerët kishin leje qarkullimi.

Me t'u zbardhur dita, ika nga shtëpia e avokatit. Margës i thashë se do të qëndroja përfestë në familjen time dhe se nuk ndjehesha mirë. Por kisha marrë një vendim.

Nëna e kuptoi shqetësimin tim, më pyeti, ngulmoi, por nuk i tregova gjë. I thashë se isha e lodhur, diçka e pamundur, dhe se më kishin dhënë dy ditë lejë me rastin e festës së vitit të ri. Kjo e gjëzoi atë, gjëzoi motrën e vëllezërit, mbasi kishin ditë që nuk më kishin parë.

Përpara dreke, u takova me përgjegjësin e organizatës së rinisë, i thashë ndodhitë e fundit në shtëpinë e avokatit dhe vendimin tim se do të dilja partizane. Ai e priti me kënaqësi këtë dhe më kallëzoi se dhe një shok i organizatës sonë, Ymer e quanin, kish shfaqur vullnetin përfundit të shkuar te partizanët. Kjo më pëlqeu. Kisha, pra, një shok, do të shkonim bashkë. Ramë në marrëveshje të niseshim të pasnesërmen.

Gjatë dy ditëve, preqatita diçka që do të niè duhej përrugë dhe për jetën e re në mal. Bleva një palë qillota. Shokët më gjetën një palë këpucë me qafa. Të gjitha gjérat i grumbullova në shtëpinë e një shoqejë.

Erdhi dita e nisjes. Ndjehesha e mallëngjyer. Ndônëse nuk kisha shumë kohë që kisha zbritur nga fshati, më dukej sikur do të shkoja në një vend krejt tjetër, në njerëz të ndryshëm, që më tërhiqnin dhe që ishin jo të zakonshëm. Ish një botë e veçantë, që po-

më priste, një jetë, që ndryshonte si nata me ditën nga ajo e qytetit. Ndjeja, gjithashtu, mallëngjimin e ndarjes nga njerëzit e mi. Por nuk e bëja veten. Mundohesha të dukeshë e qetë, sikur asgjë nuk po ndodhë tek unë. Natën e fundit në shtëpi, fjeta midis motrës dhe vëllezërve, të cilët i përqafova dhe i ledhatova. Të nesërmen, u ngrita herët. I putha të gjithë dhe ika gjoga pér në shtëpinë e avokatit. Vajta në shtëpinë e shoqes, ku më priste Ymeri. Atje mora plaçkat, u përshëndeta me përgjegjësin e organizatës dhe me shoqen, i lashë kësaj një copë letër që t'ja jepte nënës të nesërmen, dhe u nisëm pér të dalë nga qyteti nëpër një shteg të parrahur.

Do të shkonim të paraqiteshim në komandën partizane të qarkut. Ajo ish në një fshat katër orë e ca larg qytetit, në Lundrajë. Do të kapërxenim dy sërë kodrash, do të dilnim në një qafë mali, pastaj do të bënim poshtë drejt fshatit.

## 2

Dita e tre janarit ish e ftohtë dhe e mugët. Në fushë dëbora, që kish rënë ditë më parë, ish tretur; vëtëm aty-këtu, në faqen e kthyer nga veriu, përrrenjve, ruheshin mbeturina të saj. Tutje, kryet e kodrave dhe të maleve matanë zbardhnin. Qielli ish i mbuluar me re të murme, që lëviznin poshtë e përpjetë dhe uleshin ca nga ca.

E nisëm rrugën me hapa të mëdha. Unë e njihja vendin. Udhëhiqja, pra, shokun tim, i cili ish qytetar dhe rrallë kish shkuar në ndonjë nga fshatrat e përhapura faqe kodrave të afërta, me ato shtëpi, që duke-shin si dhen të bardha. Unë i tregoja viset prej nga kalonim, i shpjegoja vendin, ku do venim, i thosha sa orë na mbeteshin, se ai, herë pas here, pyeste pér kë-të. Flisnim, gjithashtu, pér luftën, pér partizanët, vrisnim mendjen se në cilin batalion a brigadë do të na caktonin, a do të ishim bashkë, a do të takoheshim me

shokët e shoqet që ishin hedhur më parë se ne në mal. pastaj, vazhdonim një copë herë rrugën pa folur, unë përpara, ai pas, të kredhur në mendimet tonë. Ku nuk më bridhte mendja! Te nëna, motra e vëllezërit, te Marga, te avokati dhe te të tjerët, tejeta drejt së cilës po shkoja, te ditët, që do të vinin, te dëshirat e mia, që besoja se do të plotësoheshin një ditë. Kjo më rrëmbente tërësisht mendjen dhe shpirtin. Unë kisha dalë me një èndërr të dashur në zemër, me një qëllim të madh në kokë. Veja të bashkohesha me ata, që domin të mos mbetej në Shqipëri këmbë fashisti, këmbë nga ata, që shtypnin njerëzit, si avokati me shokë.

Pjesa e parë e rrugës kaloi mirë. Nuk vumë re gjë-kundi ushtarë gjermanë apo laro të Ballit. Ndonëse këmbët na futeshin në baltë, e pëershkuam fushën dhe vargun e parë të kodrave pa lodhje të madhe. I kishim hyrë një gryke midis kodrave të dyta që kishin mbajtur dëborë. Këtu, më të djathëtë të një përroi të thellë, ish një fshat. Kaluam nëpër të. Fshati dukej i qetë, i përgjumur. Në të dalë të tij, u ndodhëm përballë dy fshatarëve.

— Për ku udhë e mbarë? — na pyeti njëri me mustaqe të trasha e me takie të zezë në kokë.

— Ja, gjer në Vidhas — i thashë unë enkas për një fshat, që ndodhej ndonjë orë më tutje.

— Ç'kemi andej nga qyteti? — pyeti përsëri fshatari, që mori me mend se andej duhej të vinim.

— Ç'të kemi! Hallet e zakonshme — i thashë.

Mos patë gjë ushtri gjermane?

— Jo. Pse?

— Thonë se kanë zënë të lëvizin këtyre anëve. Nga ne s'kanë ardhur, por kemi marrë vesh se kanë dalë atij krahu të sipërm, andej nga Çuka e Kuqe. Fshatarët tanë janë trembur e një pjesë i hoqi fëmijët.

— Ne s'pamë ndonjë lëvizje — foli Ymeri. — Ndofta ashtu mund të jetë.

— Kini mendjen — na këshilloi fshatari. — Mos ju dalin rrugës...

— Mendojmë të hidhemi në këtë krah, të kapërcej-më pérroin — i thashë unë.

— Nuk është kollaj. Është i thellë dhe ka mjaft ujë — u përgjigj fshatari dhe më vështroi me mosbesim.

— Do të shikojmë të gjejmë ndonjë va...

Kështu i thashë, por rrugën nuk e kishim pér an-dej. Ne duhej të shkonim drejt, të kalonim edhe këto kodra pér të dalë në qafën e malit.

I pëershëndetëm fshatarët dhe u larguam. Rruga po vështirësohej më shumë; sa vente ngushtohej e kthehej në një dhiare me gurë, gropë e dëllinja. Dëbora, që kish mbuluar çdo gjë, na fshihte nën shtresën e saj edhe atë shteg të vetëm. Pra, duhej ta gjeja rrugën nga sa më binte ndër mend, nga ndonjë shenjë e rra-llë, që mund të më ndihmonte.

— Ymer, këtej do ta kemi pak vështirë — i thashë shokut tim.

— Udhëhiq e mos ma ki hallin mua-u përgjegj ai që kuptoi se e kisha fjalen pér të, që nuk ish mësuar në këso rrugësh dhe në një kohë të tillë.

Nuk kishim nge as pér fjalë, as pér t'u kotur; du-hej të ecnim sa më shpejt, me hap të vendosur, pér të arritur sa më parë në vend, pér t'iu shmangur ndonjë keqësimi të mëtejshëm të motit dhe pér të mos u takuar me gjermanët, se mund të ish ashtu si na kish thënë fshatari, që ata kishin dalë në Çukën e Kuqe.

Dëbora na pengonte pér të nxituar; ajo na arrin-te gjer përmbi noçkat e këmbëve dhe ndjeja se po më hynte në këpucë. E ftohta po shtohej. Në trup isha nxehur, madje isha pak e dërsirë, por fytyrën ma fshiku-llonte thëllimi. Kisha frikë se do të ngatërhoja udhën. Diku shkava. Në një vend tjetër, m'u desh të mbësh-tetja dorën mbi një gur të madh pér t'u ngjitur. Ktheva kokën dhe pas hë Ymerin. Ai mundohej të më ndiq-te, të mos mbetej larg meje.

— Si dukesh? — e pyeta.

— Mirë.

— A u lodhe?

— Jo.

— Shkel në gjurmët e mia, që të mos pengohesh a të shkasësh gjékundi.

Ai ashtu bënte, shkelte atje ku kisha lënë gjurmë unë. Dhe ecnim, ecnim mbi kodrën e zhveshur e krejt të bardhë. Duhej të arrinim sa më parë.

Iu afrova majës së kodrës. Atëherë ktheva edhe një herë kokën pér të parë shokun. Këtë radhë, ai kish mbetur mjaft prapa. Por përpiquej të ecte sa më shpejt, të më arrinte, të mos shkëputej prej meje. Shikoja mundin e tij, të gjitha orvajtjet që po bënte. Vendosa ta pres. Kështu do të merrja fryshtë edhe unë, se, q'ësh-të e vërteta, isha lodhur.

— Mos u ngut, Ymer! — i thirra. — Me ngadalë. Po të pres. Kemi dhe mjaft rrugë pér të bërë.

Ai qëndroi, drejtoi shtatin dhe — duket nuk i kish kuptuar të gjitha fjalët e mia — më pyeti, duke dihatur:

— Si thua?

— Mos nxito! Mos u lodh! Po të pres.

— Jo, jo, nuk lodhem! — m'u përgjegj. — Ja, erdha!

Qëndrimi një çast ja shtoi pak fuqinë. Vura re që filloi prapë rrugën më me vrull. Por, kur arriti pranë meje, po gulçonte. Ballin ja kishin mbuluar bulëza djerse. Hunda e tij e hollë sikur ish zgjatur, ndërsa sytë e zez i ishin zmadhuan.

— U lodhe, Ymer, — i thashë.

— Disi. Ti qenke më e fortë se unë — ma bëri.

— Unë jam mësuar këtyre rripave. Jam vajzë fshati dhe malësore, bile.

— Edhe unë do të mësohem. Apo jo?

— Doemos. Do të të rrahin erërat, do të pish ujë burimi, do të çash qafat e kreshtat dhe do të bëhesh sokol mali, do të ma kalosh edhe mua.

Ymeri buzëqeshi.

Tani, përpëra nesh shtrihej një pllajë. Vendi ish

krejt i zhveshur, i mbuluar nga çarçafi i dëborës. Me të dalë majë kodrës, ndjemë një suferinë, që vërvshëllente si gjarpër. Kurse pas pak, na erdhën në vesh, që larg, krisma armësh. Ato herë afroheshin, herë largo-heshin. Era i sillte dhe i merrte prapë.

— Armë! — ja bëri Ymeri.

— Po, ashtu duket.

— Që andej dëgjohen — vazhdoi ai, duke treguar me kokë nga zna e djathtë.

— Andej është Çuka e Kuqe, për të cilën na foli fshatari.

— Të jenë gjermanë?

— Ndofta.

Nuk kishim nge të humbisnim kohë. Të ftohtët sikur po na ndillte të ngjethura në kurrizin e dërsirë.

— Nisemi — i thashë Ymerit. — Sa të dalim në qafë, pastaj e kemi tatëpjetë drejt fshatit; andej s'para zë era.

I hymë pllajës, duke menduar se ajo nuk do të na lodhët aq. Por, sa bëmë pak hapa, era filloj të na rrähë më shumë. Nisi të tërbohet e të ulërijë, të ngrejë e të vërtitë dëborën. Thuase donte të na rrëmbente e të na përplaste gjékundi edhe ne. Fytyra po më digjite, duart i kisha të mardhura, këmbët më ishin lagur. Mbledha qafën, mbërtheva jakën e ngritur të palltos, hodha në kokë dhe e lidha nën mjekër një shall të vogël dhe shtrëngova duart në xhepe. Ymeri ngrjeshi edhe më shapkën dhe rregulloi torbën që kish hedhur krahëqafë, brenda së cilës ishin edhe plaçkat e mia. Ne u pregititëm për t'i bërë ballë tufanit, që po na kërcënonte.

Po shkonim krah për krah, të penguar, të shtyrë e të lëkundur nga era që ja thoshte këngës së saj të ashpër. Ndonëse duhej të ish afruar mesi i ditës, ish errësuar sikur po zbriste nata. Dëbora, e ngritur nga era, hiqte një valle të qmendur, na vriste sytë, nuk na linte të shikonim mirë përpëra.

Por ne duhej të çanim. Nuk mund të mbeteshim

në mes të detit të bardhë, si ndonjë lundër që valët mund ta flaknin nga të donin.

— Jepi, Ymer! — i foia shokut tim. — Duhet të sosim, s'kemi ç'bëjmë ndryshe.

— Do të sosim, doemos! — m'u përgjegj ai me besim dhe hodhi vrapin vrikthi, sikur deshi të më siguronte se kish fuqi për t'u qëndruar rrugës dhe stuhisë.

Ecëm përmes tufanit, ecëm me trup e mendje të mbledhur, përshkuam gjysmën e pllajës. Na mbetej edhe gjysma. Pastaj kishim për t'i u ngjitur malit thikë që të dilnim në qafën e tij. Moti nuk kish të zbutur. Përkundrazi, ish egërsuar edhe më. Asnjëri nuk po hapte gojën. Mendja jonë rrihte në një gjë; kur do të arrimim në qafë. Ymeri po mbahej, madje mund të them se po nxitonte hap pas hapi me mua. Veç po ndjeja se frymëmarrja e tij ish bërë më e shpeshtë, gjë që tre-gonte se ai po mundohej, po luftonte, që të mos ngecete.

Pllajën e kaluam. Unë arrita më parë rrëzë malit, por dhe Ymeri nuk u vonua.

— Mirë jemi gjer këtu — i thashë.

— Po.

— Tani do ta kemi më pisk.

— Do ta kapërxejmë edhe këtë — më tha ai.

Një fjalë goje ish kjo. Mali, që për së largu dukej jo kushedi se çfarë, përkundrazi si diçka më e vogël ndaj hapësirës së pllajës, tani na ngrihej përpëra vigan, ndërsa qafa e tij na kish humbur nga sytë. Ish një mal shkëmbor. Kisha kaluar këtej dhe e dija. Por gurët e gropat e tij nuk dukeshin. Vetëm shkëmbinjtë e më-dhenj, të cilët i kish mbështjellë, gjithashtu, dëbora, shquheshin aty-këtu si xhunga të pamasa.

Filloi ngjitja jonë në atë vend të egër, pas një rruge të gjatë nëpër stuhinë e pandërrerë, që na kish lodhur. Këtë ngjitje të papërshkrueshme do ta mbaj mend tërë jetën. Male e shpate të mprehta ngjita më vonë, gjatë operacionit të parë e të dytë, edhe nën plumbat e armikut, por nuk di pse më la një vragë aq

të thellë kjo ngjitje. Ndofta ish e para në ato kushte, ndofta se isha vetëm me një shok.

E kisha të qartë se ngjitja do të ish shumë e rën-dë, jo vetëm për Ymerin, po edhe për mua. Fuqitë to-na nuk mund t'i bënin ballë egërsisë së natyrës që na ish vërsulur mizorisht nga të katër anët. Për ta mun-dur natyrën, duhej t'i vinim kraharorin, por, më shu-më, duhej të dinim të dredhonim e ta mashtronim. Pra, fuqitë tona duhej t'i përdornim me kujdes, me kursim, që të mos i humbisnim shpejt e plotësish dhe të mbe-teshim, pastaj, krejt në mëshirën e natyrës, e cila do të na shtrinte nën këmbët e saj. Duhej të çanim me guxim, me vendosmëri, duke ruajtur një pjesë të fu-qive për çdo rast, gjersa të dilnim në qafë. Këto i shpjegova Ymerit, dhe morëm të përpjetën.

Bëmë hapat e parë, kaluam disa metra, dhe na u duk se ja kishim filluar mirë. Zemrën e kishim të ngroh-të, plot shpresë. Një çast, mendova se ndofta qafa nuk do të ish larg, se do të na dilte shpejt përpara. Dhe eca më me shpresë, e ndjekur nga Ymeri.

Mirëpo të këqiat që na prisnin, nuk vonuan. E pa-ra shkava unë, rashë dhe mbeta një copë herë ashtu. Dëgjova Ymerin që më thirri:

— Leni! u vrave?!

Ai nxitoi të më vinte në ndihmë, por unë e ndala.

— Mos u afro! — i thashë. — Është vend rrëpirë, mos e pësosh më keq se unë. Do të ngrihem vetë.

Bëra të ngrihesha, mirëpo nuk ja dola dot, rrësh-qita më poshtë. Duhej të ndryshonim drejtimin. U zva-rrita djathtas. U mata përsëri për t'u ngritur. Me duar dhe me gjunjë, brofa në këmbë; pastaj hodha nja dy hapa dhe vura re se vendi ish më i mirë. I thirra Ymerit:

— Bëj këtej!

Ai eci në drejtimin tim. Por, para se të më afro-hej, ra. I zgjata dorën dhe e hoqa. U çua.

— Tani e tutje do të ecim kështu, dorë për dorë — i thashë. — Dhe kështu vazhduam rrugën.

U çapitëm me ngadalë, me ndrojtje të madhe. I shtrëngojë Ymerit dorën në pëllëmbën time, dhe më dukej se ai kish një farë zjarmie. E pashë një herë me bishtin e syrit, pa i folur. Ai vështronte përpara, me një sy pak të mekur, të lodhur e ëndërrimtar. Kushe-di çfarë i shkonte në mend. A kish frikë? A kish dy-shim? Apo hetonte atë vend të cilit duhej t'i dilnim mbanë? Nuk mund të besoja se ish trembur, as se ish penduar që kish marrë atë rrugë. Mendova vetëm se ai kish grumbulluar gjithë aftësitë e tij trupore dhe i kish përqëndruar kundër malit, dëborës dhe stuhi.

Vendi tani nuk ish fort i keq. Dëbora na kalonte përmbi noçkat, por ngjishej nën këmbët tonë, na mban-te dhe na lejonte të hidhnik hapin. Po vazhdonim ngji-tjen tonë.

Ymeri ktheu kokën dhe më tha me një fytyrë të celur:

— Dora jote éshtë një mbështetje e fuqishme përmua. Pa të unë nuk do të bëja dot këmbë në këtë vend.

Nuk i fola. Ai nuk tha gjë tjetër; vazhdoi të ecë, i ndërgjegjshëm se kjo vetëm kërkohej në ato caste.

Bëmë një copë rrugë të mirë. Qafa e malit nuk dukej gjékundi. Mendoja se kishim edhe mjافت për të bërë. Veçse uroja që vendin ta kishim kështu, të na mbante, që të mund të ngjiteshim, pa ç'ka se me mundim e lodhje të madhe.

Pas pak, m'u duk se dora e Ymerit sikur po dri-dhej dhe sikur ai po ngadalësonte hapin.

— Ymer, si ndjehesh? — e pyeta.

Ai nuk iu përgjegj pyetjes sime, porse tha:

— Vazhdojmë.

— Më duket se u lodhe shumë.

— Kam fugi akoma.

— Por na duhen edhe më, se nuk dihet kur mund t'i dalim qafës.

— Do të kemi.

Më erdhi një mendim dhe ja thashë Ymerit:

— A qëndrojtmë tē çlodhemi pak?

— Si tē duash. Po ku? — pyeti ai.

— Ulemi pak nē bisht. Sa tē marrim një çikë veten.

Ymeri pranoi. Larguam me këmbë dëborën nē një copë vend dhe u ulëm galic. Por nuk mundëm tē qëndronim gjatë nē këtë mënyrë. Këmbët na u mpinë. Era na rrihte fort. U ngritém dhe nisëm përsëri ecjen.

Kthyem bërrylin dhe, sakaq, që tē dy nuk mundëm tē përmbanim një shprehje kënaqësie.

— Qafa e malit! Ja ku e kemi! — thirra unë.

— Po arrijmë, Leni! — tha i gëzuar Ymeri.

Vërtet, qafa e malit nuk ish larg. Maja e tij ngrihej përpjetë kërcënonjëse, sikur puqte retë. Por poshtë, mjaft poshtë saj, vendi vinte lugë, përbri kurrizit tē një mali më tē ulët. Atje duhej tē kalonim. Kishim a nuk kishim edhe gjysmë ore rrugë. Pastaj, do tē kaptonim matanë. Vendi ish shullë, mbante pak dëborë, zbriste tatëpjetë. Fshati ndodhej nē fund.

Pamja e qafës na dha fuqi pér tē shpejtar. Era nuk kish tē pushuar, përkundrazi këtej ulërinte si ndonjë lukuni ujqërish. Por ne tani kishim marrë zemër dhe nuk pyesnim pér asgjë.

Ja shtrëngova dorën dhe e têrhoqa Ymerin me dëshirë që t'ja jepja vrapi pér tē pëershkuar sa më parë rrugën. Kaluam qafën dhe morëm poshtë. Këtej vendi vinte ndryshe. Dëborë kish më pak; era gati u pre. Kjo faqe e malit ish e veshur me bredha tē lartë, ndosnë tē rrallë.

Mbajtëm një çast këmbët dhe hodhëm sytë nē fund, atje ku duhej tē ish Lundraja. Fshati shquhej përmes një tisi mjegulle. Shtëpitë e tija ishin tē përhapura.

— E shikon fshatën, Ymer? — i fola shokut tim.

— E shikoj.

— Do tē arrijmë shpejt.

— Atje do tē jenë partizanët?

— Po. Atje është komanda e qarkut.

— Atëherë, shkojmë!

Ymerit nuk i durohej gjersa tē arrinim nē fshat,

të takoheshim me partizanët, të bëheshim partizanë edhe ne.

Por edhe të tatëpjetën nuk e zbritëm lehtazi. Na merreshin këmbët, nuk mbaheshim dot, ish rrezik të rruckulliseshim. Gjithë trupi na tronditej e na dhimbte. Shkonim afër bredhave, kapeshim pas tyre dhe qëndronim për t'u çlodhur një copë herë.

Kur iu afruam fshatit, pashë një fshatar që sapo doli nga shtëpia dhe i thirra:

— O shok!

Ai dëgjoi dhe u kthye nga ne.

— Nga vini kështu? — pyeti.

— Nga qyteti.

— Nga qyteti! — u çudit fshatari. — Andej, gjer në qafë, duhet të jetë kiamet i madh. Si dolët?

— Me të vështirë — i thashë.

— Për ku jini nisur? — vazhdoi fshatari. — Ur-dhëroni në shtëpinë time të merrni veten.

Në këtë çast, Ymeri u këput që më këmbë e përdhe. I ra të fikët.

— C'pati shoku?! — pyeti fshatari dhe nxitoi drejt Ymerit. E zumë atë të dy dhe e futëm në shtëpi. E shoqja e fshatarit na doli përpara dhe na ndihmoi ta vendosnim në minder, pranë vatrës. Katër kalamaj, fëmijët e tyre, na u mblohdhën rrötull.

— Shpejt! — i tha fshatari së shoqes. — Sill rakinë ta fërkojmë!

Gruaja solli një shishe të mbushur përgjysmë, të zënë në lyftë me një kokë zogu të gdhëndur në dru bushi. Fshatari hodhi ca raki në pëllëmbë të dorës dhe nisi ta fërkojë Ymerin në zverk, në témtha, në kraharor; hodhi edhe pak raki në pëllëmbë, ja vuri në hundë dhe ja mbajti një copë herë. Ymeri thithi rakinë dhe bëri kokën mënjanë; pastaj hapi sytë.

— Aq qe. I shkoi. — tha fshatari dhe iu drejtua së shoqes: — Hiqi këpucët dhe ngrohe atë qumështin ta pinë këta miqtë, se po vijnë sot nga qyteti në këtë kohë.

Grúaja deshi t'i nxirrte këpucët Ymerit, por unë nuk e lashë. Ja zgjidha dhe ja zbatha. Këmbët i ishin bërë qull.

— Nxirri dhe të tuat — më tha gruaja — dhe kthei nga zjarri.

Ajo vrapi dhe solli një kusi të vogël me qumësht, të cilin e vuri në vatër.

Fshatari ish një burrë i gjatë, pak i kërrusur, me fytyrë të zgjatur rrëth të dyzetave. E shoqja do të ish mbi të tridhjetat, mesatare nga trupi, e pashme, me një vështrim të émbël. Kalamajtë, — tre djem e një vajzë — më i madhi mund t'i kish mbushur të nëntë vjetët, ndërsa më e vogla nuk ish as tre vjeç. Kush mbathur e kush zbathur, kush me një fustan e kush me një palë bollka të grisura, ata na shikonin me kërshëri të madhe e si të hutuar.

Fshatarit i tregova qëllimin tonë. Prej tij mësuam gjendjen në fshat dhe rrötull. Ai na tha se gjermanët dhe ballistët kishin sulmuar atyre anëve. Ato të shtëna armësh që kishim dëgjuar me të dalë në pllajë, ishin krismat e përpjekjes së partizanëve me armikun. Luftha ish bërë në lindje të fshatit, ndonjë gjysmë ore e ca larg. Gjermanët donin të hynin në Lundrajë, në qendrën e komandës partizane. Por, në orvajtjen e tyre të parë, ishin thyer dhe têrhequr. Më vonë, kishin marrë krahët për ta rrëthuar fshatin. Ata kishin ushtri të madhe, kishin qëlluar edhe me artileri; disa predha kishin rënë brenda në fshat. Komanda partizane kish dhënë urdhër të têrhiqeshin fuqitë tona për të dalë në vende më të mira, për ta goditur armikun e për t'i shkaktuar humbje sa më të rënda. Partizanët ishin larguar. Kishin mbetur vetëm disa të fundit, praparoja, bashkë me të cilën do të shkonte edhe njisiti luftarak i fshatit.

— Edhe unë po shkoj me ta — tha fshatari. — Bëj pjesë në njësit. Për atje isha nisur. Koha nuk pret.

— Po vij atëherë... — i thashë.

— Po vjen?.. Po shoku?..

Ymeri që e kish marrë ca veten, foli me një zë të dobët:

— Edhe unë do të vij...

U hodh gruaja e fshatarit:

— Ku do të vesh ti! Apo të mbetesh rrugës, të pengosha edhe të tjerët? Qëndroni të dy — m'u drejtua mua.

— Jo, jo, unë nuk mund të qëndroj! — theksova

— Ti, Ymer, vërtet, nuk je në gjendje — iu ktheva shokut. — Të paktën të duhen nga dy ditë të pushosh. Por, a mundet?.. — thashë duke u kthyer nga fshatarja.

Gruaja e kuptoi mendimin tim dhe u përgjegj menjëherë:

— Mos ki merak. Vjeshtën që shkoi këtu kam mbajtur dy partizanë të plagosur. Edhe sikur të vijnë gjermanët në fshat, unë do ta ruaj më mirë se fëmijët e mi. Ta kesh mendjen të fjetur.

Mezi e qetësuam Ymerin dhe e bindëm të qëndronte.

— Rifat, ki kujdes! — e porositi fshatarja të shqin, tek po na përcillte. — Të qoftë rruga e mbarë, moj motër! — më uroi ajo.

Në komandën partizane u gjend një pushkë edhe për mua. E hodha në sup dhe u nisa së bashku me katurtë partizanë dhe me njisitin luftarak të fshatit.

## PRAPA KAFAZEVE

Gurasi është një fshat malor, i ndërtuar në një shpat gjithë shkëmbinj e gurë të bardhë. Siç duket, nga kjo ai ka marrë dhe emrin. Poshtë, në këmbët e tij, dredhon lumi, i cili dimrit e shton shumë ujin, po edhe verës ka ujë mjat të kulluar, sa që duket gjithë fundi i shtratit, me rërën, fiçorët e bardhë e të zez, dhe ndonjë cironkë të vogël — të vogël, që të vërtitet andej-këtej, duke tundur bishtin e hollë. Uji kapërxen nëpër popla të mëdha gurësh e varet nëpër ca shkallare të shtratit, duke shkumbëzuar. Arat e fshatit janë të shpérndara buzë lumit ose nëpër skërka.

Fshati kish gjithsejt dyzet a pesëdhjetë shtëpi, të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nga vetë duart e të zotërve të tyre, të cilët, që në vjeshtën e dytë e gjer në të hyrë të pranverës, punonin mjeshterinë e muratorit. Ishin shtëpi një e dy katshe, prej guri të bardhë të vendit, me dritare të ngushta e të gjata, me çati të mbuluara me plloça ngjyrë hiri. Kur dielli ish në të perënduar, prapa majave bardhoshe, që sikur çiknin qiellin tutje në horizont, xhamet e dritareve vezullonin në një ngjyrë manushaqeje a të kuqe dhe pasqyronin një shkëlqim që të vriste sytë. Por disa dritare, ndonjëse ishin kundrejt diellit, mbeteshin të murme, si sy të verbër, pa përkëdhelitë e rezeve me qelqin. Këto dritare ishin të zëna me kafaze. Dërrasat, me rripa prej tre a katër gishtërinjsh të gjerë, ishin mbërthyer mbi to së gjati dhe tërthorazi. Ato ishin murrëtyer prej ko-

hës dhe ishin ngrënë prej krimbit. Nëpër to drita nuk hynte dot lirisht brenda.

Kështu, me kafazë, ishin zënë edhe dritaret e shtëpisë së Rexhep Lisit. Ajo ish një një shtëpi me dy kate, e ndërtuar si gjithë të tjerat, me një oborr të madh të shtruar me kalldrëm, ku ishin ashefi, plevica dhe një pus, që e kish ujin brisk të ftohtë. Shtëpia e Rexhepit ish në lagjen e sipërme të fshatit dhe prej saj dukej gjithë vendi poshtë si në pëllëmbë të dorës, me shtëpi-të, arat, lëmenjtë, lumin, rrugën, që lidhte Gurasin me Granishtin, fshatin e afërt, që unk mbante më shumë se gjysmë ore.

Rexhepi ish një burrë i gjatë, rreth të pesë-dhjetave, mustaqemadh, me hundë pak të kthyer, sy-pishë, me ca bebe të zeza. Edhe mustaqet, të dredhura përpjetë, i nxinin, kurse flokët kishin zënë t'i thinjen në tëmthat dhe në zverk. Pamja e tij tregonte një burrë të qetë, me vullnet të fortë, zemërmirë.

Në shtëpi, ai ish vetë i katërt: kish të shoqen, Nafijen, një grua të shkurtër, pak të ngjallme, me një fytyrë me tipare të rregullta, ku shquhej një butësi e theksuar. Nafija, që në p'kë të mëngjezit e gjer natën vonë, vinte vërdallë në tërë shtëpinë, duke bërë një-qind e një punë, por nuk ndjehej, isikur nuk ish fare në atë shtëpi. Rexhepi kish edhe dy fëmijë: Hasanin, që kish mbushur të njëzet e një vjetët dhe Resmijen, që sapo kish shkelur në të tetëmbëdhjetë pranverat.

Rexhep Lisi ish njeri punëtor. Ai kish punuar tërë jetën sa kish plasur, bamb në arë e bamb si murator, kudo që të gjente punë. Ndryshe nuk kish se si mba-hej shtëpia. Që kur i ish rritur Hasani dhe i ish bërë krah, ai ish lehtësuar dhe i ish pakësuar ca lodhja e mundimi. Dhe Rexhepi kish thënë: «Djali po djalë ësh-të; ai ta merr krahun, të del për ndihmë. Kurse vajza, gruaja, janë për në shtëpi, nuk janë për gjë tjetër. Një djalë nuk mund të barazohet as me njëzet vajza.»

Kështu mendonte Rexhep Lisi. Ai kish huqet e tij në këtë mes, ashtu si kishin të gjithë burrat e Gura-

sit. Gratë janë vetëm për në shtëpi. Aty ishte nderi dhe puna e tyre, mendonin ata. Prandaj ato nuk ka-përxisen prakun për punë jashtë, në arë a gjetiu, siç ndodhët në fshatra të tjera. Edhe në Granisht, kishin zënë t'i nxirrnin gratë për punë. Kurse në Guras, jo, Ja pse edhe dritaret e shumë shtëpisë ishin të zëna, sot e kësaj dite, me kafaze. Kështu i kishin pasur dritaret të gjitha shtëpitë e fshatit. Mirëpo, me kohë, ca nga ca, një pjesë e fshatarëve i kish thyer dërrasat, i kish shkallmuar dhe i kish djegur në zjarr. Këtë punë nuk kishin guxuar ta bënin Rexhep Lisi dhe shokët e tij.

Në prak të mbarimit të luftës, Rexhepit i kishin sjellë në shtëpi, për të fjetur, disa partizanë. Kishin qenë tre të rinj fshatarë, një djalë e një vajzë nga qyteti. Rexhepi i kish pritur zemërhapur, si miq të vërtetë. Ai e kish pasur të qartë se partizanët luftonin për të ciliruar atdheun, për të mirën e popullit. Ai i urrente ballistët, se i njihte kush ishin, se ç'bejlerë dhe agallarë kishin në krye.

Partizanët kishin ndenjur një natë në shtëpi, kishin bërë një bisedë të gjatë me të, kish ardhur fjalë edhe për punën e kafazeve. Ata ja kishin hedhur fjalën Rexhepit se ato kafaze tregonin mbeturina të vjetra, por këtij nuk i ish mbushur mendja.

## 2

Sihariqi i cilimit të Shqipërisë i gëzoi edhe Gu-rasit. Që atë ditë, në fshat filloj të ndjehej një gjallëri. Shumë gjëra fliteshin: për reformat e pushtetit, për tokën dhe kafshët që do të mernin fshatarët e për të tjera.

Sidomos kohët e fundit në fshat u shtua gjallëria. Njerëz të qytetit hynin e dilnin më shpesh; ishin burra e gra, të rinj e të reja.

Moti ish i mirë. Pemët kishin lulëzuar. Bari, pas shirave, që kishin rënë, kish marrë përpjetë, ish azdisur. Lumi rriddhe me ujë të shkumëzuar.

Të deleguarit i mblidhnin fshatarët te lëmi që ish në mes të fshatit; vend më të mirë për mbledhje nuk kish në fshat. Atje shtroheshin këmbëkryq burrat dhe të rintjtë. Asnjë grua, asnjë vajzë nuk të shikonte syri. Disa delegatë, që kishin vajtur, kishin mundur të bënin nja dy mbledhje me pak gra e vajza në shtëpinë e kryetarit të këshillit popullor, të xha Kasëmit, i cili kish pasur një djalë partizan, Liken, që tani ish liruar nga ushtria dhe ish kthyer në fshat.

Nga shtëpia e Rexhep Lisis dukej për bukuri lëmi, ku mblidheshin fshatarët. I deleguari qëndronte në këmbë dhe u fliste, u jepte e u merrte me duar e me kokë. Ata dëgjonin duke e vështruar në sy, me gojë të hapur, ndonjëri hiqte takien dhe kruante kokën, një tjetër xheq i thoshte në vesh shokut që kish në krah. Si mbaronte i deleguari, disa ngrinin dorën dhe i bënin pyetje; të tjerë çoheshin dhe merrnin fjalën.

Këto mbledhje bëheshin në të ngrysur, po edhe në mes të ditës, si ta donte puna. Rexhep Lisi vente e merrte pjesë. Hasani, gjithashtu. Në shtëpi, mbetej Nafija me të bijën. Gruaja, si gjithnjë, as ua vinte fort veshin atyre, që ngjisnin. Ajo hynte e dilte nga ashefi në qilar, shkonte në plevicë, kthehej në dhomë, gatuante, tundte ndonjë çikë qumësht, lante e kryente punë të tjetra, ashtu e heshtur, pa bërë zhurmë.

Asaj i vinte në ndihmë Resmija që nxirrte ujë nga pusi, fshinte shtëpinë, qëronte ndonjë fasule, merrje, sidomos, me rrëgullimin e sobës e të dhomave, ose bënte ndonjë punë të dorës, që të pregetiste diçka për pajën.

Rexhep Lisi ja kish dhënë fjalën xha Kasëmit, i cili ja kish kërkuar Resmijen për Liken. Djali e kish parë njëherë rastësisht vajzën, siç ish kthyer nga ushtria, dhe i kish pëlqyer. Nafija me të bijën kish shkuar një ditë në shtëpinë e kryetarit. Ata kishin miqësi, dhe shtëpitë e tyre ishin pranë. Me Fatimen, të shqen e Kasëmit, Nafija ish si motër.

Resmija e mbante mend Liken që përpara se ai

të shkonte partizan. Pas kthimit të tij në fshat, ajo e kish vënë re disa herë nga dritarja, duke u ngjitur e zbritur, e kish parë edhe në mbledhje me të rinjtë te lëmi, kur ai u mbante fjalë, se ish përgjegjësi i rinisë së fshatit. Likja tani ish zgjatur e ndryshuar që nga koha kur e mbante mend ajo. Nga fytyra vinte pak i hequr, ksh një hundë të drejtë, sy të mëdhenj dhe një gjajtan mustaqesh të zeza në buzë. Vinte pak zeshkan dhe ish i hijshëm. Mbante një farë zhaqete dhe një palë qillota ngjyrëvaji; në këmbë kish një palë këpucë me qafë dhe në kokë kapën e partizanit me yll të kuq. Resmijes i kish lënë mbresë apo e kish parë. Ajo e vështronë me kujdes, sa herë ja zinte syri nga dritarja, dhe dëgjonte me vëmendje, kur ndonjë shoqe e saj, apo tjetërkush, fliste për Liken. Kështu, kur një natë, mbasi burrat kishin rënë të flinin, Nafija e kish hequr të bijën mënjanë dhe i kish thënë se e kërkonte xha Kasemi për Liken, ajo kish ulur kryet, ish skuqur, kish mbetur e heshtur një copë herë. Por kur e ëma e kish pyetur nja dy a tri herë se ç'mendim kish ajo, Resmija, më në fund, kish tundur kokën, duke i dhënë të kuptojë se pranonte. Me kaq, fjala e fejesës ish lidhur.

Kur thurte çorapet e pajës, Resmija rrinte në dhomën e mirë lart, prej nga dukej pjesa më e madhe e fshatit, lëmi i mbledhjeve, arat, lumi poshtë, malet e thinjura tej. Ajo lëvizte duart me shpejtësi dhe humbiste në èndërrime. Në një çast, duart ngadalësonin lëvizjet, sa qëndronin fare, dhe atëhere vajza nuk e kish mendjen në punë, por ish shkrirë e tëra në përfytyrimet që i dilnin përpara. Atëhere, sytë gështenjë, me qepallat e dendura, i mbeteshin në një pikë, fytyra e rrumbullaktë dhe e bardhë i bëhej edhe më e hijshme, duart e saj topolake mbeteshin me gjithë shtizat mbi pëqi. Në të tilla raste, ajo i ngjiste edhe më shumë nënës së saj, ndonëse nga trupi vinte më e gjatë dhe nga shpatullat më e mbushur, si i ati. Dukej se në kraharonin e saj të rritur, rrihte një zemër e ndjeshme,

e pastër, por dhe e guximshme. Buzët e vajzës ishin si qershi, tèrë tul, dhe goja i mbetej pakëz e hapur, si ndonjë gonxhe e porsaçelur, tekxa ajo ish duke ëndërruar.

Ky kujtim e zinte atë, kur kish qëlluar të vështron-te nga dritarja mbledhjet e rinisë. Ajo shikonte gjithë djemtë e fshatit, të shtruar këmbëkryq atje te lëmi, që kuvendonin rrëth punëve të tyre; u hidhte vështrimin atyre një pér një dhe sytë i mbeteshin mbi Liken, që ish në këmbë, duke folur. Kafazi i dritäres ja ndante grumbullin e të rinxje në ngastra-nngastra dhe e detyronte që ta lëvizte kokën me mërzitje djath-tas e majtas, që të mund të shikonte mirë. Më në fund, ajo kish mbajtur vështrimin në njëren nga vrimat e kafazit, nëpér të cilën Likja dukej i téri, që nga koka e gjer te këmbët. Ai fliste. Zëri nuk i vinte gjer te vajza, por duart e tij, që ngriheshin e uleshin me fuqi, grushti i dorës së djathjtë, që tundej ndonjë herë në erë, i jepnin asaj të kuptonte se Likja, pér ndonjë gjë të madhe e plot duf, u fliste shokëve të tij. Resmija e kish humbur mendjen fare pas të fejuarit të saj dhe e kish lënë çorapin në pëqi, gjersa mbledhja kish mbaruar. Atë e kish zgjuar dhe e kish bërë të hidhej si e llahtarisor zëri i s'ëmës që e thirri nga hajati.

### 3

Që kur ish bërë fejesa, Rexhep Lisi e kish mbyllur thuaçse fare të bijën në shtëpi. Ai thoshte se, tani, nderi e donte që ajo të shikonte punën e saj atje brenda, të preqatitej e të dilte me një barrë lezet kur të vinin e ta merrnin krushqit. Duhej të kishin mendjen të mos bënin ndonjë budallallëk e të turpërohen. Këto ai i kish thënë shkurt, me zërin e tij të trashë, duke vrenjtur vetullat kaleshe.

Tani, kishin nisur të vinin më shpesh e ëma e Likes dhe e motra Bajamja. Kjo vinte thuaçse çdo ditë, qëllonte dhe nga dy herë në ditë. Ish motmot më e vo-

gël se Resmija, i ngjiste shumë të vëllait, ish zeshkane, me një gërs het të trashë e të zi si penda e korbit, hedhur në kurriz, gjithnjë me një buzëqeshje në ftyrrë, e lëvizur, sprihë nga goja, që nuk i pushonte kurrë. I ati e kish fejuar me një djalë nga Granishti, i cili kish shkuar ushtar e do të kthehej pas ndonjë viti e gjysmë. Atëherë do të bënин dasmën.

Bajamja rrinte orë të tëra me Resmijen dhe i fliste pareshtur kësaj, i tregonte plot gjëra, i sillte lajmet e reja. Ajo i fliste edhe për Liken, i rrëfente ç'thosh-te ai për punët e rinisë, se si duhej të futeshin në organizatë edhe vajzat. Nga Likja dhe nga gazeta që lexonte ai, Bajamja merrte vesh ç'ndodhët nëpër qytete dhe fshatra të Shqipërisë, se si punonte rinia për të ndërtuar vendin, se si ish hapur fjala se atë vit do të bëhej një rrugë që nga Kukësi në Peshkopi. Këto ajo ja tregon-te Resmijes.

Resmija e dëgjonte, e dëgjonte me shumë vëmen-dje, thuajse ja thithë fjalët një nga një dhe donte që tregimet e Bajames të mos mbaronin. Asaj i vinte keq kur shoqja ngrihej për të ikur, ndonëse edhe kësaj nuk i vinte mirë për këtë, mirëpo duhej të largohej se e prisnin në shtëpi.

Një ditë, kur Bajamja kish ardhur të kërkonte pak ok-lainë, se u ish thyer e tyrja, ajo u ngjit në dhomën lart dhe u shtrua në bisedë me Resmijen.

— A e di se tim eti po i mbushet mendja të më lerë në mbledhjet e rinisë? — tha Bajamja.

— Vërtet?

— Duket sikur u kandis.

— Si kështu?

— Nuk e ka lënë rehat Likja. Natë për natë, kë-të fjalë i thotë: «Ti je kryetar i këshillit të fshatit dhe akoma me të baba Qemos po vete. Nuk ka lezet. Ti duhet të bëhesh shembull në fshat. E di se ka të tjerë, që janë gati t'i lënë vajzat, por të presin ty?» Kur s'e lë xha Kasëmi, kryetar i këshillit, të bijën — thonë ata — si t'i lëmë ne tonat?! «Hajde, baba,

mjaft më me të vjetrat!» Edhe delegatët, që kanë ardhur nga qyteti, i kanë folur gjithnjë tim eti për këtë punë. Ai jo se nuk do, por ka turp mos e tallë njeri.

Resmijen sikur e hutoi një gëzim.

— C'thua, Resmije? — pyeti Bajamja.

— Oh, ç'të them? Fjalë të mira po dëgjoj, por...

— Çfarë?

— Shumë e vështirë më duket të bëhet kjo...

— Pse?

— Ti i di baballarët tanë...

— I di, por... nuk ka për të mbetur kështu... Mirë thotë Likja.

— A thua?..

— Po, po, nuk ka për të mbetur kështu... — Pastaj, Bajamja e pyeti Resmijen: — A të pëlqen të vesh në mbledhje?

Resmija u përgjegj pas një çasti:

— Më pëlqen. Por ç'e do! se mos është në doren tonë...

— Do t'ja mbushim mendjen edhe xha Rexhepit.

— Oh! E ku i mbushet mendja atij! As mund t'ja zësh në gojë një gjë të tillë. Bota mund të përmbyset, por që të më lërë ai të dal jashtë, të vente në maledhje, kjo s'më duket të bëhet. E njeh tim atë apo jo? Nuk shikon se tani, që kur lidhëm fejesën, ai nuk më lë të pipëtij fare?

— Nuk ka se ç'bën yt atë. Do të japë e do të jepë, dhe një ditë do të zbutet. A e di se ç'më ka thënë Likja?

— Çfarë? — u hodh Resmija plot këershëri.

— «Ti dhe Resmija do të jini të parat që do të hyni në organizatën e rinisë». «E ku e lë xha Rexhepi Resmijen!», i thashë unë. «Nuk e lë?! Do ta lërë se s'bën!», ngulmoi Likja. «Resmija është tani e fejuara ime. Nesër do të martohemi. Tani kam të bëj unë me të. Turp, nder, çdo gjë më bie mua.» Kështu më tha Likja.

Resmija ndjeu zëmrën t'i rrahë më fortë. Faqet e

saj morën të kuq. Me atë bardhësi të fytyrës, me tis-  
sin e përskuqur, me qafën e gjatë, me dylbenin e bar-  
dhë, që i mbulonte kokën gjer afër ballit, duke lënë  
t'i dilnin ca cullufe ngjyrë gështenje, me dy gërshe-  
tat mbi kraharon, Resmija dukej një vajzë e dlrë,  
shpirti i së cilës ish ndrydhur prapa kafazeve, por që  
tani kish zënë të rrrethohej me shpresa dhe me gëzi-  
min e moshës së re, gëzim që po hapte krahë, kohët  
e fundit, pas fejesës.

— Ç'hotë tjetër Likja? — pyeti ajo.

Bajamja e kuptoi edhe më mirë gjendjen e vajzës.

— Më flet shumë herë për ty. Të do shumë, të  
do me gjithë mend. Është i çuditishëm Likja. Nuk dua  
ta lëvdoj se e kam vëlla, po, ç'është e vërteta, është  
i zoti, i mirë, i dashur... Ke për të shkuar jetë me të.  
«Erdhi koha të çlirohet edhe gruaja», thotë ai, «të da-  
lë nga kafazet, ta shkelë fanatizmin. Prandaj luftuan,  
prandaj dhe vetë gratë morën pjesë në luftë».

Resmijes i vinte mirë kur dëgjonte gjithë këto.  
Ndonëse mjaft gjëra i kish të errëta, ndonëse nuk e  
dinte se çkuptim kishte kjo apo ajo, dhe se si do të ven-  
te filli, ajo e ndjente thellë se ashtu mbyllur e kok-  
ulur, si kishin qëndruar e po qëndronin gratë e vaj-  
zat, ish një gjë që nuk durohej dhe që nuk kish për  
të mbetur kështu. Tjetër kohë kish ardhur. Sa gjëra  
po dëgjonte ajo, dhe sa flisnin njerëzit!

Fjalët e Likes, që ja kish thënë Bajamja. «.. pran-  
daj dhe vetë gratë morën pjesë në luftë...», i kujtuan  
atë partizanen, që u kish ardhur në shtëpi, bashkë me  
partizanë të tjera, në kohën e luftës. Ajo i tha Bajames:

— Mban mend kur na erdhën partizanët në fshat,  
dy vjet të shkuar? Kish edhe partizane me ta. Ë, të  
kujtohet?

— Posi.

— Ne patëm bazë katër veta në shtëpi. Ish edhe  
një vajzë nga qyteti. Vinte rrumbullake, me leshtra  
të zeza të prera shkurt, e veshur me pantallona.

— Nëve na erdhën pesë veta. Me ta ishin dy par-

tizane: njëra prej qyteti dhe tjetra nga Devolli.

— I përgjova nga hajati, kur ata ishin në dhomë. Dëgjoja çflisnin. Kur u hap një herë dera dhe doli Hasanit për të marrë gjellën, vura re partizanen, që i ish kthyer tim eti dhe po i thoshte: «Ku i kini gratë, o shoku Rexhep? Pse nuk po i shohim?» Im atë u zu ngushtë dhe i tha: «Gruaja ka punë: ja, po na bën ca për të ngrënë...» Partizanja e pyeti prapë: «Po çupa nuk ke?» Babai, sikur i ish zënë fyt, mezi u përgjegj: «... Kam një...» «Ku është, pra?» ja bëri ajo. Ai gënjeu: «Ish pa qejf dhe ka rënë...» Po partizanja i ra hilesë dhe ja pat: «Më duket se nuk i nxjerr gratë në të huajt, o shoku Rexhep. Gabim e ke. Ne jemi shokë e vëllezër. Nuk duhet të mbetemi me zakonet prapanike. Ato duhet t'i zhdukim. Ja, më shikon mua? Vajzë jam, po kam marrë pushkën dhe po luftoj krah për krah me vëllezërit e mi për të çliruar atdheun.» I mbaj mend fjalët e saj, që i rriddhnin nga goja zinxhir. Im atë nuk foli më. Ai i thirri Hasanit të sillte gjellën.

— Unë u dola partizanëve — tha Bajamja. — Edhe mëma u doli. Im atë s'bëri zë. Ndenja me ta gjersa ranë të flenë. Bëra muhabet me partizanet tërë natën. «Eja me ne, eja të bëhesh partizane edhe ti, eja të takosh Liken», më thoshnin ato duke qeshur. Do të vish?» «Do të vij», u thosha unë dhe qeshja me to. Do të vij se më ka marrë malli për Liken» Im atë, duke më dëgjuar, ja bënte: «A, llafamane, llafamane!» Mëma i pyeste për Liken, mos e njihnin, mos e dinin ku ish brigada e tij. Ato i thoshnin të mos kish merak, se edhe pak muaj e Shqipëria do të çlirohet dhe Likja do të kthejë shëndoshë e mirë.

— Trime vajza ato partizane — tha Resmija.

— Si ato duhet të jemi — ja bëri Bajamja. — Josi ne që na kanë mbajtur të kyçura në burg.

— Dhe na mbajnë akoma — u hodh tjetra.

— Na kanë mbajtur sa na kanë mbajtur — tha duke ngritur zërin Bajamja. — Nuk do të rrimë tërë

jetën kështu, de! Hajde, pa ta tregojmë edhe trimëri-në tonë!..

— Si të bëjmë?

Ashtu si bënë ato.

— Ku e ke fjalën?

— Ato dolën malit, rrëmbyen pushkën, luftuan krah për krah me djemtë dhe burrat kundër armiqve, u kacatytën me ta. Ne do të dalim tani, në punë, bashkë me vëllezërit tanë... .

— Po kush na lë?

— Se mos ato të gjitha i lanë prindërit? Kish mjaft që ikën nga shtëpi pa lejën e babait a të nënës. Kishte ca vajza të tillë në batalionin e Likes. Ato deshën të luftonin për çlirimin e atdheut; dhe nuk i pengoi dot kush.

— Kështu ta bëjmë edhe ne?

— E pse jo? Po s'deshën të na lënë vetë, kështu do ta bëjmë.

Resmija mbeti pak e menduar, pastaj tha: — Unë i kam zili ato, partizanet, që kishin dalë malit. Ato ishin me të vërtetë trimëresha. S'patën frikë as nga fa-shistët, as nga ata që donin t'i mbanin në shtëpi.

— ... Dhe ç'i gjeti? — e ndërpree Bajamja. — E fituan me luftën e tyre.

— E fituan — tha me zë të ulët Resmija, — e fituan vërtet, m'u lumtë!

#### 4

Në mëngjez Bajamja, siç e kish zakon, hyri duke nxituar në oborr dhe thirri:

— Resmije, Resmije! Ku je, moj?

— Hajde, Bajame, hajde! — u dëgjua Resmija, e cila doli nga soba dhe u drejtua për në ashef.

— Dëgjo një sihariq të ri — i tha Bajamja Resmijes.

— Ç'është?

— Do tē ngrihet shkolla nē fshatin tonë. Që nga kjo vjeshtë e tutje, fëmijët nuk do tē venë nē shkollë nē Graniشت. Shkollën do ta ndërtojë rinia, më tha Likja.

— Kur do tē ndërtohet?

— Këto ditë, do tē fillojnë. Po, dëgjo, Likja më tha se do tē hapet edhe kurs, ku do tē mësojnë analafabetët, ne, moj Resmije!

— Kush tē mësojë?

— Analfabetët.

— Analfabetët?!

— Po, moj. Analfabetë quajnë ata, si ti dhe unë, që nuk kemi vajtur nē shkollë, që nuk dimë shkrim e këndim. Mësuesja e shkollës do tē na mësojë edhe ne. Ika tani, Resmije, se kemi vënë kazanin tē lajmë rrobat — shtoi Bajamja dhe u nis me tē shpejtë, si flutur, ndërsa gërshta e zezë i hidhej nē kurriz.

Po atë pasdite, nga dritarja e dhomës së mirë, Resmija vuri re se nē lëmë po mblidheshin tē rintjtë e fshatit. Ndër tē parët kish vajtur atje Likja bashkë me një djalosh tjetër, që, siç dukej, ish nga qyteti.

Hasani nuk kish vajtur ende. Resmija i dëgjoi këmbët nëpër shkallë.

— Hasan, ku vete? — e pyeti.

— Në mbledhje.

— Ç'e kini këtë mbledhje?

— Për punën e shkollës — shpjegoi Hasani me zërin e tij tē qetë, ashtu si fliste dhe e ëma. Hasani nga fytyra i ngjiste t'et, nga trupi vinte i shkurtër si e ëma dhe nga tē folurit i përngrjiste asaj.

— Çfarë shkolle? — pyeti përsëri Resmija, duke u shtënë sikur nuk dinte gjë.

— Do tē ndërtojmë shkollë nē fshat. Për këtë do tē bisedojmë nē mbledhje — dhe Hasani zbriti shkallët.

Resmija e ndoqi me kujdes zhvillimin e mbledhjes nē lëmë. Në fillim, tha pak fjalë Likja. Pastaj, foli shumë djaloshi nga qyteti. Pas tij, u ngritën e folën shumë tē rintjtë. Resmija pa edhe tē vëllanë që mori fja-

lén. E vërejti atë me kujdes tek po fliste, duke mendar se çfarë, vallë, po thoshte. Më në fund, foli edhe një herë Likja, dhe mbedhja mbaroi. Ajo e ndoqi të fejuarin e saj me sy, gjersa ai u largua së bashku me djaloshin.

Kur u shtrua familja rrëth sofrës për të ngrënë darkën, Rexhep Lisi dukej i menduar. Vëtullat i ishin mbledhur në rrëzë të hundës, e cila sikur i ish përkulur më shumë, ndërsa buzët i ishin shtrënguar e zgjatur përparrë. Nafija solli dy misurë me dhallë e ca dja-thë të fortë; Resmija, bukën dhe lugët.

Rexhepi pyeti të birin:

— Ç'e kishit atë mbedhje, sot?

— Për punën e shkollës... Do të ngremë shkollë në fshat.

— Hëm! — ja bëri Rexhepi. Si qëndroi pak, vazhdoi: — E kush do ta ngrejë?

— E mori përsëri rinia. Ne do të punojmë. Do të na vijnë në ndihmë dhe nga qyteti.

— Nga qyteti?

— Po, do të vijnë disa brigada të rinisë. Do të punojnë me radhë, gjersa të mbarohet shkolla.

Ra një heshtje. Dëgjoheshin të trokiturat e lugëve në misuret me dhallë. Nafija hante dhe, herë-herë, shikonte me bishtin e syrit të shoqin. Resmija kish ulur sytë mbi sofrë; ajo dukej sikur nuk e kish mendjen në bisedën, por, ç'është e vërteta, ish bërë tërë veshë dhe nuk linte t'i shpëtonte asnjë fjalë. Kur të tjerët pushuan, asaj i vajti mendja tek ato që i kish treguar në mëngjez Bajamja; mendonte se fjalët e saj kishin qenë të vërteta. Iu kujtua edhe kursi i analfabetëve, që i kish zënë në gojë shoqja. Të ish e vërtetë edhe kjo? A dinte gjë Hasani? Do ta përmendte, vallë?

Rexhepi pyeti:

— Kur do të fillojë puna?

— Këto ditë — u përgjegj Hasani.

Resmija mbante veshët ngritur.

Rexhepi po mendohej. Pastaj, tha nëpër dhëmbë:

— Do të ketë dhe Gurasi shkollë.. .

— Kjo është gjë shumë e mirë — shtoi aty për aty Hasani. — Do të mësojnë të gjithë fëmijët e fshatit tonë. S'është nevoja të vejë kush gjer në Granisht. Atëherë, kush vente në shkollë, vente. Të tjerët, sidomos vajzat, mbeteshin pa shkollë.

Rexhepi ja bëri:

— Vajzat... S'prish punë se mbetkan pa shkollë vajzat... .

Resmija deshi të hidhej e të thoshte: «Pse të mos mësojnë vajzat ? Ç'kusur kanë të mbeten qorre ato?», por nuk pati guxim; fjalët i mbeten në grykë dhe u skuq. Një copë bukë i ra nga dora.

Hasanit i vajtën sytë tek e motra dhe ja priti t'et:

— Edhe vajzat duhet të mësojnë; pse jo?

— Se mos do të bëjnë hesape të mëdha ato... — tha Rexhepi. — Ç'ka humbur jot ëmë që nuk di gramë?

— Ai që është pa shkollë, është i verbër me sy, baba, — tha Hasanit. Kështu ish qëmoti, por, sot, punët ndryshuan.

— Ndryshuan, nuk them se jo — pohoi Rexhepi, — por vajza, gruaja, bën edhe pa shkollë.

— Sot, e drejta u është dhënë të gjithëve — vazhdoi djali.— Prandaj nuk duhet të mbetet prapa.

— Po më flet ashtu siç shkruan gazeta, që na këndon Likja atje në zyrat e këshillit — ja bëri Rexhepi.

— S'e ka keq as gazeta, as Likja — u hodh e tha i biri.

Rexhepi e ktheu gjetkë.

— Si do të punoni për shkollën?

— Me punë vullnetare.

— Do ta bëni dot?

— Si të mos e bëjmë?!

— Po ç'duhet?

— Gurët i kemi. Qerestenë do ta presim në pyll. Do të djegim gëlqeren. Plloça për të mbuluar çatinë ka te

Gryka e Ujkut. Do të na ndihmojë dhe këshilli. Nga qyteti do të na dërgojnë bankot dhe gjëra të tjera.

— Domethënë, ke ndër mend të merresh edhe ti me këto punë?

— Disa orë në ditë, duhet. Kur të jetë puna, do të vete ndonjë ditë në mal për qereste. E dhashë fjalën edhe unë si të tjerët.

— Të lësh punën tënde e të trapitësh për të tjerët?!

— Nuk do ta lë punën tonë. Po edhe shkolla puna jonë është. Apo jo? Të tjerët luftuan, çliruan Shqipërinë. Ne do të punojmë që ta ndërtojmë të re.

«Më të lumtë, Hasan!», po thoshte me vete Resmija. «Të lumtë ajo gojë të keqen motra!»

Rexhepi u ngrit.

— Grua, shtromë të bie — iu drejtua ai Nafijes, e cila ish trembur mos pëlciste ndonjë sherr në mes të shoqit dhe të birit.

\* \* \*

Pas dy ditësh, në Guras erdhën dhjetë veta të dërguar nga rinia e qytetit. Ishin shtat djem e tri vajza. Ata i shpërndanë nëpër shtëpitë e fshatit. Dy vajza i shpunë në shtëpinë e kryetarit.

Të rintjtë e Gurasit kishin filluar të grumbullonin gurët te vendi ku do të ndërtohej shkolla. Në fshat, dukej dhe ndjehej se po ndodhët diçka me rëndësi. Të gjithë flisnin për këtë ngjarje. Burrat e moçëm tundnin kokën dhe thoshin : «Hej, hej ! Nuk kish parë ndonjëherë Gurasasi shkollë e mësues... Ne mbetëm pyka në diell, por ja, fëmijët e fëmijëve tanë, do ta kenë shkollën në prak të shtëpisë, do të venë e do të mësojnë të gjithë». Disa shtolin : «Erdhi tjetër kohë, tjetër ! Kjo qeveri, që është tani, jo shkolla, po çudira, çudira do të bëjë. M'i lumtë rinisë! Po e bënë fora! Mor, po, duhet ta ndihmojmë edhe ne, se e ka hak!», hidhej e thoshte një tjetër.

Zunë të hapin themelinë e shkollës. Njëri nga ata që kishin ardhur nga qyteti, mbante një letër në dorë dhe u

tregonte të tjerëve se që nga e gjer ku duhej të thellonin. Siç i thërrisin, ai ish gjemometër.

Kazmës së parë i ra Likja.

— Hajde, gjëuar, shokë! Të rrojë partia! — thiri dhe e nguli me fuqi majën e hekurit në tokë.

— Paç dorën e mbarë! — thanë të rinjtë dhe të re-jat. Dhe ata e pasuan Liken në këtë punë.

Punën e vrullshme të rinisë për ngritjen e shkollës në Guras Resmija po e vështronte nga dritarja me ku-reshtje dhe habi. Ajo ish ngjitur enkas atje; kish pranë edhe Bajamen.

— Shiko, moj, shiko me sa hov që ja kanë marrë! Pa le ç'punokan edhe ato të qytetit! Më shumë se djemtë! Njëra prej tyre paskësh qenë partizane, — po thoshte Bajamja, duke folur shpejt e shpejt, si ndonjë tartareckë.

Por Resmija nuk po ja vinte veshin. Ajo kish humbur në ato që po shikonte atje poshtë ku po zjente puna. Shikonte Liken, Hasanin, shikonte, sidomos, qytetaret. Ishin të veshura me fustane. Njëra prej tyre — siç duket ajo për të cilën Bajamja kish thënë se kish qenë partizane — ish me pantallona. Që të tria ishin leshprera. Njérës, që dukej mjaft më e gjatë se të tjerat, leshrat i skuqnin.

Resmija sikur donte t'i përpinte me sy. Nuk ua shqitte vështrimin. Vinte re me kujdes çdo lëvizje të tyre, se si ngrinin e ulnin kazmat, si qëndronin e çlodheshin, pastaj merrnin lopatat e nxirrin dheun, si flisnin midis tyre dhe me djemtë. Zemra po i rrihte tak-tak, më shpejt se kurdoherë. Ajo po ndjente faqet t'i ndize-shin prush. Po punonin bashkë me djemtë, tri vajza! Çudi! Kishin lënë shtëpitë, kishin lënë njerëzit dhe kishin vajtur atje në Guras, majë malit e shkëmbit! Si i kishin lejuar prindërit? Nuk i kishin penguar fare? Apo ato nuk donin t'ja dinin?.. Hej, qytet qytet! Sa ndryshe qen-këshe ti! Pastaj, habia sikur i pakësohej, kur mendja i vente te vajzat, që ishin hedhur në luftë.

Vajza me pantallona i kujtoi partizanet që u kishin vajtur në fshat. Siç i kish thënë Bajamja për ato që u kishin shpënë në shtëpi, njëra ish qytetare, porse tje-

tra ish bijë fshati, po, po, bijë fshati, nga Devolli! Jo vetëm qytetaret ishin hedhur në luftë dhe tanë po punonin, por edhe fshataret kishin dalë malit për të luftuar bashkë me djemtë! Paskish edhe fshatare që dilnin nga shtëpia e punonin në arë si pa gjë të keq. Po, kishte! E di ajo.

Këto mendonte, për këto i rrithë zemra fort Resmijes, duke parë vajzat që punonin atje ku do të ndërtohej shkolla. Dhe mendja e saj nuk peshonte vetëm këto, por fluturonte edhe në të tjera gjëra, në ato për të cilat kish kaq dëshirë!

— E di, moj, që ajo e gjata, leshkuqja — Afërdita e quajnë, — do të na mësojë shkrim e këndim? — ja preu endërrimet Bajamja.

— Shkrim e këndim?! — ja bëri si e hutuar Resmija.

— Posi! Ka sjellë me vete një libër, një abetare.

— Sa kohë do të rrinë këtu për të na mësuar?

— Do të na mësojë ca kjo, pastaj do të na vazhdojnë të tjerat, që do të vijnë.

— E kush do të mësojë?

— Vajzat e fshatit, moj.

— C'vajza të fshatit?

— Nja katër bëhemë një herë, me siguri.

— Cilat janë këto?

— Unë, një, Bahrija e xha Myrtos, dy, Zenepja, tri, mund të vijë edhe Ganija e Shabanit, katër. Resmija u çudit:

— Bahrija, Zenepeja, Ganija! Do të mësojnë?! Si? Ku?

— Posi, moj. Ka biseduar Likja me xha Myrton dhe Shabanin. Xha Myrtos ja ka mbushur mendjen edhe Afërdita, që u ka vajtur në shtëpi. Për Zenepen e ka marrë përsipër i vëllai. Po të vish edhe ti, bashkë me ty, bëhemë pesë.

— Unë?!

— Edhe ti!

— Kush më lë...

— A e di si e ka bërë hesap Likja? Afërdita po bën tri ditë te xha Myrtoja. Pasnesër, tha ai, do ta heqin që andej dhe do ta sjellin tek ju.

— Tek ne?

— Po, moj, do ta sjellin tē banojë. Dhe do tē mbli-dhemi këtu, që ajo tē na mësojë. A nuk e ka menduar mirë Likja? S'ka ç'bën xha Rexhepi! Apo jo?

Kjo e gëzoi Resmijen. Një qytetare do t'u vente në shtëpi. Me tē ajo do tē bisedonte, prej saj do tē dëgjonte e do tē mësonte gjëra, do tē mësonte edhe shkrim e le-xim, siç thoshte Bajamja!

— Është shumë e zgjuar Afërdita — vazhdoi shoqja e Resmiges. — Na vjen çdo mbrëmje bashkë me Violetën dhe Shpresën dhe kërcet muhabeti pér shtatë palë qejfe. Apo nuk është shakatore Violeta! Ç'nuk na tregon pér atëherë kur ish partizane!.. Afërdita më ka mësuar disa shkronja. Ja, kësaj i thonë a — shpjegoi Bajamja, duke shënuar me gishtin tregues në A mbi pëlhirën e minderit ku ish ulur Resmija.

... Pas dy ditësh, vajza nga qyteti vajti në shtëpinë e Rexhep Lisis. Resmija e priti me gjithë zemër, duke e vështruar me kujdes. Tani, asaj iu duk shumë e gjatë, dhe i pëlqeu me atë fytyrë tē vogël, me ato pikla rrëth hundës dhe përmbi mollëzat e faqeve, me ata sy shumë tē kaltër, që i mbyllte pak, dhe me ato flokë krejt si me këna, të cilët i mbante tē mbledhur prapa veshëve.

Që në mbrëmjen e parë, te Rexhep Lisi vajtën edhe dy qytetaret e tjera, bashkë me Bajamen. Ajo me pantallona, Violeta, kish një fytyrë tē mbushur, tē djegur nga dielli e tē rrahur nga era, me sy tē mëdhenj, që nxinin si dy kokrra qomyri. Tjetra, Shpresa, vinte fytyrë-gjatë, pak e hequr, me sy si bajame, buzëkuqe.

— E shikoni, po e bëjmë shkollën... — filloj e para Violeta. — Ka dalë një metër mbi tokë. Në shtator, fëmijët e Gurasit do tē venë në shkollën e tyre. Ja ç'bëjnë partia dhe pushteti, moj nënë! — iu drejtua, pastaj, Nafijes, duke i hedhur krahun në qafë. Dhe vazhdoi: — Ja pse luftuam, që tē fitojmë lirinë, që tē dalim nga errësira tē gjithë, që tē shohim ditë tē bardha edhe ne gratë, barabar me burrat...

— Ashtu, moj bijë, ashtu... — thoshte me zërin

e saj të butë Nafija, në mënyrë të vetvetishme, pa u menduar shumë dhe duke tundur kokën.

Violeta foli gjatë. Folën edhe Shpresa dhe Afërdita pér jetën e re, që kish lindur në Shqipëri, pér të mirat që e prisin popullin, pér shkelmin që u duhej dhënë fashizmit dhe prapambetjes. Pastaj, ato folën pér jetën në qytet, pér rindërtimin që bëhej kudo, pér kënetën e Malikit, që do të thahej, e pér plot gjëra të tjera.

Fshatarët po i dëgjonin duke i vështruar në sy, duke përpire çdo fjalë të tyre.

Resmija kish mbetur si e trullosur. Ato qytetare i dukeshin shumë të çuditshme, si njerëz që vinin nga një botë tjetër, pikërisht si partizanët dikur. Sa gjëra po dëgjonte ajo pér herë të parë! I dukeshin si përralla. Të mahnitshme ishin pér të ato vajza. Dhe përbrenda i lindi një dëshirë e madhe, një zili, një nevojë, pér të qenë edhe ajo si ato, pér të jetuar dhe punuar si ato, pér ta parë e pér ta njobur botën plotësisht si ato. A do të kish një fat të tillë? Ky mendim nuk e linte të qetë.

Kur u kthyen në shtëpi Rexhep Lisi dhe Hasani, të gjitha gratë zbritën në dhomë. Qytetaret u shtruan në bisedë me burrat. Rexhepi i dëgjonte pa folur, i menduar. Herë-herë, ai u drejtonte ndonjë pyetje ose rrihnin në fjalët e tyre ato vajza.

Si ikën shoqet e saj dhe Bajamja, Afërdita ndenji rrëth sofrës me gjithë familjen pér të ngrënë darkën. Ajo deshi të vazhdonte bisedën e nisur më parë. Në mënyrë të qetë, iu drejtua Rexhepit:

— Shumë vetave u duken çudi gjithë këto që kanë ngjarë e po ngjasin. Dhe, me të vërtetë, është pér t'u çuditur. Ku ish parë një luftë e tillë e popullit tonë kundër dy armiqve kaq të mëdhenj e të armatosur gjer në dhëmbë, sic ishin fashistët italianë e gjermanë! Shqiptarët kanë luftuar edhe herë të tjera, por jo

si kësaj radhe, që u ngritën më këmbë të gjithë anembanë Shqipërisë! Lirinë na e solli edhe gjaku i grave dhe i vajzave shqiptare! U përbys bota e vjetër, po, xha Rexhep, u përbys! Ca thonë. «U prish dynjaja». Jo, bota nuk u prish. Në vendin tonë edhe në vende të tjera, ku popujt kanë fituar lirinë dhe paravësinë e vërtetë, u prish, u përbys bota e armiqve të popullit, e tradhëtarëve dhe e shtypësve. Ndër ne, po lind një jetë e re. Këtë duhet ta shikojmë e ta kuptojmë mirë. Që të zhdukim varfërinë dhe paditurinë, ku na kishin lënë, duhet t'i përvishemi punës të gjithë, me burra e gra, ashtu siç luftuam, ndryshe nuk bëhet. Por, për këtë, sa gjëra duhet t'i hedhim prapa krahëve! Unë, për shembull, një vajzë nga qyteti, ndodhem larg shtëpisë sime, kam ardhur këtu të punoj për të ngritur shkollën; ndenja disa ditë te xha Myrtoja, tani jam në shtëpinë tuaj... Kudo e ndjej veten për bukuri, si në shtëpinë time, si në gjirin e familjes sime. As më ka gjetur, as do të më gjejë ndonjë e keqe...

Rexhep Lisi e dëgjoi Afërditën përsëri me sy ulur, duke thithur, në heshtje, cigaren e trashë me duhan gérxhallë. Por, kësaj radhe, nuk duroi më gjatë. Ai sikur deshi të nxirrte edhe ato që kish gëlltitur pak më parë, kur ishin vajzat e tjera dhe tha:

— Ndofta nuk e ke keq dhe ti, moj çupë. Por, ndryshe është andej nga qyteti, ndryshe këtej nga ne...

Afërdita i preu fjalën:

— Do të thuash në fshat? Por e di, sigurisht, që edhe në fshat gratë e vajzat dalin në punë, marrin pjesë edhe në gjëra të tjera bashkë me burrat. Sido mos këto vite, që nga çlirimini, puna ka ndryshuar në mjaft fshatra.

— E di, në fushë ka fshatra si thua ti. Mirëpo këtej i thonë malësi dhe kemi të tjera zakone.

— Të tjera zakone! — ja bëri Afërdita. — Nuk duhet t'i mbajmë zakonet që nuk na vlejnë, zakonet prapanike! Të gjithë të marrim zakonet e mira të shqiptarit.

— Pse, ç'të keqe kanë këto zakonet tona të maliçisë? Ato na i kanë lënë të parët, dhe ne do t'i lemë kështu siç i kemi gjetur.

— Jo, xha Rexhep, duhet të shkundemi nga zakonet e këqia, që na kanë lënë pushtonjësit e huaj, turqit, sidomos, që t'i mbyllim gratë brenda në kafaze.

Duke dëgjuar Afërditën, një dritë e re sikur po i kthjellonte mendjen Resmijes. Ajo po dëgjonte e po mësonte gjëra për të parën herë. Dhe këto sikur po i jepnin zemër më shumë.

— Si thua ti, Hasan? — iu drejtua Afërdita djaloshit.

— Ashtu është. I kam thënë edhe unë babait...

Rexhepi e shikoi shtrembër të birin, por këtij nuk iu tremb syri.

Afërdita iu kthye përsëri të zotit të shtëpisë:

— Xha Rexhep, Likja, i fejuari i Resmijes, është djalë shumë i mirë. Ka qenë partizan, është i hedhur në punë, drejton organizatën e rinisë...

— Ku e ke fjalën? — pyeti Rexhepi qëllimi shëtit.

— Dua të them se ai mendon e vepron drejt, prandaj është mirë të dëgjojmë dhe të rintjtë, ashtu si dhe të vjetërit.

— Gjer tani unë nuk kam vojtur për mend, që të marr mendtë e tij — tha Rexhep Lisi jo pa tallje.

— S'e kam fjalën aty, por një mendim i saktë, i kujtdo qoftë, nuk bën keq kur merret. A nuk ke biseduar ndonjëherë me të?

— Kur e ka sjellë puna... Për disa gjëra, ai kërkon të ngatërrojë dynjanë.

Nafija i ra të shoqit me bërryl, se ai po shante të dhëndërrin. Rexhepi vështroi të shoqen turivarur. Ajo uli kokën.

— Pse nuk vjen Likja në shtëpinë tuaj? — pyeti Afërdita.

Atij ja ka ënda të vijë, por tani nuk e ka sérën. Kur të marrë të shoqen, atëherë po.

— Pse, tani ç'bëhet po të vijë? Ai është dhëndërr i juaj, është bërë njeri i shtëpisë.



— Ja ka një çikë frikën babai — ngacmoi Hasani.

— Ti mbylle gojën, se nuk të janë rritur akoma veshët! — iu kanos Rexhepi të birit dhe u ngrit.

...Afërdita u shtri në dyshekun që kish shtruar Resmija në dhomën e mirë. Të dy vajzat do të flinin bashkë. Resmija shohti llambën dhe u fut edhe ajo në jorgan. Afërdita i hodhi krahun dhe e pushtoi. Resmija ndjeu ngrohtësinë e saj dhe një erë të kënd-sme që vinte nga trupi i vajzës, erë të cilën ajo nuk e kish ndjerë tjetër herë.

Resmija i tha Afërditës:

— Shumë mirë ja bëre. Të lumtë goja!

Afërdita theksoi:

— Do të vijnë edhe për ju ditët e bukura, moj motër. — Nuk do të mbeteni të mbyllura, jo. Veç duhet të përpigjeni dhe vetë. Ta merrni punën në dorë.

— Nuk është aq e lehtë.

— E lehtë nuk është, vërtet, kjo është një luftë. Por se mos ish më e lehtë lufta me armë, që bënë vajzat? Ë?

— Mirë thua.

— Kjo luftë është më pak e rëndë se ajo. Tani jemi të lirë, jemi zotër në vendin tonë, prandaj fanatizmin dhe prapambetjen duhet t'i shkulim.

— Por cila nga ne do të guxojë të hidhet e para?

— Të hidhen sa të mundin. Dy, tri, katër, në fillim. Pastaj do të bashkohen edhe të tjera. Të gjitha vajzat presin shkëndijën e parë.

— Ashtu është.

— Krah ku të mbështeten kini shumë: komunistët, rininë, na kini ne.

Resmijes po i qeshite buza, po i shkëlqenin sytë në errësirën e dhomës.

Ashtu të pushtuara, të dy vajzat biseduan, për një kohë të gjatë, për shumë gjëra, për punë vajzash dhe për çështje të moshës së tyre, për fejesën dhe martesën e ardhshme të Resmijes, për Liken... gjersa

ju rënduan qepallat, fjalët zunë të rralloheshin, dhe gjumi i mbërtheu në krahë të njëra-tjetrës.

5.

Puna për ndërtimin e shkollës, në Guras, kish marrë hov të madh. Qytetarë dhe fshatarë nxitonin të mbanin me nder zotimin. Në krye të tyre ish Likja.

— O burra, o trima! — u thërriste ai të rinjve dhe vetë merrie me shpejtësi gurët, i vendoste, i shikonte këtej-andej, u vinte plumbçen, pastaj shtron te përsipër llaçin me mistri.

Me kurrizin e dorës së majtë ai ngriti kapën në të cilën kuqëlonë ylli. Në ballë, i ishin bërë sumbulla djerse.

Likja kish mësuar mjeshtërinë e muratorit që para se të shkonte partizan. Tani, si në punët e tjera, ashtu edhe në ngritjen e shkollës, ish bërë shembull për të gjithë.

Muret po rriteshin dita-ditës, dritaret po merrnin trajtë si ca sy shumë të mëdhenj.

Të rinxjtë kishin dhënë fjalën ta mbaronin para afatit, që ish caktuar në fillim.

U bë një pushim.

Kush zbriti nga skela, kush la tezgën, dhe u ulën aty ku ish grumbulli i gurëve.

— A u lodhët? — u tha Likja të tjerëve.

— Këto çupat xheku lodhen ca — tha një djalë vendas, fytyrërrumbullaktë, me një hundë me majë, që shikonte përpjetë.

— Neve mos na e qaj hallin! — ja priti menjëherë Violeta. — E tregon puna jonë. Ti dhe ca të tjerë nuk haheni dot me ne. Sa herë ju kemi lënë në baltë?

Të tjerët qeshën. Ai që deshi të ngacmonte vajzat, mbeti i turpëruar.

— Mirë ta bëri, o Sefkë! — i tha një fshatarak tje-

tér. — Ç'të duhen llafet ty! — Dhe vazhdoi: — Mor, po këto qytetaret punojnë më shumë se djemtë! Po çupat e Gurasit kur do të dalin?

Djali me hundë përpjetë sikur deshi të merrte hak, ndërhyri:

— Ti nuk ke motër, prandaj nxitohesh të shtysh të tjerët...

— Nuk është fjala këtu, e Sefkë — u hodh Likja.

— Njëri ka motër, tjetri s'ka. Të gjithë duhet të përpinqemi që jo vetëm vajzat, po edhe gratë të dalin në punë e në mbledhje dhe në çdo gjë tjetër. Apo jo? Nuk duhen marrë punët së prapi.

— Mirë thotë — tha një djalë nga qyteti. — Për këtë duhet të punojmë, paskemi a s'paskemi motra.

— Doemos, ata që kanë motër, duhet, në radhë të parë, të nxjerrin motrën e tyre, të bëhen shembull. «Po ti ç'po bën për motrën tënde», do të më thoni.

Bajamja gati është — e ndërpren Liken Afërdita.

— Ajo do të dalë e para.

— Do të dalë që ç'ke me të! — tha Likja. — E dini, veç, që im atë nuk hidhet dot i pari, ndonëse është kryetar i këshillit? Sidoqoftë, ai s'ka si pengon. Vëtëm se unë mendoj që kur të dalin, të mos jetë vetëm një, por katër a pesë vajza, që t'u bëjë përshtypje të tjerëve, t'i nxitë edhe ata. Se vetëm një, është rrezik që për një kohë të mbetet fillikat.

— Ashtu është — pohoi Afërdita.

— Megjithatë, tim atë nuk kam për ta lënë rehat, jo. Do t'ja heq edhe atë drojtje që ka në vete.

— Puna është ç'duhet bërë me të tjerët — tha Violeta.

— Po. Duhet të bëjmë një punë më të madhe. T'u flasim, të përpinqemi, t'u mbushim kokën. Por, kryesorja është që t'u heqim frikën vajzave, motrat apo kushrirat tona qofshin. Ato ta thyejnë akullin, pa u tutur se ç'mund t'i gjejë. S'ka për t'i gjetur gjë, jo! Në dorë e kanë. — Pas një heshtjeje të shkurtër, Likja vazhdoi: — Punë të tjera, më të rendësishme, na pre-

sin. Shqipëria, dita-ditës, do të ecë përpara. Ne duhet të kapërxejmë çdo pengesë, që të mund t'u bëjmë ballë detyrave të reja.

Që këtej fjala ra në punën e mësimit.

— Si duken vajzat? a po mësojnë? — pyeti Likja Afërditën.

— Mirë ja kanë filluar — u përgjegj tjetra. — Bajamja dhe Resmija e rrëmbejnë mësimin menjëherë. Janë të zgjaura, dhe kanë shumë zell për të mësuar.

Të rinxjtë e të rejat u ngritën dhe vazhduan punën gjersa nisi të erret. Pastaj, ata lanë tezgat, çekanët, lopatat e mistritë dhe u shpérndanë nëpër fshat.

Likja me nja dy të tjerë mori për andej nga kë-shilli. Në sheshin para zyrës, ishin mbledhur fshatarë që tymosnin llullat, dridhnin ndonjë cigare sa gishti i madh i dorës, vendosnin mbarë e prapë. Midis tyre, Likja patanë dhe më tej Rexhep Lisin, i cili, siç dukej, atëhere po ngjitej për në shtëpi se edhe rruga i binte këtej.

— E latë punën? — pyeti xha Kasëmi të birin, duke e vështruar me ata sy të thellë, që e tregonin sikur ish përherë në mendim.

— Ja, apo... — tha shkurtimisht Likja.

— Mor, po m'i lumtë rinasë! — u hodh e tha një plak i shkurtër, me ca mustaqe të rralla, me fytyrë të vogël, që i queshte gjithnjë.

— Mos na i lëvdo shumë të rinxjtë, se u rritet mendja pastaj... — tha me një zë gjysmë të ngjirur një fshatar tjetër i hollë e i gjatë, moshëkaluar, i cili zuri të kollitej.

— E pe që nuk fole mirë, o Shyqo! — ja bëri plaku i shkurtër me fytyrë të qeshur. — Nga rinia do ta këmi selametin ne, po nga kush tjetër, nga gérxhot?

— Mirë thotë xha Osman — ndërhyri një meso burrë me një kapë të zezë në kokë.

Shyqoja deshi ta zinte në fjalë xha Osmanin.

— Po nxirre edhe ti çupën në punë e në mbledhje, xha Osman, — i tha atij.

— Pse, nuk do ta nxjerr, thua? Do ta nxjerr që

punë e madhe! Po ti si do të bësh me tënden, pa na thuaj!

— Më të lumtë goja, xha Osman! Fole mirë! — thirri Likja.

— Xha Osmani e ka kuptuar — tha burri me kapë të zezë.

— E kam kuptuar, dhe të gjithë do ta kuptojnë se kjo parti po na i hap sytë, po na zgjon nga gjumi — theksoi plaku. Pastaj, iu drejtua Shyqos. — E, nuk më dhe përgjigje për çupën tënde, si do të bësh?

Tjetri lëvizë një herë shpatullat, sikur u krojt, dhe nuk diti q'të përgjigjej.

— Eu! ti, xha Osman, ke llafe... — tha ai pastaj dhe bëri tutje.

— Dale, dale, mos ik, përgjegju këtu! — nuk e la të qetë xha Osmani.

— Kam punë, kam punë, nuk kam nge për muhabet — vazhdoi tjetri me zë të ngjirur dhe iku.

Xha Osmani ja dha të qeshurit. Qeshën edhe të tjerët.

— Ç'ja bëre paq, o xha Osman! — tha me kënaqësi Likja.

Gjithë këtë bisedë e dëgjoi Rexhep Lisi, i cili u ndodh aty prapa bashkëfshatarëve.

— Si m'u ngryse, Rexhep? — i foli xha Kasëmi që e vuri re.

— Mirë. Ju si u ngrystë? — u përgjegj Rexhepi.

— A e dëgjon xha Osmanin? — vazhdoi krushku.

Rexhepit iu duk sikur ai ja hodhi.

— Dëgjova — ja bëri thatë.

— Kështu është puna, Rexhep, — ndërhyri këtë radhë xha Osmani. — Kështu do të bëhet edhe me çupën time, edhe me tënden. Dëgjomë mua, se jam ca më plak. Po dëgjo edhe këta djemtë, ama — vazhdoi ai duke treguar Liken me shokë.

Biseda nuk zgjati më. Fshatarët zunë të ndahan.

Duke shkuar me shokët, Likja u tha:

— E dini se Zenepeja e xha Osmanit do të jetë nga të parat që do ta kapërcejë prakun e shtëpisë?

- Thua?
- Po, po, më ka folur Bajamja pér tē.
- Nuk dëgjon, dhe xha Osmanin s'ka pér ta ndaluar — tha njëri nga djemtë.
- Xha Osmani éshëtë me ne. Plak, por zemrën e ka prej tē riu.
- Djemtë qeshën.
- Po, po, Zenepeja e xha Osmanit do tē jetë nga tē parat vajza, që do tē dalin — theksoi edhe një herë Likja.

\* \* \*

Në këtë kohë, në Guras u përhapën dy lajme: do tē shkonin vullnetarë pér tē tharë kënetën e Maliqit dhe pér tē ndërtuar rrugën e rinisë që nga Kukësi në Peshkopi. Flitej se brigada vullnetarësh, nga qytete dhe fshatra, ishin nisur pér në këto dy aksione.

Guras po ziente nga këto lajme.

«Si, ore?! Do tē thajnë Maliqin?!» thoshte njëri.

«Aha, s'ma merr mendja! Ku thahet tërë ajo dreq kënetë! ja priste tjetri.

«A e dini se edhe në kohën e Zogut i hynë kësaj punë, por aha! nanac se bënë gjë!»

«Lerna, o, me gjithë Zogun dhe këndezin! Atëherë i hëngrën paratë bejlerët e tregëtarët, pa e lanë kënetën sic ish!»

«Kjo Parti i bën tē gjitha! Edhe kënetat i than, edhe malet i sheshon! Kështu, ta dini!»

Këto thuheshin e fliteshin nëpër mezhdha, ku fshatarët shtroheshin e dridhnin një cigare, nëpër shtigjet, nëpër ara, në mbrëmje, kur ngjiteshin në fshat, në sheshin para këshillit, nëpër shtëpítë.

Likja mendonte më thellë pér këto dy aksione. Nga fshati duhej tē dilnin vullnetarë. Kish marrë vesh se nga Granishti, Guras i dhe fshatrat e tjerë rrötull duhej tē dilte një brigadë pér në Maliq, kurse dhjetë vullnetarë tē tjerë, — pér në rrugën Kukës—Peshkopi.

Ai takohej me tē rinjtë, rrihte punën me ta, u merrte mendimin. Porse dikush kish hedhur një fjalë tē prapë: «Ç'na duhet ne Kukësi e Maliqi! S'uа kemi ngenë! Ne kemi hallet tonë këtu, duhet tē nxjerrim bukën! Le tē venë qyletarët në ato punë».

Likja me tē rinjtë më tē mirë tē fshatit duhej t'i zinte ato gojë tē këqia, tē mos linte që ato tē villnin vrer.

Ai caktoi mbledhjen e rinisë pér ta shtruar çësh-tjen. Pas kësaj, do tē bëhej edhe mbledhja me po-pullin.

Likja ish si në ethë. Por ja, një ditë para mbledhjes, nga Granishti erdhi një sihariq: në mbledhjen e rinisë së Granishtit, ku kishin marrë pjesë edhe vajza, kishin dalë pesëmbëdhjetë vullnetarë pér në Maliq dhe katër pér në rrugën Kukës — Peshkopi. Midis vullnetarëve tē Maliqit, ishin edhe tri vajza. Thuhej se pas tē rinjve e tē rejave, kishin dalë vullnetarë edhe nja dhjetë burra.

Likes i dha zemër ky lajm. Ai u prengatit pér mbledh-jen.

Ndërkaq, Bajamja, sa i mori vesh tē gjitha këto nga i vëllai, vrapoi te Resmija.

— Dëgjo, moj, dëgjo ç'bëjnë çupat e Granishtit!  
— thirri ajo me nxitim.

— Çfarë?!

— Tri çupa dolën mbrëmë vullnetare pér tē pu-nuar në Maliq, pér tē tharë kënetën! Dëgjon?

— Tri çupa dolën vullnetare?! — u habit Resmi-ja, sikur nuk u besonte veshëve tē saj.

— Po, moj, po! Nuk kuption?! Është Burbuqja, e motra e përgjegjësit tē rinisë. A tē kujtohet? Ka ar-dhur njëherë në fshatin tonë; një çupë e shëndoshë, faqekuqe, me leshtra tē dredhura. Është, pastaj, e bija e kryetarit tē këshillit. Dhora i thënkëshin dhe një tjetër, nuk e di si e ka emrin, që e paska t'anë kapiten.

— Ç'thua, moj! — ja bëri përsëri Resmija.

— Ja, kështu si tē them, shkojnë vullnetare në

Maliq, bashkë me djemtë, dhjetë djem të fshatit!

— Çudi! — tha Resmija e menduar.

— Çudi, pa çudi, — u hodh Bajamja — ja, kësh-tu e bëjnë shoqet tona. Jo si ne që nuk dalim nga praku i portës!.. Të humburat e botës mbetëm ne!

Oshëtiu tërë fshati nga ky lajm. Vajza, gra, burra, pleq e plaka, thanë e përsëritën shumë gjëra. Vajzat e djemtë, thuajse të gjithë, e priten mirë, u gjëzuan, u dhanë të drejtë vajzave të Granishtit. Disa burra e gra nuk kundërshtuan, por ranë në mendime. Pati plaka, që corrën faqet e thanë: «Ptuh, ptuh! Çështë ky kiamet! U prish dynjaja! Korbat, korbat!»

Edhe në shtëpinë e Rexhep Lisi, siç u kthyen nga puna qytetaret, në mbrëmje, u ndez biseda për vullnetarët e Granishtit.

Afërdita pyeti Resmijen:

— Si thua, a bënë mirë që dolën vullnetare vajzat?

— Vajzat e Granishtit nuk janë mbajtur si të mbyllura. Ato kanë dalë e kanë punuar. Doemos, edhe vullnetare mund të dalin... — tha vajza.

— Po edhe ju nuk kini për të qëndruar në këtë gjendje — ja pat Afërdita. — Veç duhet të lëvizni një çikë vetë. Ja, kështu, siç vepruan granshtarkat. M'u lumtë atyre!

Atë mbërmje, Rexhep Lisi i pati më të rralla fjalët. Ai kish në kokë lajmin e ardhur nga Granishti. Afërditës i ra era. Ajo ja hodhi:

— Xha Rexhep, si shumë i menduar dukesh sonte... Ku të punon mendja, në vajzat e Granishtit, që do të shkojnë vullnetare në Maliq?

Edhe Rexhepi e kuptoi se ajo donte ta ngacmonte, prandaj iu përgjegj pak rëndë:

— Po, u bënë edhe ato të marrin rrugët, të shkojnë ku u do qejfi! U bë kungulli të marrë gardhin!. Kështu është. Po s'u vure kapistall vajzave e po s'i bëre zap, të turpërojnë..

Afërdita nuk mbeti pas:

— Nuk kanë për të turpëruar njeri, xha Rexhep,

ashtu si nuk u turpërua njeri nga partizanët, që luftuan maleve. Përkundrazi, ato u nderuan; edhe këto do të nderohen. — Pastaj, duke ndryshuar të folurit, i tha: — E, po si mendon, xha Rexhep, kështu të mbyllura në shtëpi, prapa kafazeve, do të mbeten tërë jetën vajzat tuaja?

Rexhepi e ndjeu veten të zënë ngushtë. Nuk dinte ç'përgjegje të jepte. Ai nuk donte të përgjigjej fare. Mirëpo nuk kish se si. Pyetja e Afërditës kërkonte përgjegje. Vajza po e vështronte drejt në sy, me një buzëqeshje të lehtë, dhe priste fjalët, mendimin e tij.

— Rexhepi tha me gjysmë zëri:

— Nuk i ka ardhur koha kësaj pune...

Afërdita ja priti:

— I ka ardhur, i ka ardhur koha, xha Rexhep. Ti e shikon dhe e kupton vetë. Veçse të vjen vështirë, të duket si turp. se të mban prapa zakoni i vjetër. Kjo është e vërteta.

Rexhep Lisi nuk foli më.

Heshtja e t'et solli një lehtësi në shpirtin e Resmijes.

\* \* \*

Likja mori gjithë masat për mbledhjen e rinisë në Guras. I lajmëroi të rintjtë një për një. Me disa prej tyre foli veçan.

Në mbledhje morën pjesë edhe qytetaret dhe i deleguari që kish ardhur enkas për këtë punë.

Likja hapi mbledhjen dhe tha shkurtimisht qëllimin e saj se do të bisedohej për aksionet e rinisë. Pastaj, e mori fjalën i deleguari, i cili theksoi rëndësinë e madhe të aksioneve për tharjen e kënetës së Maliqit dhe për hapjen e rrugës Kukës— Peshkopi. Ai tha se ish një nder për rininë që të derdhte djersën në këto aksione, ashtu si kish derdhur gjakun për çlirimin e vendit.

Pas të deleguarit, folën Violeta, Afërdita, Likja. Ky i shikonte bashkëfshatarët e tij drejt në sy, dhe fjalët e tij të thjeshta, por të zjarcta, sikur ua drejtonte e ua ngulte mu në zemër. Të rintjtë e dëgjonin me kujdes

dhe dukej se, më mirë se kushdo tjetër, kokën e tyre ua mbushte ai, Likja, sekretari i tyre.

Si mbaroi Likja, mbledhja ra në qetësi. Sikur askush nuk guxon te fliste, sikur te prisnin njëri-tjetrin.

Por kjo nuk zgjati shumë.

— Me leje — u dëgjua zëri i Hasanit.

Të gjithë u kthyen drejt tij.

— Folë, Hasan! — i tha Likja.

— Unë dal vullnetar për në rrugën Kukës—Peshkopi.

Mbledhja sikur mori frymë me një palë mushkëri.

— Të lumtë, Hasan! — ja priti Likja. — Ke përtë thënë gjë?

— Jo, nuk kam. Ç'është nevoja të them? — u përgjegj Hasan. — Puna është të dalim vullnetarë sa më shumë. Unë ftoj të gjithë shokët t'i përgjigjen thirrjes për në aksione.

Hasani sikur u kish hequr turpin; pas tij u ngritën e folën të rinj njëri pas tjetrit. Dolën, gjithsejt, tetë vullnetarë: dy për në rrugën Kukës—Peshkopi dhe gjashtë për në Maliq.

Në mbrëmje, punët u turbulluan në shtëpinë e Rexhep Listit.

— Përse qenke hedhur ti?! — iu drejtua Hasanit i ati, duke e vështruar me nofulla të shtrënguara dhe vetulla të mbledhura.

— Do të vete atje ku venë shokët...

— Të hanë brirët?

— Pse?

— S'paske punë e zanat që dashke ta lesh shtëpinë?

— E do puna.

— Po punët tonë këtu kush i bën, apo botë?

— Nuk do të mbeten pa u bërë edhe punët këtu:

— Hë, hë! Mos do të na i lesh të mbaruara pa të ikësh?!

— Në këtë kohë nuk kemi ndonjë punë të madhe këtu — tha djali. — Mbjelljet i mbaruam, për korrrjet do edhe një muaj e ca. Gjer atëherë unë kthehem.

— Punë të tjera nuk kemi? — u rëndoi fjalëve Rexhepi.

— Atyre u bën ballë vetë, ashtu si do të bëjnë edhe të tjerët.

Rexhepi ish skuqur. Ai ziente përbrenda. Por i biri e kish zënë në fjalë.

Hasani po e kuptonte se në ç'gjendje ish i ati. Ai, shtruar, ja ktheu:

— Po të mos vete unë, tjetri, tjetri, si mund të bëhen ato punë, baba, si mund të rindërtohet Shqipëria? Vetë nuk bëhen, duan njerëz.

Në këtë dyluftim midis Rexhepit dhe të birit, ish e pranishme edhe Afërdita, që, gjer atë kohë nuk kish folur. Duke dëgjuar me vëmendje, ajo ndërhyri në bisedë në çastin e fundit:

— Mirë thotë Hasani. Luftën e bëmë të gjithë së bashku dhe Shqipérinë e re, të begatshme e të bukur, së bashku do ta ngremë. A s'kemi ardhur për këtë punë në Guras edhe ne nga qyteti?

Rexhepi po lëshonte nofullat, po shrinte vetullat, ndërsa të kuqtë e fytyrës po i shpërndajahej.

Ai pa të birin, shikoi Afërditën, doli në oborr dhe ndezi një duhan.

\* \* \*

Vullnetarët u nisën e shkuan për në Maliq dhe në rrugën Kukës — Peshkopi. Siç u muar vesh, nga të gjithë fshatrat rreth e rrotull, ishin bërë disa dhjetëra veta. Përveç vajzave të Granishtit, për në Maliq kishin dalë vullnetare edhe dy vajza nga një fshat tjetër, nga Plava.

Nisja e vullnetarëve nga Gurasi u bë diçka si festë. Ata u mblohdhën te lëmi në mes të fshatit, me nga një torbë hedhur supit a krahëqafë. Dolën të gjithë të rinjtë për t'i përcjellë, si edhe të rinjtë e të rejat e qytetit, kryetari i këshillit, xha Kasëmi dhe disa burra të tjerë. Resmija dhe Bajamja i panë ata nga dhoma lart; që prapa kafazeve. Vullnetarët u nisën me këngë

në gojë — këngë partizane — dhe morën poshtë për tu bashkuar me vullnetarët e Granishtit. Gjer atje me ta shkoi edhe Likja. Resmija i ndoqi gjersa Hasani dhe Likja i humbën nga sytë.

... Tani Gurasi u dukej si ndryshe njerëzve; mendime dhe ndjenja të tjera kishin ata. Nafija, si kurdoherë, punonte e qetë dhe e heshtur, që në pikë të mëngjezit gjer vonë, si kishin rënë të tjerët për të fjetur. Por ajo shikonte se nuk ish më as koha e çupërisë së saj, as koha e aty e katër-pesë vjetë më parë. Ç'ne! Ato kohë kishin ikur e vajtur. Tani nuk i vënkeshe dot fre njeriu. Dhe, dale-dale, ndryshe e më ndryshe do të vinte koha...

Rexhep Lisi ziente përbrenda. Ikja e Hasanit sikur ja kish shthurur gardhin; lajmet për vajzat fshatare, që kishin shkuar vullnetare, e kishin turbulluar shumë. Ç'po bëhej kështu, or tungjatjeta?! Ëndërr ish kjo apo e vërtetë?! Jo, jo, nuk ish ëndërr! Kish marrë fërra uratën. Pak kohë më parë kishin dalë malit vajzat partizane, tashti, pa gjë të keq shkonin të punonin ku t'u shkrepte. E ku do të mbaronte kjo punë?! Kjo do të ngjiste edhe në Guras? Vallë e kishin humbur davanë burrat dhe baballarët? Ish ashtu siç thoshte Afërdita? Gratë barabar me burrat?.. E jo! Ai ish burrë me mustaqe, ish baba e kreua i shtëpisë! Nuk mund ta linte kurrë të bijën të bënte si ato mëndjelehat e Granishtit dhe të Plavës! Ama, baballarë që paskëshin.

Të tjera gjëra shkonte ndër mend Resmija. Asaj i buçiste koka dhe i diçan para syve njëqind e një gjëra. I kujtohej lufta, i përfytyroheshin partizanet, i vinin në vesh lajmet që vajzat e Granishtit dhe të Plavës kishin dalë vullnetare. Resmijes i dukej se diçka ish përmbysur, diçka tjetër ish krijuar, një erë tjetër po frynte. një diell tjetër po ndritte. Si në ëndërr, ajo shkontakte veten midis të rinxje e të rejave, që nxitonin, që punonin, që ja merrnin këngës, që ishin plot guxim e trimëri, që e ftonin të bashkohej me ta, të vente midis tyre t'ja merrte këngës edhe ajo, të punonte së bash-

ku. Po, po, të dilte jashtë atyre mureve, të thyente ato kafaze të dritareve, që i copëtonin qiellin dhe tokën, të rendte atyre luadheve, të mblidhë tufa lulekuqesh arave, të ndihmonte për të ndërtuar shkollën e fshatit...

... Në shtëpinë e Rexhep Lisit, Afërdita vazhdonte t'u mësonte vajzave leximin dhe shkrimin. Kohët e fundit, ishin shtuar edhe dy të reja, dhe ishin bërë gjithsejt shtatë. Veç mësimit, Afërdita u fliste edhe për gjëra të tjera: si venin punët në vendin tonë, se e udhëhiqte partia popullin për një jetë të re; për gjendjen ndërkombëtare... Këto takime të vajzave ishin si mbledhje të një organizate të veçantë të rinisë, vetëm me të reja. Me gjërat që kishin mësuar, disi kishin ndryshuar vajzat, sikur ishin bërë më të zgjaura e më të shkathëta.

Rexhep Lisit i dukej sikur shkelte mbi gjëmba. Në shtëpi kish mbetur si i shkretë. Ai ish i vetmi burrë në atë shtëpi, që gumëzhinte si koshere nga hyrje-daljet, nga fjalët dhe punët e gjithë atyre femrave. Atij i vin te sikur ato po e mbytnin. Njëherë, i tha së shoqes:

— Mor, po ç'bëhet kështu, moj grua?! Sikur po na thithin gjakun këto, si ndoca shushunja! Ç'kanë ashtu?!

— E, or burrë! — ja bëri Nafija. — Ka ardhur koha e tyre; koha e tyre!..

Likes i punonte mendja larg. Ai donte të çante akullin, të thyente prangat e vjetra dhe t'i nxirrte vajzat jashtë, t'i tërhiqte në mbledhjet me të rinjtë, t'i hidhte në punë për të ndihmuar në ndërtimin e shkollës, tanë që nga fshati ishin larguar tetë të rinj, tetë krahë punë. Këtë detyrë i kishin ngarkuar Likes edhe në mledhjen e organizatës së Partisë në Granisht, ku ai bën te pjesë. I kishin thënë, gjithashtu, se për të ndihmuar në këtë punë, do të vinin në Guras dy a tri vajza nga Granishti.

Likja bisedoi për të gjitha këto me Afërditën dhe vajzat e tjera nga qyteti. Ata vendosën të fillonin t'u flisin më hapur të rejave të Gurasit, sidomos atyre, që mblidheshin për të mësuar; por edhe të tjerave duhej

t'u venin qytetaret nëpër shtëpitë dhe t'i shkundnin nga gjumi. Në mënyrë të veçantë, Likja porositi Afërditën të kish kujdes Resmijen.

— E, moj Resmije, — i tha një ndajnatë Afërdita, siç ishin mbledhur të tri qytetaret, bashkë dhe me Bajamen. — a do të dalësh në mbledhje?

— Të dal në mbledhje? Po im atë?!

— Lëre atë — vazhdoi Afërdita. — Ti a do të dalësh?

— Unë, — tha e menduar Resmija — unë dua, po të dalin edhe shoqe të tjera...

— Ja, unë do të dal e para — u hodh e tha Bajamja. Zenepeja është e dyta...

— Zenepeja?..

— Po! — theksoi Bajamja — Zenepeja. Edhe të tjera do të dalin.

— Edhe unë vij — tha me guxim Resmija. — Dua të vij, veç kam frikë nga im atë...

— Hiç mos ki frikë! — u hodhën Bajamja dhe Afërdita.

Bajamja vazhdoi:

— Di si më tha Likja? « I thuaj Resmijes se me t'a-në e rregulloj unë. Ta flerë mendjen ajo».

— Edhe mua kështu më tha — shtoi Afërdita. — Likja dhe unë do t'ua mbushim mendjen të gjithë atyre të cilëve nuk po u mbushet.

Ditën tjetër, në Guras erdhën dy vajza nga Graniqisti. Të dyja shtathedhura, njëra bardhoshe, tjetra flokëgështenjë, me nga një fustan prej basme e nga një dylbene të bardhë në kokë. Me to ish edhe vëllai i njerës.

Do të bëhej mbledhje me vajzat e Gurasit. Thanë të mblidheshin në shtëpinë e xha Kasëmit, por kjo nuk u gjend me vend. Donin të merrnin në mbledhje edhe Resmijen, prandaj nuk mund ta bënin atje, nuk mund të hynte çupa në shtëpinë e dhëndrrit, pa u bërë martesa. Likja bisedoi me të vëllanë e Zenepes, që ta bënin mbledhjen në shtëpinë e tyre. Kështu mbeti. Me

anën e Bajames dhe të Afërditës, Likja i dërgoi fjalë Resmijes që të vente në mbledhje me doemos. Me të ëmën do të merreshin vesh. I ati, hëpërëhë, nuk duhej të dinte gjë. Shtëpia e Zenepes nuk ish larg asaj të Rexhep Lisit. Afërdita dhe Bajamja do të merrnin Resmijen dhe do të shkonin bashkë.

Kështu dhe u bë. Nafija në fillim kundërshtoi, u tremb, por, më në fund, mbeti si e tulatur dhe pshëritiu thellë, kur pa të bijën të dalë nga shtëpia me dy vajzat e tjera.

Në mbledhje ishin katër vajza nga Gurasi: Bajamja, Zenepeja, Bahrija dhe Resmija. Ishin, gjishashstu, Likja, i vëllai i Zenepes, një djalë i hollë si stap, dy vajzat nga Graniشتët dhe tri qytetaret.

Likja e mori fjalen i pari:

— Ne po bëjmë për të parën herë një mbledhje të tillë, ku marin pjesë djem dhe vajza. Po, djem dhe vajza nga fshati ynë! — theksoi. — Hë? Duket si e çuditshme! Dhe vërtet, një mbledhje si kjo, kështu fshehumrazi, që të mos na marrë vesh njeri, është e çuditshme sot kur ne jemi të lirë në vendin tonë. Por kjo punë nuk ka për të vazhduar kështu...

Likja tha se kish ardhur koha të dilnin në mbledhje e në punë pa drojtje, pa frikë nga askush, se asnjeri nuk mund t'i pengonte. Ata kishin me vete gjithë organizatën e rinisë, kishin Partinë. Krahët e tyre ishin të ngrohta.

Fjalët e Likes i mbështeti Afërdita:

— Po, po, mirë e tha Likja: erdhi koha të veprojmë. Kështu duhet të bëjmë, se vetëm kështu mund të fitojmë të drejtat tona. Kështu bënë edhe partizanët, kështu po bëjnë edhe vajzat e fshatrave të tjera. Ta shkelim fanatizmin! Ta shkelim frikën!

U hodh Bajamja:

— Unë jam e para, motrani, që do të dal në mbledhje dhe në punë. Ja, — vërtiti ajo pëllëmbën e dorës — bota sikur të përmbyset, do të dal!

Resmija buzëqeshi.

Zenepeja pasoi Bajamen:

— Me ty më ke, Bajame. I kam dhënë karar edhe unë. Ç'të bëhet, le të bëhet!

Po flisnin të gjitha vajzat, përvec Bahrijes dhe Resmijes, e cila kish mbetur si e trulloosur. Kokën e kish si të mbushur me mjegull; e ndjente veten nga njëra anë disi të çliruar, nga ana tjetër kish frikë se mos e merrte vesh i ati, dhe kushedi ç'mund të ngjiste.

Foli për sëri Likja, duke iu drejtuar katër vajzave të fshatit, por duke vështruar kryesisht Resmijen dhe Bahrijen.

— E dini ç'është? Ju duhet të dilni në punë. Po, po, të dilni për të punuar jashtë shtëpisë! Bile menjëherë, që nesër. Kështu do ta hidhni hendekun. Pa nuk mjaf-ton të merrni pjesë një a dy herë në muaj në mbledhje. Duke dalë në punë, do të luftohet fanatizmi, «do të thyhet këmba e shejtanit», kur thonë plakat. Atëherë, do të vini më kollaj edhe në mbledhje. Kështu është.

Njëra nga vajzat e Granishtit, ajo bardhoshja, ja bëri:

— Mirë thotë. Të dilni në punë. Kështu e filluam edhe ne. Kështu na u bindën më shpejt prindërit. Kjo dha dorë që tri vajza nga fshati ynë dhe dy nga Plava të shkojnë në aksionin e Malikit. Po nuk morët vetë guxim, nuk kini gjë në torbë.

Resmija po dëgjonte Bardhoshen; mendja i shkon-te tek i ati, por vështrimin e kish te Likja. Ai atë ditë dukej shumë i hieshmë dhe i gjallë. Sytë i nxinin si kokrra ulliri, baluket e dredhura i binin mbi ball, mustaqet e holla i shkonin shumë. Kur fliste, asaj i dukej sikur nxirrte mjaltë nga goja. Dhe ajo ish gati të bënte ç't'i thoshte ai.

Likja herë e shikonte Resmijen drejt në sy, herë i hidhte një shikim têrthorazi. Ai e kish parë vetëm disa erë për së largu. Kurse tanë, aty përballë tij, si e vuri re çdo gjë të sajnë, fytyrën me lëkurë të lëmuar, qepallat e dendura, qafën e derdhur si prej farfurie, i lindi një dëshirë e flakët, sikur të gjithë të

iknin dhe t'i linin vetëm, atë dhe Resmijen; t'i vente pranë, t'i merrte duart topolake në duart e tij, t'i thoshte se sa shumë e donte dhe t'i puthte ato buzë të kuqe!

Kur mbaroi së foluri vajza nga Graniشتë, u hodh e tha Bajamja:

— Ta presim shkurt: unë që nesër do të dal në punë. Do të vete të punoj bashkë me Violetën Shpresën dhe Afërditën. Hë, kush vjen me mua? Folë, Resmije, folë Bahrije!

Vajza tjetër nga Graniştë tha:

— Hëni, mos u mendoni, se do t'ju vijmë në ndihmë edhe ne të dyja bashkë me katër djem nga fshati ynë për ndërtimin e shkollës. Mori vendim organizata jonë. Ta mbaroni shkollën sa më parë.

— Dëgjoni? — tha Likja. — Ja ku kini edhe dy shoqë nga Graniştë. Turp, turp vërtet, të vijnë çupat e Graniştit të na ngrenë shkollën, kurse tonat të rrinë e të bëjnë sehir prapa kafazeve! Ç'na mbetet neve pastaj?

Pas Likes, foli Zenepeja:

— Unë e thashë dhe qëpari. Do të dal që nesër, siç tha Bajamja.

— E, moj Resmije? — tha Likja, duke vështruar drejt vajzën, e cila u skuq. — Ç'thuai ti?

— Jo, Like, jo — ja bëri ajo me drojtje. Nuk e jap dot fjalën. Kushedi ç'mund të bëjë im atë!...

Kështu tha ajo me gojë, por me zemër kish zili guximin e Bajames dhe të Zenepes.

As Bahrija nuk dha ndonjë premtim. Mbledhja mbaroi me kaq. U ngritën të gjithë. Zenepeja dhe i vëllai i përcollën të tjerët te praku i portës. Afërdita dhe Bajamja e shoqëruan Resmijen. Likja u vajti pas. Në qoshën e rrugës, ai iu afrua vajzës. Dy të tjerat, me qëllim, bënë pak përpëra. Likja i shtrëngoi dorën Resmijes dhe i tha në vesh:

— Resmije, mos ki frikë! Unë gjithnjë për ty mendoj. Do t'ja kthej mendjen xha Rexhepit. Në

mos, di ta bëj dhe ndryshe. Tani, unë përgjigjem për çdo gjë...

Kur Likja i shtrëngoi dorën, Resmija ndjeu një të rrënqethur, që i pëershkoi gjithë trupin. Ish një rrënqethje ë ëmbël dhe tronditëse. Ajo i dëgjoi të gjitha ato që i tha ai, pastaj murmuriti:

— Ik, o Like, mos na shikojë njeri!

Shkëputi dorën nga e tija, nxitoi dhe u bashkua me Afërditën dhe Bajamen.

Në shtëpi atë e priti stuhia. Rexhep Lisi ish kthyer nga puna. Ai kish pyetur të shoqen pér Resmijen, por kjo kish bërë sikur nuk e kish dëgjuar dhe ish larguar. Kur hynë vajzat, e gjetën atë në oborr. **Ai** zgurdulloi sytë, kur pa midis të tjerave, të bijën.

— Ku ke qenë ti?! — iu drejtua asaj me kanosje.

Resmija nuk foli, po u bë flakë në fytyrë dhe mori të hynte në trem. Rexhepi, i nxehur edhe më shumë, i thirri:

— Ty, moj, po të them! Ku ishe?! Nga po vjen?!

Resmija nuk iu përgjegj as kësaj radhe. Ndërhyri Afërdita:

— Ishim te Zenepeja, xha Rexhep. Vajtëm të tria...

— Ç'është kjo Zenepe! — ja bëri tjetri, me damarët e qafës të fryrë. — Nga vete e bredh?!

— Te Zenepeja e xha Osmanit... — ndërhyri Bajamja.

— Mos më trego ti Zenepe e xha Osman! I di unë shumë bukur! — tha përsëri me zemërim Rexhepi, por, pastaj, e përmbarjti veten, i hodhi një vështrim së bijës që po ngjitte shkallët dhe vetë hyri në dhomë.

Për darkë Resmija nuk zbriti poshtë; as Afërdita. Vajza i ruhej t'et. Rexhepi ja përplasi tërë dufin së shoqes.

— Ti, moj, ti ku je?! A rron në këtë shtëpi apo je e vdekur?! Si e le të shkojë, moj? Si e le?!

— Unë nuk e pashë kur iku — gënjeu Nafija.

— Nuk e pe?! Po pastaj nuk e more vesh që çupa nuk ish në shtëpi?!

— Ja, njëmëthi, para se të vije ti e mora vesh, por nuk dija se ku kish vajtur.

— Nuk e dija se ku kish vajtur! — e përqeshi Rexhepi.

— Avash, o burrë, mos thirrë kështu se na dëgjon bota — tha qetë Nafija. — Është edhe tjetra lart...

— Hëm! — shkreptiu Rexhepi. — E di unë kush m'i bën këto! Ajo, ajo qytetarja! Po flasin njerëzia se duan të na i nxjerrin çupat në mbledhje me djemtë. Mos e ka shpënë Resmijen në ndonjë mbledhje të tillë?! Pa dale, do t'i vete Kasëmit e do t'i them të ma heqë nga shtëpia! Po! do t'i them!

Vajzat, në dhomën lart, po mbanin vesh. Ato dëgjonin potere, herë-herë kapnin disa fjalë, herë nuk kuptionin gjë. Fjalët e fundit të Rexhepit u dëgjuan qartë. Afërdita i tha Resmijes:

— Do të zgres të bisedoj me tët atë. Ti rri këtu. Ajo hyri në dhomë.

— E paske prishur gjakun sot, xha Rexhep — foli shtruar.

Tjetri nuk bëri zë. Nxori kutinë e duhanit, e hapi dhe zuri të dredhë një cigare. Nafija po e shikonte vajzën me një farë përdëllimi, sikur priste ndihmën e saj. Afërdita i shkeli syrin dhe i buzëqeshi.

— E di, xha Rexhep, e di se ku e ke hallin — vazhdoi ajo duke iu drejtuar të zotit të shtëpisë, i cili po rrinte kokë varur. — Mos u bëj më kaq fanatic, hiq dorë nga zakonet e vjetra të dëmshme. Shikon si po dalin vajzat e botës, në Granisht, në Plavë e në fshatra të tjerë, shkojnë në punë, në mbledhje, venë dhe gjer në Maliq, për të punuar?

Në këto fjalë, Rexhepit filloj t'i ndizej koka. Damarët anës së ballit nisën t'i rrabin fort. Si shumë mend po i shiste kjo pispiluke e qytetit. Shumë në

hundë po i hynte ajo. Nuk mund t'ja mbante më tej.

— Dëgjo, moj Afërditë — i tha asaj. — Unë nuk shikoj se ç'bën bota. Le të bëjnë ç'të duan ata! Çdo dele varet nga këmba e saj. Unë të lutem shumë, mos m'i bjerë çupës në qafë, mos ma nxirr andej-këtej, mos kërko të ma shpiesh nëpër mbledhje; — përfundoi ai, duke u mëshuar fjalëve të tij.

Nafija kujtoi se këto fjalë do ta kishin prekur Afërditën. Ajo tha:

— Ç'janë këto mbledhje, or burrë! Mos u zemëro me Afërditën.

Rexhepi e pa shtrembër të shoqen. Atij nuk i pëlqeu fare ndërhyrja e saj.

— Ti hesht! Rri atje ku je! — thirri ai. Pastaj i tha: — Pa shiko sill këtu tët bijë, ta fjalos si duhet, se nuk ja shkoqita punën.

Nafija nuk deshi që sherri të ndizej më keq.

— Lere, tani, ç'ta zgjatim më tutje.

— Shko, sille, të them unë! — ngulmoi ai.

Nafija nuk kundërshtoi më. Ngjiti shkallët pa bërë zhurmë, i vajti së bijës, e cila po dëgjonte ato që po ndodhnin poshtë, e këshilloi të ish e përbajtur kundrejt t'et e të mos tregonte se kish qenë në mbledhje, pastaj të dyja zbritën në sobë.

— Në mbledhje ishe? — iu drejtua Rexhepi me të rreptë së bijës, sapo e pa.

— Jo — iu përgjegj kjo dhe u ul në një karrigë, më sytë përdhe dhe duart në pëqi.

— Mos gënje! Trego të vërtetën!

U hodh Afërdita duke parë se Rexhepi po merrte shumë zjarr.

— Xha Rexhep, shtroje gjakun — tha ajo me të butë. — T'i lemë këto tani.

Mirëpo Rexhepit po i lëshonte koka tym.

— Nuk të pyeta ty! — iu kthyë asaj. — Këtu është puna jonë, është familja jonë! Neve na përket çdo gjë!

Afërditës nuk i pëlqeu kjo sjellje. Nga ana tjetër,

nuk mund ta linte Nafijen në baltë. I duhej folur pak ndryshe Rexhepi.

— E di, xha Rexhep, e di ç'do të thuash. Ti kërkon të më ngarkosh me faj mua. Ti do të më heqësh edhe nga shtëpia. Po, po! E dëgjova me veshët e mi. Por nuk e ke mirë kështu. Unë jam vajzë e re, ti je babai im, por po ta them me zemër të hapur: nuk e ke mirë.

Rexhepi, kur pa se Afërdita i kish marrë vesh fjalët dhe qëllimin e tij, mbeti si i turpëruar. Nuk i erdhi mirë që tjetra i dinte ato; ndjeu një shqetësim, një tronditje.

Kjo u ra në sy të tjerëve. Nga përgjegjja që Afërdita i kish dhënë babait të saj, Resmija u mbush me guxim, me një fuqi të atillë sa, po të vazhdonte kjo grindje, do të fliste edhe ajo si duhej, pa frikë.

Rexhepi nuk deshi ta dorëzonte veten me kaq, por duke i bërë bisht dyluftimit me Afërditën, iu drejtua përsëri së bijës:

— Më thuaj ku ishe. Te Zenepeja apo gjetkë? Dhe, në goftë se ishe te Zenepeja, përse vajte atje, për mbledhje? Hë, folë! Ty të pres!

Resmija ndjeu se kish ardhur një çast vendimtar. Kjo punë kish marrë tashmë rrugën e saj. Në mos sot, nesër, çdo gjë do të dilte në shesh. Nuk mund të mbahej fshehur tërë jetën. Le të bëhej ç'të bëhej! Një orë e më parë, aq më mirë. Pastaj, nuk ish vetëm, kish shoqe, kish me vete të ëmën, kish, sidomos, Liken pér mbrojtje. E zemëruar, e hidhëruar edhe pér mënyrën me të cilën i ati i kish folur Afërditës, ajo iu përgjegj:

— Në mbledhje isha, po! Bashkë me shoqet...

Duke dëgjuar përgjegjen e së bijës, Nafija çakëriti sytë dhe mbeti si e ngrirë. Edhe Afërdita u habit dhe u kthyte nga Resmija. Po, përbrenda saj, ndjeu një gëzim. Po shikonte se kish përpëra një tjetër Resmije, guximtare e të vendosur, që po shkelmonte atë jetë të ndryshkur të saj dhe po hidhej përpëra si trimëreshë, drejt shpëtimit, drejt dritës.

— Si the, moj?! Ishe në mbledhje?! — bërtiti i ati dhe brofi më këmbë.

U ngritën edhe gratë. Rexhepi eci drejt së bijës. Në mes të tyre, hynë Nafija dhe Afërdita. Resmija hapi derën dhe mori shkallët përpjetë. Atë e ndoqi pas Afërdita.

\* \* \*

Për ndërtimin e shkollës, të nesërmen, bashkë me të tjerët, dolën edhe Bajamja dhe Zenepeja. E dhën nga Granishti edhe të rinjtë e të rejat, si kishin thënë në mbledhje. Likja, si u muar ca me njerëzit në shkollë, u nis të takonte Rexhepin. Ai i kish mësuar nga Afërdita të gjitha ato që kishin ndodhur natën e shkuar.

E gjeti Rexhepin tek po prashitte misrin. Pa e zgjatur shumë, hyri në thelb të bisedës:

Mora vesh ca gjëra, që paskan ngjarë mbrëmë, xha Rexhep.

Tjetri bëri sikur nuk kuptoi, ndonëse e dinte se ku i dhimbte dhëmballa djaloshit.

— Përse e ke fjalën? — pyeti.

— Xha Rexhep, nuk bën mirë që sillesh kështu me Resmijen — tha Likja. — Iku koha e baba Qemos... Eja të shikosh atje në shkollë... sot kanë dalë në punë ime motër dhe Zenepeja e xha Osmanit.

Rexhep Lisi po e vështron te dhëndrrin me kujdes, duke u mbështetur me të dy duart mbi bish-tin e shatës.

— Nuk mbahen më të kyçura vajzat, xha Rexhep,  
— vazhdoi djali. — Duhet të fitojnë lirinë edhe ato...

Rexhepi ja priti:

— Nuk të jap hesap ty! Kështu dua, kështu bëj!  
Eshtë hesapi im! Ti me tët motër dhe tjetri me të bi-jën bëni ç'të doni!

I hipit në kokë edhe Likes:

— Edhe pér Resmijen më takon mua të flas! Unë

jam i fejuari i saj. Mos ki merak se bëhet me fjalë.  
Nuk e gjen gjë as atë, as ty.

Rexhepi nuk mbeti prapa:

— Por ajo èshtë në shtëpinë time! Kur ta marrësh,  
atëhere, fundja, mund të bësh si të duash. Tani, ajo  
duhet të bëjë si ta urdhëroj unë, babai i saj!

— Dëgjo, xha Rexhep, ta presim shkurt. Ti po  
vazhdoive të mbash këtë rrugë, unë e marr që nesër  
Resmijen, pa shumë saltanete. Bëjmë celebrimin dhe  
mbaroi puna! Ja, kështu!

Rexhepit iu duk sikur i dhëndrrri i ra një grusht  
turinjve. Ai gjëmoi.

— E merr, po të ta le unë siç thua ti! Ç'u bë, ore?!  
Ndonjë pulë që ta rrëmbesh nga koteci? Martesa do  
të bëhet si e do puna, dhe jo hajdutçe!

— Siç po sillesh ti — ja preu Likja, — puna e  
do që kështu të bëhet, të mos presim më, por ta  
marr vajzën dhe të kurdisim dasmën. Të shpëtojë  
ajo nga shtypja. Ti, po deshe, eja në dasmë, po s'de-  
she, rri! Ajo ka për të qenë gruaja ime, dhe gruan  
time unë nuk do ta lë si zogun në kafaz. Ky èshtë fun-  
di i fjalës!

Likja i ktheu krahët Rexhepit dhe, duke shke-  
lur nëpër vijat e arës, iku me nxitim. Tjetri mbeti  
ashtu si më këmbë, me shatën në duar, duke vështruar  
të dhëndrrin që po largohej dhe duke ndjerë kokën  
të renduar nga një turbullirë, që kish lindur prej  
kësaj ngatërrrese, ku kishin hyrë punët.

Tërë ditën e ditës, Rexhep Lisi nuk e pati me-  
ndjen në punë. Ai i binte shatës, por mendja i flutu-  
ronte gjetkë. I trullosur, siç ish, u binte misrave dhe  
këputi disa prej tyre. Njëherë, mënt ja futi këmbës  
me shatë. Hej, ç'i kish pjellë! Hej, në ç'bekra që e  
kish futur ai, i dhëndrrri!

Vajti në shtëpi tërë hundë e buzë. E shoqja e vu-  
ri re, por nuk e shpoi. Ja dinte huqin.

Atë mbrëmje, Resmija u shti e sëmurë. Nuk i doli  
përpara Rexhepit as ajo, as Afërdita. Likja i kish tre-

guar késaj se si ish përfolur me tē vjehrrin, e kish positor tē vinte nē lijeni Resmijen dhe t'i thoshte se, po tē vazhdonte i ati tē ngulte këmbë nē tē tijat, ai do ta merre nē shtëpi pa një pa dy dhe do tē bënин martesën. Ajo nuk duhej tē trembej, as tē ngurronte. Për çdo gjë, do ta njoftonte Afërdita. Bashkë me këtë, tē vente nē shtëpinë e tij, kur ta lajméronte.

Të dy vajzat këto gjëra kishin nē gojë. Në fillim, Resmija u trondit pak nga ato që i tha Afërdita. Pastaj, gjaku iu shtrua. A'jo iu bind shoqes së saj, iu bind porosisë së Likes.

Kurse poshtë nē dhomë, pas një heshtjeje tē gja-të, Rexhep Lisi i tha së shoqes:

— A e di ç'më ka ndodhur sot me Liken?

— Çfarë?

Rexhepi ja kallëzoi tē gjitha. Nafija u hidhërua. Zemra nisi t'i rrahë më shpejt. Pse tē ndodhnin këto nē shtëpinë e saj? Pse t'i mbante bota nëpër gojë? Le pa, nuk kishin as Hasanin që së bashku t'i flisnin e tē mundoheshin t'i mbushnin mendjen tē shoqit që tē lëshonte udhë, tē mos bënte ndonjë turp, se dëm do tē kishin e jo fitim.

— Hë, mor burrë, — tha Nafija, duke psherëtirë — nuk kanë lezet këto zënka, nuk ka lezet që dhëndrri tē na e rrëmbejë çupën, ose tē mos ja japim. Nuk jemi turpëruar ndonjëherë, që tē turpërohemë kësaj radhe. Të bëjmë punën siç ka hije. Fundja, gruaja e tij është dhe tē bëjë ç'të dojë me tē...

Ajo priste që i shoqi t'i përgjigjej, ndofta ai do t'i shfrynte dhe do t'i kanosej. Por Rexhepi nuk hapi gojë. Ai mbeti këmbékryq mbi këndin dhe treti vështrimin nē tymin e duhanit që kish mbushur dhomën. Nafija po e vështronte, dhe po i vinte keq për tē.

...Edhe Likja nuk ish i qetë atë mbrëmje. Ai kish vendosur tē bënte ashtu siç i kish thënë Rexhepit. Si përgjegjës i rinisë, ai donte që në Guras tē copëtosheshin fare ato leqe që u mbanin këmbët lidhur vajzave. Atë që kishin bërë Bajamja dhe Zenepeja,

duhej tē bënин тē gjitha; dhe, sidomos, duhej ta bënte Resmija, e fejuara e tij. Duke nxjerrë nē punë e nē mbledhje Resmijen qysh tani, kur ende nuk ish martauar, kjo do t'i linte mbresë tē madhe gjithë fshatit, do tē shtynte shumë vajza, që ishin thuajse gati pér tē dalë nē punë e nē mbledhje, tē merrnin guxim, t'ua kérkonin me ngulm këtë prindérve tē tyre dhe ta kaperxenin prakun e shtëpisë. Kështu mendoi Likja.

Ai i tha t'et:

— Nuk zvarritet më kjo punë, baba. Ose ta lërë xha Rexhepi Resmijen tē dalë nē punë bashkë me Bajamen dhe tē tjerat, atje nē shkollë, dhe ta bëjmë dasmën mirë e bukur, ose, pérndryshe, e mora Resmijen qé nesér. Ja, këto t'i vesh e t'ja thuash. Unë më nuk piqem me tē. Ja thashë ç'kisha pér t'i thënë.

Xha Kasëmi, një burrë mbi tē pesëdhjetat, mesatar nga trupi, me fytyrë tē rreshkur, flokëzbardhur, me sy tē thellë, që dukeshin sikur ishin gjithnjë nē mendim, e gjeti me mend se ashtu duhej vepruar.

Që nē mëngjez herët, ai i doli Rexhepit nē udhë, kur ky ishi nisur pér tē prashitur. Edhe xha Kasëmi kish hedhur një shatë nē sup. Rexhepi po zbriste kokulur me setren krahëve, me takien nē majë tē kokës, duke hedhur ngadalë hapat e tij tē mëdhenj. Nuk pa krushkun, veçse kur ky i foli:

— Mirë mëngjezi, o Rexhep!

— Mirë mëngjezi, Kasëm! — ja bëri tjetri, dhe sikur i erdhi e nuk i erdhi mirë kur vuri re pérpara tij krushkun.

— Do tē prashitetsh, o Rexhep? — pyeti Kasëmi.

— Dhe pa pritur përgjegje, vazhdoi: — Edhe unë kam dalë tē prashit ca misrin.

Në fund tē fshatit, udha e tyre ndahej. Por xha Kasëmi i mbajti këmbét dhe i tha krushkut tē tij:

— A rrimë pak nē këtë ledh, ta dredhim një herë?

U ulën nē lëndinë. Aty pérpara shkonte një vijë uji. Dielli sapo kish zënë tē dilte. Frynte një puhi e freskët. Xha Kasëmi nxori kutinë e duhanit nga xhepi

i potureve prej shajaku tē zi dhe ja zgjati Rexhepit.  
— Dridhe.

Tjetri mbushi një fletë me duhan, pastaj ja ktheu kutinë xha Kasëmit. E drodhi edhe ky. Rexhepi ndez i eshkën dhe ja dha së pari krushkut. Cigaret zunë tē tymosin.

Ja nisi xha Kasëmi:

— E di, o Rexhep, që je në një hallë, e di... Ky hall më ka zënë edhe mua... Miq kemi qënë, krushq u bëmë, s'ka ku tē vejë më mirë... Por... ja që na dalin kleçka dhe avaze... E solli koha... Dhe, ç'është e vërteta, kohës s'paske ç'ti bësh...

Me atë tē folurën e tij tē urtë e tē matur, me fjalët që i thurte pér bukuri, xha Kasëmi i dha tē kuuptojë Rexhepit se ku qëndronte puna.

Rexhepi nuk pati fuqi t'i kundërshtonte. Zemra nuk i epej, por buzët nuk i lëviznin dot pér t'ja prishur xha Kasëmit. Ai tundte kokën një herë andej, një herë këtej, dhe nxirrte shtëllunga nga goja.

Më në fund, dy burrat u ngritën. Tek po ndahe-shin, Rexhepi tha:

— Nuk tē them dot gjë, Kasëm. Nuk tē them dot gjë, jo! Edhe ti nuk e ke keq, por, ama, tē bëj dhe një gjë tē tillë, nuk e gjej dot atë fuqi...

Iku secili në punën e vet.

Rexhep Lisi nuk e ndjeu veten mirë atë ditë. E zuri koka. I dukej sikur e kish rrashur njeri me dru. Nuk punonte dot.

U kthyte në shtëpi afër drekës. Kur e pa Nafija, u çudit dhe u tremb. Asaj i shkoi ndër mend se i shoqi xheç kish. Nuk dukej mirë. E pyeti:

— Përse u ktheve që tanë, o burrë? Ç'ke?

— S'mund. Më dhemb koka, më shpojnë kockat, më vijnë si ethe. Do tē shtrihem. Më sill jorganin.

Ai ra në kënd. Ndenji ca ashtu i shtrirë, por nuk qëndroi dot shumë. U ngrit ndenjur dhe drodhi një duhan. I thirri së shoqes:

— Më bëj një kafe.

Resmija zbriti që lart në dhomë, u kujdesua përt'anë, por ky nuk ja zgjati, duke iu përgjegjur shkurt se ish i sëmurë.

...Në mbrëmje, Afërdita i solli Resmijes fjalë të reja. Likja i kish thënë se të nesërmen ajo duhej të dilte me doemos në punë. Ai kish biseduar me babanë e vet. Ky i kish folur xha Rexhepit. Pra, po të kundërshtonte a ta pengonte i ati, ajo të mos kthehej në shtëpinë e saj, por të vente tek ai. Po, kështu do të bëhej. Të vente me rrobat e trupit, pa marrë asgjë. Nuk kish rrugë tjetër. Po ta donte, ajo nuk duhej të ngurronte aspak.

Të dy shoqet kuvënduan për këtë punë tërë natën e natës. E kthyen mbarë e prapë. Resmijes nuk i vinte mirë që po përfundonte kështu puna, por ajo e pa se nuk kish nga t'ja mbante.

Të nesërmen, të dy vajzat u ngritën shumë herët. Nafija ish çuar para tyre. Rexhep Lisi po bënte një gjumë të rëndë.

Afërdita i tregoi Nafijes se ku qëndronte puna. Gruaja u step, fytyra sikur iu bë edhe më e bardhë dhe tha me buzë të dredhur:

— Ç'na gjeti, moj bijë, ç'na gjeti kështu!

— Nuk ju gjeti gjë, teto Nafije, — i tha Afërdita. Të gjitha do të rregullohen. Çdo gjë do të shkojë mirë. Dëgjomë mua. Dhe po të pyesë xha Rexhepi — vazhdoi ajo — ja thuaj troç të gjitha, mos ja fshih.

Vajzat dolën nga shtëpia. Atje në shkollë, i prisnin shoqet dhe shokët, i priste Likja. Ky u gjuar pa masë. Resmija filloj punën bashkë me të tjerat. Muret e shkollës ishin ngritur mjaft.

Rexhep Lisi u zgjua i mbytur në djersë. Ai thi-rrri me zë të ngjirur:

— Grua, grua, eja të më fshish se kam dërsirë!

Nafija i vajti shpejt e shpejt pranë dhe i fshiu kurzin, kraharorin dhe sqetullat me një shami të madhe. Pastaj i bëri një kafe dhe e pyeti si e ndjente vreten. Ai përtoi t'i përgjigjej, megjithatë, i tha:

— Ashtu, një hesap.

E piu kafenë dalëngadalë, duke thithur duhanin, me trup atje, por me mëndje gjetkë. Nafija po rrinte në cep të dhomës dhe po ndiqte me kujdes çdo lëvizje të tij. Ajo vinte re se, brenda një dite, i shoqi ish do-bësuar shumë, ish tretur. Në buzët dhe poshtë syve, kish nga një shirit të zi, sytë i ndritnin si të një njeriu me ethe, fytyra i ish zverdhur.

Rexhep Lisi, duke ndjerë se një qetësi e madhe kish rënë në të gjithë shtëpinë, pyeti:

— Resmija ç'bën?

Nafija nuk pandehu se fjala pér Resmijen do të vinte kaq shpejt. Si të bënte? Ta gënjente të shoqin? T'i thoshte se edhe vajza ish pa qejf dhe nuk ish ngri-tur nga shtrati, apo t'i tregonte të vërtetën? Ngurroi pak. I shoqi e pyeti përsëri:

— Ç'bën Resmija, të thashë!

Nafija vendosi t'i kallëzojë të vërtetën.

— Dëgjo, o burrë, por mos e prish gjakun! Pér kokën e fëmijëve!... Të mos bëjmë turpe, të mos na qeshë bcta... Se je dhe i sëmurë...

— Folë, moj folë përse të pyeta!

— Ç'të tha dje xha Kasëmi? — pyeti Nafija të shoqin, në vend që t'i përgjigjej.

— Ç'na fut këtu xha Kasëmin?!

— Kësaj pune, o burrë, duhet t'i japim fund. Me-që edhe xha Kasëmi është i një mendjeje me të birin, ashtu ta bëjmë. E, paç jetë, mos ua prish atyre, të mos prishim dhe qetësinë e nderin e shtëpisë...

Rexhep Lisi po shikonte se edhe e shoqja ish ngatërruar keq me këto punë, se edhe ajo po mban-te anën e tyre... Siç dukej, ai kish mbetur vetëm.

— Mor, po përgjegju përsa të pyeta! Pse ma hedh fjalën gjetkë?!

— E po, ja, të ta them, or burrë, se nuk fshihet dot: Resmija doli sot të punojë në shkollë, bashkë me shoqet e saj.

Rexhep Lisit iu nxi fytyra, iu zgurdulluan sytë, sikur ta kish zënë njeri për fytì dhe ta kish shtrënguar fort.

— Si the?! Doli të punojë?! — ja bëri ai me të prerë.

Deshi të fliste më, deshi të thërriste, por fjala i ngeli në grykë. U ndje fare i këputur; dora që mbante cigaren e shoqtur, filloi t'i dridhet. Ai mbështeti shpatullat te muri dhe mbeti si i alivanosur. E shoqja u tremb, u ngrit nga vendi, e shkundi për supesh, duke i thirrur me emër, pastaj i dha të pijë një kupë ujë. Si i kaloi tronditja e parë, Nafija i tha të shtrihej dhe e mbuloi me jorgan, kur ai vuri kokën në jastëk.

Tërë atë ditë, Rexhep Lisi nuk ngriti krye. As hëngri, as piu. Sytë i mbante mbyllur. Herë binte në gjumë, herë rrinte zgjuar. E shoqja e pyeti nja dy herë mos dënte gjë, por, duke mos marrë përgjegje, nuk e ngau më dhe e la të qetësohej.

Vajzat u kthyen në shtëpi në mbrëmje. Rexhep Lisi nuk i ndjeu fare. Nafija u tregoi mbi gjendjen e të shoqit dhe mbi sa kish biseduar me të. Afërdita mendoi se puna po shkonte mirë, se Rexhepi nuk kish për të nxjerrë më kundërshtim, për t'u bërë pengesë; ai ish thyer. Ajo vajti njoftoi Liken. Kur u kthye, i tha Resmijes se i fejuari ish shumë i gjëzuar.

Edhe Resmija ish mbushur me ndjenja të çuditshme gjëzimi, kënaqësie, ngazëllimi. Ajo, për të parën herë në jetën e saj, ndjente diçka shumë të këndshme në shpirt. Atë që nuk e pandehte kurrë, atë që kish èndërruar prej disa vjetësh, e kish fituar. Ish e lirë, ashtu si partizanet, që luftuan armikun, ashtu si mijërra vajza të tjera që punonin në qytete e fshatra për të ndërtuar Shqipërinë e re. Ajo nuk do ta shikonte më botën të ndarë ngastra-nngastra, nëpërmjet kafazeve të dritares së saj, të ngrëna nga koha dhe krimbi.

Të nesërmen dhe ditët e tjera me radhë, doli në punë përsëri gjithmonë e lehtë, e qeshur. Asaj i vinte vetëm keq për një gjë, që kish afruar dita e largimit

të Afërditës dhe e vullnetarëve tjerë të qytetit. Ata do të zëvendësohen prej shokëve të rinj.

Rexhep Lisi ndenji ashtu i sëmurë një javë. Por nga dita në ditë, trupin filloj ta ndjejë më mirë dhe brenga e zemrës nisi t'i largohet. Atë erdhën e panë xha Kasëmi dhe Likja. Ky i prashiti misrin xha Rexhepit.

Likja ish plot gëzim e në Guras ish thyer akulli i fanatizmit dhe se një diell i ri po hidhte rrezet mbi fshat.

## BRUMI I ZJARRTÉ

— Mirë mëngjezi, Ngjelinë! — tha rojtari plak që nga dera e qoshkut, që ish në të hyrë të fabrikës.

Gruaja, që po kalonte atë çast, nuk u përgjegj menjherë. «Hëm!» mendoi plaku dhe buzëqeshi lehtë.» «Nuk e ka mendjen. Kushedi, hall njeriu!...»

Ngjelinës, si jehonë e vonuar, i erdhi në vesh përshëndetja e rojtarit dhe ajo ja ktheu:

— Mirë mëngjezi, xha Ilo! Si u gdhive?

— Mirë, mirë, si gjithnjë. Në turnin e parë je sot?

— pyeti pastaj ai.

— Në turnin e parë.

Dhe gruaja eci në sheshin e gjerë të fabrikës, drejt ndërtesës kryesore të saj.

Rojtari e ndoqi me sy, duke vënë re hapat e saj të vegjël dhe atë shtat të pakët, ndërsa vazhdoi të mendojë: «Ndofta kanë punë shumë... Por asaj nuk ja ha qeni shkopin. Sa e mbledhur vjen nga trupi, aq e fortë dhe e zonja është. Ore, i kemi trime gratë ne! Kanë punuar rëndë më parë dhe tani punojnë që ç'ke me të! Ua kalojnë edhe burrave, ore!» Dhe i shkoi mendja te gratë që kish njohur në mërgim, ku kish qenë shumë vjet të shkuar. «Ç'ne, o! Ku gjen si gratë tona andej!» përfundoi.

Ndërsa xha Iloja thoshte këto me vete, Ngjelina e kish mendjen te mbledhja që do të bënin pas turnit. E kish lajmëruar përgjegjësi, Thomai, i cili ish edhe

sekretar i organizatës së partisë në fabrikë. U kish thënë se do të shqyrtonin çështje të punës e të prodhimit, nën dritën e vendimeve dhe të porosive të fundit të partisë.

Ngjelinës i kishin tingëlluar si një këngë, që të bënë në shpirt, ato fjalë që Thomai u kish lexuar nga fjalimi i 6 shkurtit i shokut Enver. Ajo i kish të gjallë në mendje e në zemër ato fjalë aq të ciltëra, aq të zjarëta, aq të drejta dhe aq prekëse të Udhëheqësit. Njëkohësisht ajo e përfytyronte shokun Enver që e kish parë kur u kish vajtur në qytet. I bëhej sikur kish në vesh zérin e tij të ngrohtë e burrëror. Po ja, sa lart i kish vlerësuar edhe një herë gratë dhe të drejtat e tyre! Dhe ç'goditje të rëndë u jepte atyre, që merrnin nëpër këmbë këto të drejta!

Prej ditësh Ngjelina jetonte në afshin gjallëronjës të këtyre fjalëve. Asaj i dukej se edhe një dorë tjetër ish zgjatur për ta ndihmuar e për ta përkrahur që të shtynte e të hidhte tej pengesat, që i dilnin rrugës, dorë që sikur shpërndante tisin e mjegullës, që shtrihet diku përpara, dhe sikur e ardhmja më e lulëzuar dhe më e ndritur zbulohet tani.

Me të tilla mendime dhe ndjenja, Ngjelina i kaloi të tetë orët e punës; ajo punonte, nxitonte dhe mendjen e kish vetëm te mbledhja, që do të bëhej pas turnit, te fjalimi i 6 shkurtit, te ato që priste t'u thoshte Thomai.

Nuk ja kish frikën punës, së cilës ja kish marrë anën dhe e kryente shpejt e shpejt, sa të gjithëve u bënte përshtypje. Brigadën, ku ajo bënte pjesë, e kishin quajtur më të mirën. Të gjithë anëtarët e saj ishin të shpejtë e të kujdeshshëm në punë. Normën e tejkalonin çdo ditë. Ngjelina duhej të mos mbetej prapa në mbartjen e prodhimit. Brumi dilte flakë i kuq nga furra, me shpejtësi fryhej, kalonte në paraformë, pastaj te kallëpi, prej nga dilnin shishet e nxehta, të shkëlqyera, të përskuqura ende aty-këtu, sidomos te gryka. Ngjelina duhej t'i mbarte ato në furrën e tem-

perimit, ku do tē ftoheshin dalëngadalë. Po tē vonohej ajo, do tē vonohej puna e gjithë brigadës. Prandaj në lopatën e saj nuk merrte aq shishe sa merrnin mbar-tësit e tjerë, por më shumë; ua kalonte tē tjerëve edhe në rrugët që bënin. Pak herë e kishin lavdëruar pér këtë punë tē saj!

Mirë kjo, po në mbledhje si do tē vente puna?

...U mblodhën në këndin e kuq tē fabrikës, i cili mbante ende erë gëlqereje tē freskët, se ish ndërtuar i ri, ashtu siç ish e re e gjithë fabrika e qelqit.

Thomai, një burrë mesatar nga trupi dhe nga mosha, me fytyrë tē mbushur, u ngrit e foli, në fillim, pér përfundimet në punë gjatë pesëmbëdhjetëditeshit tē parë tē muajit. pastaj pér tē metat dhe detyrat. Në fund, po, në fund, ai e shpuri fjalën atje...

Ngjelinës po i vinin mendimet tē njëpasnjëshme, sikur e sulmonin enkas pér t'i kujtuar diçka, pér ta nxitur që tē merrte një vendim; ato nuk donin ta linnin tē qetë. Përbrenda saj, xheç i vlonë e i kish ndezur trupin. Kur ja kishin zënë në gojë kohë më parë, ajo kish ngurruar. Ndonëse dhe ja hante syri, ajo ish lëkundur. «Po sikur tē mos e bëj dot?» kish thënë me vete. «Puna është e rëndë. Duhet ta hapësh e ta mbyllësh kallëpin 2500 herë! Dhe ai rëndon nja 80 kile! «Ajo e ndjente veten tē fortë, por ndryshe ishin ata, burrat. Pastaj, ishin dhe tē stërvitur; ishin në atë punë që kur ish ngritur fabrika e vjetër. Një mendim tjetër i kish lindur: «Po burrin që do tē heqin, në ç'punë do ta venë? Mos bëhem shkaktare që ai tē dëmtohet?» Të gjitha këto ja kishin fashitur atë shtytje që kish përbrenda dhe që i thoshte: «Hë, se mund ta bësh, qdo gjë mësohet, qdo gjë bëhet!»

Por, tani duke dëgjuar Thomanë që po fliste, zëri i brendshëm sikur zuri ta ngacmojë përsëri. Thomai po u përsëritte që tē mos kishin frikë, tē kishin besim, tē hidheshin e ta merrnin përsipër atë punë.

Thomai tha:

— Mos ka ndonjë grua që e vret ndërgjegja se

ç'do t'i bëjmë tani burrat e ku do t'i vemë? Të jenë të qetë edhe burrat, edhe gratë. Në fabrikë ka punë sa të duash, dhe kujtdo do t'i gjendet vendi që i takon, pa e dëmtuar aspak. Po çdo problem do të zgjidhet.

Ngjelinës iu duk sikur Thomai këto fjalë i tha për atë. Atij, ndofta, i kish zënë veshi diçka, se gratax xheç kishin pëshpëritur midis tyre.

Disa gra e burra u zotuan që ta shtonin prodhimin dhe të ishin më aktivë si në familje dhe në fabrikë.

Si ndonjë qerthull, vërtiteshin mendimet në kokën e Ngjelinës. Fjalët e shoqeve, fjalët e Thomait sikur e shponin si shtiza. Asaj i dukej se ky ish çasti kur duhej të vendoste.

Ajo u ngrit; fytyra i ishte skuqur.

— Me leje! — tha.

Të gjithë u kthyen për ta vështruar.

Thomai buzëqeshi.

— Hë, Ngjelinë, ç'ke për të thënë?

— Marr përsipër të zëvendësoj punën e burrit në kiko.

Kaq tha Ngjelina dhe u ul. Asaj iu duk se kish thënë gjithshka, se kish shprehur gjënë më të madhe e më të guximshme.

Në sallë, u ndje një pëshpëritje.

— Shumë mirë, Ngjelinë, shumë mirë! — tha Thomai, në zërin e të cilit ndjehej gjëzimi dhe kënaqësia. — Kjo është një iniciativë shumë e rëndësishme, shoqe dhe shokë! — vazhdoi ai. — Ngjelina theu akullin — shtoi pastaj, duke hedhur vështrimin nga krahu, ku ishin ulur gratë.

Një çat, kur foli Thomai, në sallë ra përsëri qetësia; njerëzit sikur ishin mpirë. Por, si mbaroi ai, zunnë të pëshpëritin kokë më kokë si burrat dhe gratë.

— E do njeri fjalën? — pyeti Thomai.

Heshtje.

— Kush do të flasë? — pyeti përsëri.

U ngrit Nexhjeti, një burrë i shkurtër, me pikla të kuqe në fytyrë. Ai përgëzoi Ngjelinën për nisiati-

vën e saj dhe ftoi ta përkrahin atë edhe gratë e tjera.

— Për iniciativën e Ngjelinës ka gjë njeri? — theksoi Thomai, sikur të donte të thoshte se këtu e kish fjalën më shumë.

Asnjë nuk foli.

— Ç'thonë gratë e tjera?

Ato nuk po përgjigjeshin, por fytyrat u shkëlqenin nga një gëzim i brendshëm.

Një burrë fytyrëploçë, me nofulla të gjëra dhe hundë të shtypur, u hodh e tha:

— Dale, një herë, të shohim punën e Ngjelinës, pastaj edhe ato mundet...

Dukej se mbledhja nuk kish pse të zgjatej më.

Thomai tha:

— Ngjelina mori një iniciativë jo të vogël. I lumtë! Shembullin e saj duhet ta ndjekin shoqet e tjera. Unë, si përgjegjës i turnit dhe si sekretar i organizatës së partisë, zotohem se do ta ndihmojmë atë që të kapërxejë çdo vështirësi.

## 2

Kish disa ditë që Ngjelina po punonte në kikon me katër kallëpë. Puna shkonte zinxhir: fryrësi merrte brumin e zjarrtë me një shkop të hekurt, e frynte, e futte në paraformë: Që këtej, me trajtën e tij fillestare, si fluskë e gjatë, brumi kalonte në kallëpin të cilin e hapte, e myllte dhe e hapte përsëri Ngjelina, duke nxjerrë shishet që i merrte mbartësja. Ajo ndjente krahët të lodhur, por kjo nuk e vriste. Më shumë ajo ndjen te një lodhje në shpirt. Ndaj dhe fytyra e saj vezake sikur ish zgjatur më shumë ato ditë, faqet i kishin hyrë dhe sytë ngjyrëhiri i dukeshin të zmadhuar. Ndofta, në këto ish ndikuar edhe e nxehta prej afro 40 gradësh që ish në vendin e punës. Por Ngjelina ndjente një nxehtësi më të madhe përbrenda saj. I dukej sikur kjo e nxehtë ish prej 1500 gradësh, si ajo

brenda në furrë, ku shkrihej rëra e kthehej në brumë qelqi.

Këtë të nxeh të ja kishin shtuar fjalët që i thuheshin prapa krahëve dhe, ndonjë herë, i përplaseshin edhe në fytyrë me tallje.

Që ditën e parë, ai hundështypuri e kish pyetur me djallëzi:

«E, si vajte me normën, Ngjelinë? Besoj se e tejkalo...»

Ai ish tallur. Ajo nuk e kish plotësuar normën. Doemos, nuk ish gjë e lehtë. Edhe ditën e dytë, ajo i ish afruar normës, por, përsëri nuk e kish plotësuar dot.

Për këtë, hundështypuri dhe nja dy të tjerë e kishin mbajtur nëpër gojë: «Ajo po merr më qafë të tjetrët; norma është kolektive.»

Kjo e kish vrarë Ngjelinën. Ajo ish bërë shkak-tare që edhe shokët e saj të mbeteshin prapa, të dëmtohen! Për këtë nuk e zuri gjumi disa net. I shoqi i fliste, i jepte zemër, por asaj nuk i hiqej brenga. A do ta arrinte normën? Në qoftë se jo, si do të bëhej pastaj?

Kish mbledhur gjithë fuqitë e saj ato dy ditë të fundit, e vendosur që ose të plotësonte normën ose nuk kish ndryshe!..

Dhe, ja, ato ditë nuk kish shkuar keq. Asaj iu lehtë-sua ca shpirti, por fjalë të tjera i erdhën në vesh: «Dale, dale, se tani ka bërë ftohtë! Pa kur të shtrëngojë vapa e verës, kur t'i bjerë e nxehta nga sipër e nga poshtë, të shikojmë sa do ta bëjë normën! «Ngjelina e dinte, ishin fjalët e hundështypurit këto. «Nuk është punë për gra kjo! Do të punojnë gratë në kiko! E po mirë! Do fuqi atje, do durim, qëndresë! Nuk jemi një lloj, si këmbët e dhisë!»

Dhe vera po afronte.

Ajo ja kish thënë brengën e saj Thomait. Edhe ky e shikonte punën, ish kujdesuar dhe kish folur me besim:

— Do ta bësh normën dhe do ta tejkalosh. Për

këtë, jam e sigurt. Tani, është fillimi. Të kujtohet kur nise punën si mbartëse? Në fillim punoje ngadalë, bile të binin e të thyheshin dhe shishet. Por pastaj, ë? nuk ta arrinte dot njeri. Ki besim në fuqitë e tua, Ngjelinë!

Mirëpo, bashkë me nxehësinë e furrës së shkrirjes dhe me ngrohtësinë e motit, që shtohej përditë, po përhapeshin murmuritje të tjera të hidhura nga ata tre-katër burra, shokë të hundështypurit: «Ama, prodhim me cilësi na nxjerr Ngjelina, jo shaka!»

«E po, kështu bëhet norma: në kurriz të cilësisë!»

«C'të fryrë që i fryjnë shishet!» «Metodë e re, ore!»

«Apo ato gryka sa të drejta që i nxjerrin!»

Ngjelinës koka i rëndonte si një tra, kur hyri në shtëpi, pas turnit të dytë. Koha ish zagushi. I shoqi nuk ish aty, se kish turnin e tretë në punën e tij. Djali dhe vajza po flinin.

Ndonëse nuk kish futur gjë në gojë që përpara orës një, nuk i shkonte mëndja për të ngrënë. Gjuhën e kish të përtharë. Piu një çikë ujë, por iu duk i hidhur.

Gruaja nuk kish qetësi. Nuk i vinte për gjumë. U ul pranë tryezës, me dorën të mbështetur në faqe. Vështrimin e mbërtheu diku mbi lulet e mushamasë me ngjyrë qielli, që mbulonte tryezën. Ajo dukej e munduar. E mundonin fjalët, mendimet, e brente një mëdyshje. Jo, nuk ish aq e thjeshtë çështja. Duhet ta shikonte më mirë, më thellë. E kish marrë, siç duket, me rrëmbim. Ish nxituar. Ka puna punën. Ata kishin një jetë të tërë që punonin, ishin burra, kishin bërë kurse dhe përsëri... jo t'i hynte kjo punës menjëherë dhe t'ja dilte mbanë! Jo, jo, nuk ish e lehtë! Nuk e bënte dot. I ish dukur gjë e vogël. Ish rrëmbyer. Kish bërë gabim.

Në këtë përfundim arriti ajo si ndënji një kohë të gjatë ashtu, me kokën të turbullt të mbështetur në pëllëmbën e dorës.

Por pas pak, një fill shprese iu ngjall thellë në

kraharor. Ndofta do ta bënte edhe kjo punën më vonë, do të mësohej... Sigurisht, nuk ish punë e lehtë, donte kujdes, mjeshtëri, por a nuk do t'i fitonte këto? Pa t'ja vinte veshin ca më shumë punës, pa të shikonte të tjerët, më të vjetërit, pa të pyeste edhe ca, kështu do t'u hynte gjérave brenda. E? Nuk ish më mirë të bënte kështu? Le të mos e dorëzonte veten kaq shpejt!

Kjo mëdyshje, ky dyluftim, në mendjen e në ndërgjegjen e saj, sikur e brenin Ngjelinën.

Prapë i dolën para syve furra e shkrirjes, kikot, fytyra e hundështypurit, fjalët, që vinin rrrotull në-për fabrikë dhe iu duk çdo gjë e rëndë, e pamundur. Pastaj, në çast, ajo tha me vete: «Jo, jo! do t'ja them Thomait. Është mirë që të marrë fund sa më parë, se sa të zgjatet. Kështu duhet bërë.»

E kapitur, ra në shtrat për të fjetur, por gjumi e zuri shumë vonë.

\* \* \*

Turni i parë, të nesërmen, mbaroi punën dhe punëtorët e turnit të dytë po pregetiteshin për të filluar. Ngjelina veshi bluzën mavi, lidhi shaminë e bardhë në kokë, por nuk bëri për ne kiko. Ajo donte të takonte Thomanë. Pa andej-këtej. Nuk ja zuri syri. Pyeti nga dy veta mos e kishin parë. Ata i ngritën supet.

Mbeti ashtu, pa ditur ç'të bëjë, në mes të reparit të madh, ku ajri ish si zhagu i korrikut, dhe një zhurmë e fortë të detyronte të flisje me zë të lartë. Burrat, që punonin pranë furrës, ishin zhveshur në kanotiere. Fryrësit po merrnin shkopinjtë e tyre, mbartësit-lopatat. Ajo vazhdonte të rrrotullonte vështrimin për të gjetur Thomanë. Një punëtor, që i shkoi pranë, i tha se ai ish në mbledhjen e këshillit teknik, që kish filluar prej kohe.

Sa kaloi punëtori, u hap dera e zyrës, që ish në një anë të repartit, dhe i pari doli që andej Thomai. Pas tij, u dukën drejtori i fabrikës, inxhinieri, të tjera...

Ngjelinës diçka i rrahu në kraharon. Iu duk sikur zemra do t'i mbetej. Kënaqësia e parë se Thomanë e kish gjetur dhe se do ta njoftonte për vendimin që kish marrë një natë më parë, iu zhduk. Ajo nuk e ndjente veten të aftë pér të bërë këtë njoftim. Ata njerëz që kish përpala dhe që po dilnin nga një mbledhje, ku do të kishin shqyrtuar ndonjë problem të rëndësishëm të prodhimit, sikur po e vështronin me kujdes, sikur ja kishin lexuar mendimin dhe po i thoshnin të hiqte dorë nga vendimi i saj. Shokët e shoqet, rrull, kishin filluar nga puna, dhe ajo po ndjehej fajtore që vetë nuk po fillonte. Asaj i erdh turp kur i shkoi ndër mend se ata do të mësonin që kish vendosur të hiqte dorë nga puna në kiko. Çfarë do të mendonin për të? Se ajo ish trembur, kish ngri tur duart, se nuk e kish mbajtur fjalën, se qënkej vettëm një llafazane. Iu kujtua edhe hundështypuri. Ai, doemos, do të gëzohej, do të tallej dhe do të mburrej se i kish dalë fjala që kish thënë.

E, pra, për inatin e tij, për gëzimin e shoqeve të saj, për këtë barrë që kish marrë përpala sekretarit të organizatës së partisë, ajo nuk do të dorëzohej! Jo, nuk do të dorëzohej!

Thomai iu afrua, kur Ngjelina kish vajtura pranë kikos dhe kish vënë dorezat.

- E, Ngjelinë, si dukesh? — e pyeti ai.
- Mirë. Ja, po fillojmë...
- Isha në mbledhjen e këshillit teknik...
- Më thanë.
- Ndër të tjera, biseduam edhe për ngritjen e kurseve të kualifikimit.
- Do të ngrihen?
- Po, që nesër. Do të marrësh pjesë edhe ti.



— Doemos. Kam nevojë të përvetësoj mjeshterinë.  
Nga kjo anë nuk jam akoma mirë.

— Mos ki merak, do të të japim çdo ndihmë. Do të ngarkojmë edhe një mjeshtër të vjetër të të ketë nën kujdes. Edhe kjo vështirësi do të kapërxehet, ash-  
tu si u kapërxye ajo e normës. Apo jo?

Thomai vuri buzën në gaz. Ngjelina po e vësh-  
tronnte me vëmëndje. Sytë e saj ishin të qeshur.

...Në pushimin që u bë pas katër orësh, Ngjelina  
doli në sheshin e fabrikës; ajo e ndjente veten ndry-  
she tani dhe i pëlqente të thithte ajrin e freskët, të  
sodiste kodrat e gjelbëruara, rrëzë të cilave ish fabrika.

U ul në lëndinë. Tek po rrinte ashtu, me zemër  
të qetë dhe mendje të fjetur, iu afroan dy shoqe Val-  
detja dhe Maria.

— Këtej qenke, moj! — i tha Valdetja. — Po të  
kërkonin.

— Pata qejf të dilja një çikë. Ç'kemi?

— Vendosëm edhe ne! — ja bëri tjetra me një  
shprehje gëzimi.

— Çfarë vendosët?

— Të punojmë në kiko!

— Ashtu?! — u gëzua Ngjelina dhe brofi në  
këmbë.

— Po, po, do të punojmë! — u hodh e tha edhe  
Maria.

Ngjelina i përqafoi të dyja.

— Ja thatë Thomait? — i pyeti pastaj.

— S'ja kemi thënë — u përgjegj Valdetja.

— Ejani të vemi t'ja themi!

Dhe të tria u drejtuan për në fabrikë.

Përpara tabelës së punëtorëve të dalluar dhe  
asaj ku vendoseshin lajmërimë dhe njoftime të tjera,  
kishin qëndruar dy veta. Njeri ish rojtari i fabrikës, i

rrojtur e i krojtur, siç e kish zakon, dhe tjetri një punëtor i gjatë nga ata të gazgjeneratorit, me një kapë prej letre në kokë dhe me çizme prej llastiku në këmbë. Ata po lexonin një fletërrufe.

— Thirr, thirr një çikë, se s'para dëgjoj mirë — po i thoshte plaku djaloshit.

— Ja: falënderon partinë për ndihmën që i kanë dhënë, zotohet se do të punojë edhe më shumë në të ardhmen, se do të nxjerrë prodhim me cilësi, dhe fton të gjitha punëtoret e fabrikës që të përqafojnë inisiativën e saj.

— Ore, dëgjova se edhe ca punëtore të tjera, këto ditë, kanë marrë përsipër të punojnë në furre — tha tjetri.

— Po, dhjetë të tjera.

— Hajde, Ngjelinë, hajde! E bëre fora! — tundi kokën plaku.

— Dhe shikoje: pesë para njeri duket — ja bëri djaloshi, duke treguar fotografinë e Ngjelinës, që ish në krye të tabelës së nderit.

— E njoh, e njoh... iu përgjegj plaku. — Nuk është puna të jesh trupmadh. Duhet të kesh zemër, zemër! — Dhe vazhdoi: — I njoh unë, i njoh gratë tonë. Janë si brumi i zjarrtë i furrez atje; por janë nga një brumë më i fortë, nga ai brumë, që bëhet çelik, çelik, o bir!

## VAJZA ME SHENJË NË FAQE

Autobusi po ngjitte të përpjetën e malit, nëpërmes pishave. Rruga ish e ngushtë dhe e pashtuar, e mbushur me gropë dhe me gurë të rrëkellyer nga ledhë, të cilin shirat e gjerryenin gjithnjë. Ditët e fundit, moti kish qenë me lagështi dhe ujërat e kishin vështirësuar edhe më shumë këtë të përpjetë, të cilën autoritetet mezi e kalonin.

Maqina ish e mbushur plot e përplot me njerëz me mosha të ndryshme. Me të moshuarit sikur po mërziteshin nga rruga e keqe, e cila mbante mjaft gjer në qendrën e lokalitetit malor, ku, atë ditë do të kremtohej përvjetori i një brigade partizane. Megjithatë, në autobus ziente kënga. Ja kishin marrë ish-luftëtarët e brigadës, punonjësit dhe nxënësit e shkollës së mesme të qytetit, që po shkonin në festë. Po këndonte edhe shoferi.

Kënga partizane buçiste fort, ajo sikur ndjehej ngushtë brenda autobusit, dhe donte të shpërthente e të shtrihej tej dritareve të hapura, në ato pyje e brije, ku kish marrë fill e kish jetuar vite të shkuara në ajrin, që mbante erë barut. Më lart, më të mprehetë ngriheshin zërat e djemve dhe të vajzave, që kishin zënë gati gjysmën e maqinës prej pesëdhjetë vendesh. Midis këtyre zërave, shquhej ai i një vajze, me tingull të pastër e të ëmbël, që sikur të përkëdhelte, dhe zëri i ngrohtë e i plotë i një djali. Megjithatë, ndonëse kë-

ta zëra harmonizoheshin, nuk kishin atë ndjenjë, atë mall, atë afsh, që buronte nga zërat e matur të ish-partizanëve. Nëpërmjet këngës, ata rijetonin ato ditë të mëdha plot ngjarje, brenga dhe mundime, gjëzime dhe fitore. Këngë, shoqe e pandarë e jetës, jeta vetë!...

Kur pushonte kënga, udhëtarët kalonin në bisedat e tyre të larmishme. Kujtimet e luftës kishin në gojë më të shumtët. Kështu, herë-herë, në gjysmën e parë të autobusit, binte një farë qetësie të cilën sikur e kërkonin, sikur e ndillnin ato kujtime, që nuk donin ti cënonte kush, tu tronditte dlireshinë dhe madhështinë.

Por, në pjesën e dytë të maqinës, ku rrinin nxënësit, fjalët shpërthenin, hidheshin, përziheshin, sikur të roitte ndonjë bletë. Merrej e nuk merrej vesh se ç'thuhej. Lëshohej një zë i mprehtë, dikush përqeshte, një tjetër jepte ndonjë përgjegje me thumb dhe pëlciste gazi. Ko zhurmë vazhdonte, zgjatej, rritej dhe bëhej e mërzitshme. Udhëtarët kthenin kokën, shikoni të pakënaqur ata që e tepéronin dhe i këshillonin të mbanin qetësi, të ishin të matur. Por, sa binte pak heshtja, gazi dhe zhurma shpërthenin përsëri. Në ndenjësen e gjatë në fund të autobusit, ishin ulur pesë vajza, të cilat, duket, ishin ngatërrastaret. Ato nuk merrnin vesh dhe shpotitë, ngacmimet dhe të qeshurat e tyre përfshinin në poterën e vetë gjithë të rinjtë dhe të rejat.

— Aa! — klithi dikush nga fundi, sa të gjithë udhëtarët ktheyen menjëherë kokën, të shqetësuar për çka mund të kish ndodhur.

Sado që u mundua, një nxënëse nuk mbajti dot të qeshurit, por ja plasi me zhurmë e më stërkala pështyme.

Një vajzë me flokë të zez kaçurrelë, me qëpalla të kthyera e me hundë pak përpjetë, ish ngritur më këmbë në cepin e majtë të fundit të autobusit dhe, duke u shtënë si ndonjë e pafajshme, që donte të mbante rregull, po thoshte:

— Ç'bëni kështu?! Mbani qetësi! Nuk ka lezet!...  
Një udhëtar ja priti:

— Lëri, lëri ato, se ti i bën më të mëdhatë. Të pashë që e godite atë djalin në kokë.

— Unë?!

— Po, po, ti!

— !...

Ndërhyri një grua me moshë të thyer:

— Të vura re edhe unë, që kur u nis autobusi. Ti i ngacmon të gjithë. Qenke zevzeke e madhe! — Pastaj, shtoi: — Nuk paskan një mësues që t'i shoqërojë? Si kështu?

— Mësuesit mbetën me nxënësit e tjerë në autobuzet e pasme — tha një udhëtar.

Një burrë bullafiq tha:

— Nuk është puna që të jetë doemos mësuesi, pa të rrinë si duhet. Këta janë nxënës të maturës, për një dy muaj dalin mësues vetë. Apo jo? — iu drejtua ai nxënësve.

— Po — u përgjegj një djalë. — Dhe vazhdoi: — Kini të drejtë. E tepëruam. — Pastaj, u kthyte nga vajza, që rrinte më këmbë dhe i tha: — Loreta, mjافت! Nuk janë shaka këto!

Vajza kish mbetur si e vecuar. Fjalët, vështrimet e udhëtarëve, sikur e kishin topitur. Edhe ndër shokët e saj vihej re një pendesë. Ajo u ul pa folur më.

Në autobus ra heshtje. Sëcili bluante mendimet e veta. Shumë udhëtarë diçka mendonin për nxënësit dhe për ndodhinë. Pranë meje, kisha Hekuranin, sekretarin e organizatës së partisë të një fshati të largët malor, të Belenit. Me Hekuranin njihesha prej vjetësh. Në ndënjasën përballë nesh, ish ai burrë, që kish thënë për nxënësit se do të dilnin mësues. Pranë tij, rrinte si i dremitur një fshatar me moshë, të thyer, me mustaqe të rralla, me një kapë të zezë në kokë.

Buri bullafiq, që mbante një kasketë ngjyrë hiri, na tha:

— Kam punuar disa vjet si llogaritar në shkollën

e tyre dhe i njoh thuajse të gjithë. Ah, ç'është ajo Loretta! E sillte shkollën vërdallë! Po, po! E vutë re një shenjë që ka në faqen e majtë? Kujtim nga prapësitë e saj i ka mbetur.

I hodha një vështrim vajzës me bishtin e syrit. Ajo seç po murmuri me shoqet që kish pranë. Sytë e zez i shkëlqenin. Një buzëqeshje i ndriçonte ftyrën. Dukej shumë e gjallë, dhe, megjithëse kish krijuar një farë mërzie me sjelljen e saj, ish tërheqëse. Mespërmes faqes së majtë, kish shenjën e gjatë të një plage të vjetër. Por kjo shenjë nuk e shëmtonte, përkundrazi sikur ja shtonte hieshinë.

— Mënt u bë copë një ditë — vijoi bashkëudhëtari ynë. — Ku nuk hipte e ku nuk kacavirej, si ndonjë dhi e egër! Nëpër mure, nëpër pemët e kopshtit të shkollës e nëpër hekura e trarë. Një herë, se për ç'djall, kish hipur në murin e palestrës së shkollës, që ish duke u ndërtuar. Po qeshte e po tërbohej me bashkënxënësit e saj, kur një të shkarë e një të rënë nga tri metra lart! Poshtë kish hekurishte, dërrasa e sende të tjera për palestrën. Aq u vra, sa mbeti pa frymë. U ngrit gjithë shkolla më këmbë. E shpunë në poliklinikë. Deshën ta shtronin në spital. Nuk pranoi. Ndenji në shtëpi ndonjë javë për mjekim. Që atëhere i ka mbetur ajo shenjë në faqe. Por, prapë, nuk vuri mend.

Fshatari, që sikur po dremitte, tha:

— Është mëzkë akoma, vëllaçko! Çdo gjë i duket shesh e lëndinë. Prandaj harbon kështu. Dale, dale, pa do të vijë në rrugë dhe do të hedhë çapin si duhet.

— Nuk e di, nuk e di — tha me një farë mosbesimi tjetri. — Më duket se kështu është prerë kjo dhe kështu ka për të qenë.

— Jeta, puna i ndryshojnë njerëzit — ndërhyri Hekurani.

— Kjo është fare çamaroke! — theksoi llogaritari.

— Ashtu duket, vërtet — pohoi Hekurani.

— Prandaj them unë...

Zëri i vajzës, me tingull të pastër e të ëmbël, u ngrit nga fundi i autobusit:

— Ndër ara, fabrika, kantiere...

2

Kaluan muaj, kur një ditë pranvere, në sheshin kryesor të qytetit, u ndodha ballë për ballë me Hekurarin. Bashkë me të, ish një vajzë me pantallona mavi, me buzë të kuqe me grykë të mbyllur. Ajo mbante një çantë në dorë.

I dhashë dorën mikut tim dhe e përshëndosha.

— Ja, apo erdhëm — më tha Hekurani. Pastaj, duke më treguar vajzen, vazhdoi: — Nuk e njeh? Është Loreta. Të kujtohet?

«Loreta?», mendova unë. Emrin sikur e kisha dëgjuar, po nuk po më kujtohej se ku.

Hekurani më erdhi në ndihmë.

— Kemi udhëtar vjet bashkë në një autobus, për në festën e brigadës...

Menjëherë më ra ndër mend çdo gjë. I dhashë dorën vajzës duke thënë:

— Posi, më kujtohet. Si je?

Ajo po buzëqeshte. Ish disi më e rritur, lëkura e fytyrës sikur i ishte regjur ca. Shenja në faqe i dallohej si më parë dhe, për çudi, e tregonët më të këndshme. Sytë e saj sepse kishin një hije tjetër, një vështrim disi burrëror.

— Kemi ardhur për mbledhjen e intelektualëve në ndihmë të fshatit, që bëhet nesër — më shpjegoi Hekurani. — Loretën e kemi mësuese në Belen — shtoi, duke parë se unë po e vështroja me këershëri si Loretën dhe atë.

— Shumë mirë — iu përgjegja.

Hekurani sikur ngutej.

— Po shkoj të takoj një shok — tha. — Mund të shihemi prapë sonte...

U shtrëngova dorën. Loreta më buzëqeshi përsëri dhe u largua me një hap të zhdërvjellët. U ktheva dhe e pashë edhe një herë. Sepse më la një mbresë të vëçantë kjo vajzë!

Në mbrëmje takova Hekuranin në klubin e qytit. Shkëmbiem fjalët e para mbi shëndetin dhe punët e seclit, mbi çështjet e kooperativës bujqësore, pastaj ra fjala për mbledhjen e intelektualëve dhe për Loretën.

— Domethënë Loretën e paskeni mësuese në fshat? — i thashë Hekuranit.

— Po, po. Duket një çikë si çudi, ndofta, dhe mua nuk më erdhi mirë në fillim.

— Pse?

— Të kujtohet sjellja e saj në autobus?

— Po.

— ...Dhe ato që na tregoi ai që kish qënë llogaritar në shkollë?

— Posi.

— E, pra, në vjeshtë më erdhi në zyrë. Lëre që më doli papritur dhe më habiti, por më dogji, kur pa shë se ish ajo.

«Po vij mësuese në Belen» më tha.

«Neve na kanë caktuar një mësues tjetër» ja prita unë, disi i mërzitur, gjë që asaj i ra në sy.

«E di. Kishin emëruar Bardhylen këtu. Unë isha caktuar në një fshat afër qytetit. Por, Bardhylja ka shumë të sëmurë nënën, nuk ka njeri për ndihmë në shiёpi dhe asaj iu muar parasysh lutja që të vendoset në afërsitë e qytetit. Unë, vullnetarisht kërkova të ndërrroja me të fshatrat. Prandaj po vij në këmbë të saj».

«Ke ardhur vullnetarisht gjer këtu, në Belen, në këto gérxhe e shkrepë, një ditë larg qytetit!» i thashë unë me një farë qëllimi.

«Pse të mos vija?! Ç'ka këtu për t'u çuditur?»

m'u përgjegj zjarr pér zjarr ajo, duke dashur tē he-dhë poshtë mendimin që fshihnnin fjalët e mia. «Gjithë klasa jonë kish premtuar tē vente pér tē shërbyer ku-do që tē ishte nevoja. Edhe nē fshatin më tē largët, edhe nē kushtet më tē vështira, unë jam gati tē vete, po ta dojë puna!»

Këto fjalë tē Loretës më bënë përshtypje. Megji-thatë, unë nuk isha i qetë. Kisha dëgjuar se mësuesen e parë Bardhylen që na kishin caktuar në fillim, e kishin hequr nga fshati ynë dhe do tē na dërgonin një tjetër. Por, kur m'u paraqit Loreta, siç tē thashë, nuk më erdhi mirë. Përgjegjja që më dha ajo, nuk ish gjë e vogël, ç'është e vërteta. Mirëpo kush më siguronte se ato që tha nuk ishin veçse fjalë apo dëshira? A mund tē ish e shtruar dhe e saktë ajo nē punë? Apo ish tamam një kokëkrisur, një çamaroke, si na kishin treguar dhe si e pamë nē autobus që, nē vend që tē na bënte punë, tē na prishte, që nē vënd t'u jepte mend fëmijëve, t'ua nxirrte fare? ose tē na nxirrte ndonjë avaz tjetër nē fshat? Këto gjëra më shkuan nē mendje dhe më shqetësan. Madje, ja futa një çikë nē vesh inspektorit tē arësimit tē lokalitetit tonë, sikur tē na i hiqnin dhe tē dërgonin një tjetër. Por ky nuk ma vu-ri veshin.

U pa puna që nuk kishim ç'të bënim, prandaj me tē do tē gatuheshim. Vendosa që atë ta kisha mirë nē sy. Shkolla jonë kish mjaft nxénës. Kishim edhe dy arësimtarë tē tjerë: një vajzë nga fshati ynë dhe drej-torin, një djalë nga fusha. Një vit më parë, punët nuk na kishin shkuar mirë. Mësuesja e kish pasur vitin e parë nē shkollë, tjetri nuk kish qenë fort i shtruar: bënte ç'bënte dhe largohej, kur me leje e kur jo. E kish mendjen nē fshatin e tij, se dashurohej me një vajzë. Ja, tani, na kish ardhur edhe kjo, e kushedi se si do tē na vente puna... Isha nē hall.

— E po si vajti? — pyeta unë me padurim.

— Hëm! — qeshi Hekurani. — Mbaj vesh. Sa u rregullua nē shtëpinë, ku e caktuam, Loreta shkoi

menjëherë për të parë shkollën. Kjo nuk ish në terezi. Ishin bërë ca rregullime, po ish e palyer dhe e palarë, kish edhe mungesa të tjera. Drejtori nuk kish ardhur. Mësuesja e fshatit ish vetëm. Gëlqere nuk kish pasur në dyqanin e konsumit.

Loreta iu shkreh mësueses sonë, Sanijes:

«Ç'kini bërë, moj! Edhe një javë mbetet për të filuar shkolla, dhe ju nuk jini gjékundi!»

«Medet!», mendova unë. «Pa ardhur mirë dhe ja nisi sherrit! Hej, ç'do të na pjellë me këtë!» Por, nga ana tjetër, i jepja të drejtë.

«Me ngadalë, moj vajzë...», ndërhyra, duke pasur frikë se mos kërlesheshin të dyja. «Do t'i shikojmë këto punë. Çfarë duhet?»

«Në radhë të parë, gëlqere. Pastaj, të na ndihmoni pér të irregulluar të gjitha shkatërrirat.»

Dërguam njeri në lokalitet. Ai gjeti gëlqere, mori edhe disa sende të tjera për shkollën. Loreta iu përvesh punës. I dha shpirt Sanijes, që është një çikë e ngadalshme; mori edhe disa nxënës të rritur për ndihmë. Papo, zbathur në thonjtë, që me natë, filloj lyerjen dhe pastrimin e shkollës. Brenda dy ditësh, kjo u bë kupë. Kur erdhi drejtori, tri ditë para se të nissin mësimet, çdo gjë ish në rregull. Unë e vura përpara atë që më vinte si në dasmë.

Çështjen e shkollës dhe, veçanërisht, Loretën, i kisha, si të thuash, në planin e ditës. Në klasën e saj, kisha një djalë.

«Si vini me mësuesen e re?», e pyesja.

«Mirë, babi», më përgjigjej ai.

A jua shpjegon mirë mësimet?»

«Shumë mirë»

«Ju qorton?»

«Është një çikë e rreptë me ata që nuk bëjnë detyrat, por nuk i godet.»

Më zuri veshi se midis mësuesve kish grindje. Sido mos midis drejtorit dhe Loretës. I vajta, një ditë, drejtorit.



«Si shkon?», e pyeta.

«Mirë. Këtë tremujor, po dalim më mirë se vjet. Por Loreta sikur na shet shumë mendje.»

E këshillova të ish i kujdeshëm, të shikonë të mirat e të metat e njerëzve dhe të punonë me urtësi për t'i ndrejtura ata.

Bisedova edhe me Sanjen. Më lëvdoi Loretën në punë, por më tha se ish ca e rrëmbyer.

Një ditë, drejtori më erdhi tërë zemërim në zyrë.

«Shoku sekretar, ose ja mblidhni Loretës», më tha, «ose unë dorëzoj kyçet! Nuk punoj dot me të!»

— Si eshtë puna?», e pyeta unë.

«Ajo kërkon të dalë mbi drejtorinë. Fut hundët atje ku s'i takon!»

«Do të vij, sot pasdreke, në mbledhjen tuaj.»

Vajta. Atje dolën mjaft gjëra. Drejtori mundohej tu bënte bisht gabimeve të tij. Loreta kritikoi të metat, bëri dhe autokritikë. Sherri i vërtetë kish plasur në lidhje me papastërtinë e nxënësve. Një vajzë e klasës, ku jepte mësim drejtori, ish gjetur me morra. Kjo e kish shqetësuar shumë Loretën. Ajo e kish ngriitur me të madhe çështjen e papastërtisë, që kish në atë klasë. Disa nxënës vinin të palarë, të grisur, të shkujdesur. Drejtori nuk i vinte re këto gjëra; ai nuk u fliste nxënësve, nuk punonë me prindërit e tyre.

Drejtorit nuk i kish ardhur mirë për vërejtjen.

«Unë do t'i laj e do t'i pastroj?» kish thënë.

«Ti duhet të këshillosh fëmijët e të kërkosh të vijë të pastër e të rregullt» i ish përgjegjur Loreta. «Ta bësh çështje edhe në familjet e tyre.»

«Nuk ja kam ngenë të rend për këto gjëra nëpër shtëpitë e fshatit. Unë kam njëqind punë» ja kish kthyer ai.

«Punë kemi të gjithë», ish hedhur Loreta, por klasat dhe nxënësit i kemi të pastër.»

Dhe, vërtet, klasa e saj ish shembullore në pastërti. Për këtë kish fituar edhe flamurin. Loreta punonte shumë me familjet. Vente shtëpi më shtëpi, çdo

ditë, dhe kujdesej si për preqatitjen e mësimave nga nxënësit, ashtu edhe për pastërtinë dhe për punë të tjera. Kështu, mjaf familje, që nga rregulli dhe pastërtia nuk kishin qenë fort mirë, kishin ndryshuar shumë. Një punë të madhe ajo kish bërë, sidomos, në familjen, ku banonte.

Këto ishin të vërteta, dhe të drejtën nuk ja haje dot. Drejtori, në fund, i pranoi gabimet e tij.

Me punët e kulturës në fshat nuk ishim mirë; kishim një vatër kulture, por kjo rrinte më shumë mbyllur se hapur. Edhe brenda nuk kish gjë. Në mbledhjen e asamblesë, ku u zu në gojë edhe puna e vatrës së kulturës, Loreta u ngrit e tha:

«E marr unë përsipër vatrën e kulturës. Do ta drejtoj vetë, s'është nevoja të ketë përgjegjës të vëçantë.»

Dhe kështu u bë. Që kur e mori ajo në dorë, gjendja ndryshoi. Kooperativistët, sidomos rinia, venë çdo mbrëmje në vatrën e kulturës. Atje bëhen biseda. Loreta vetë u flet për librat. Më parë nuk kishim grupe artistike. Tani, rinia i ngriti. E ku dilnin vajzat! Loreta këndon në kor, merr pjesë në estradë; ajo tërroqi shumë vajza në grupe artistike. Sivjet, për të parën herë, ne do të dalim në festivalin folkloristik.

— Endrra e keqe na doli për hair, si thonë pleqtë — qeshi Hekurani.

— Edhe mua më duket si çudi — i thashë unë. S'ma merrete mendja... .

— Dhe ç'është më e madhja — vijoi Hekurani, — ajo nuk ka më huqet e para; është zbutur, është shtruar, nuk rrëmbehet, është bërë më e pjekur, megjithëse është, si gjithnjë, shumë e shkathët.

— Këtë përshtypje më la edhe mua, kur e takova.

— Të kujtohet ç'na tha ai plaku në autobus, vjet?

— S'më bie ndër mend.

— Ai që kisha pranë, me ato mustaqe të rralla... .

— Po, po, e kam parasysh... .

— Ai tha një fjalë shumë me vend: «Është mëzkë

akoma. Çdo gjë i duket shesh e lëndinë. Dale, dale, pa do të vijë në rrugë...» Këto janë fjalë të urta, të nxjerra nga përvoja e jetës. Sa qe e re, në shkollë, në familje, Loretës ndofta i dukej se çdo gjë, që fluturonte, hahej, si i thonë fjalës. Por, kur ra në punë, në jetë, atëherë, hë...

— ...u kalit — plotësova unë.

— Po, po, u kalit, e pa veten midis njerëzve të punës, përpara detyrave. Shembulli i kooperativistëve, që punojnë ditë e natë, që hapin qilizmë edhe në dëborë, që bëjnë tarraca dhe kanë kthyer në toka buke edhe skërkat zhurishte, i kanë mësuar asaj shumë gjëra, që nuk ja mësoi shkolla.

— Është e vërtetë...

— Fshatarët e duan, e nderojnë, ia dëgjojnë fjalën... Po, po, kjo është Loreta sot.

Hekurani heshti, disi i menduar; pastaj, tha:

— Po të tregoj edhe një gjë, që do të duket më e pabesueshme. Loreta ka rënë në dashuri me agronomin e kooperativës. E kemi djalë nga fshati. Vjet mbaroi teknikumin bujqësor.

— E do edhe ai?

— Sigurisht.

— E kanë me gjithë mend?

— Po, po. Janë dashuruar fort, por e mbajnë si të fshehtë; kanë, siç duket, ndonjë qëllim. Ndofta Loreta...

— Thua të martohen?

— Do të martohen. Agronomin e kemi djalë të mirë, nuk është ndonjë nga ata që hidhen lule më lu-le. Pastaj, pse të mos e marrë?

— Po Loreta?..

— Edhe asaj ja bleva mendjen, por nuk i rashë fort në sy. Një ditë, ja hodha larg e larg. «A të pëlqen të rrish për gjithnjë në fshat?», e pyeta. «Pse të mos më pëlqejet?!

» m'u përgjegj aty pér aty. «Kudo është atdheu ynë. Dhe ndërtimit të socializmit duhet t'i shërbejmë kudo.» «Po sikur të të martojmë në fshat?»

iu drejtova përsëri. «Ha-ha-ha!» qeshi Loreta dhe tha:  
«Edhe kjo mund të ndodhë. Njeriun që vlen ta dashu-  
rosh, mund ta gjesh kudo: edhe në fshat, edhe në ma-  
jë të malit, dhe me të mund të shkosh e të rrish ku ta  
dojë puna.» Dëgjon? — ma bëri Hekurani.

— C'vajzë! — thashë unë.

— Vajzë e kohës sonë — theksoi Hekurani dhe u  
ngrit. — Më fal tani — tha. — Sonte jam për darkë te  
Loreta. Duhet të nisem, se u bë vonë, më duket.

## KUR ZBARDHI DITA PËRSERI ...

Një portë u hap, u dëgjuan ca të qeshura të forta dhe një trumbë vajzash doli në rrugë. Ato po vazhdonin një bisedë që e kishin filluar brenda shtëpisë. Disavë nuk u mbahej gazi.

— Mjaft edhe ju! — u tha njëra. — C'qeshni kaq?! Por të tjerat po gajaseshin.

Një vajzë e gjatë, me gërshteta të trasha, që kish hedhur një xhaketë të leshtë krahëve dhe që përcillte shoqet, u tha:

— Pse nuk ndenjët edhe pak?

— O, akoma të rrinim? Vajti ora nëntë! — ja ktheu një tjetër.

— U bëfsh edhe njëqind vjeç! — e uruan dy vajza me një gojë atë me gërshtetë.

— Natën e mirë! — thanë të tjerat.

— Natën e mirë!

Vajzat kopsitën palltot, shtrënguan shallet në qafë, nja dy ngritën jakat dhe u nisën me nxitim.

— Uuu, qenka ftohtë! — u drodh njëra, që vinte shkurtalaqe.

— Ftohtë, pos!

— Do të na bjerë dëborë...

— Ka kohën.

Kur dolën në rrugën kryesore të qytetit, vajzat u ndanë: tri morën poshtë, dy lart. Këto u zunë për krahu dhe u dhanë më shumë këmbëve pë t'u nxehur. Në

fytyrë u binte drita e neonit. Njérës sikur i ish murëtyer pak lëkura. Tjetrës i kish marrë një ngjyrë disi të bardhë. Vetëm maja e rrumbullaktë e hundës i ish skuqur. Ajo tha:

- I mbushi Tefta të nëntëmbëdhjetat.
- Është më e madhe se ty. Vali.
- Vetëm një muaj...
- Duket më shumë...
- Vjen më e gjatë, prandaj...
- Po gërshetat i kanë hie...
- Hë, hë...
- Nuk i ka prerë që në fillorë...
- Po.

— Të kujtohet kur na ka ardhur në klasën e tretë? Atëherë dukej e shkurtër. Por hodhi shtat menjëherë në klasën e gjashtë.

- Është shumë e dashur Tefta.
- Miqësia jonë nuk do të prishet kurrë.
- Shoqja e Valit e hodhi fjalën gjetkë:
  - Vetëm një muaj, the, është më e madhe se ti?
  - Një muaj e disa ditë.
  - Domethënë pas një muaji do të festojmë ditë-lindjen tënde?
  - Po. Dhe pikërisht më 1 janar, ditën e vitit të ri. Harrove?

— Oh! Më doli nga mendja!  
Kishin arritur përpara një ndërtese katërkatshe.  
— Tani, natën e mirë. Afërditë, — i tha Vali shoqes së saj.

- Dale, se do të të përcjell.
- Ç'është nevoja? Ja ku e kam edhe unë, dy hapë, më tej.
- Do të vij.

— Jo, jo! Se, pastaj, duhet të kthehem edhe unë të të përcjell ty. Natën e mirë.

Dhe Vali i iku shoqes nga krahu.

Asaj i kaloi një drithërimë. Rregulloi më mirë jakën e ngritur të palltos, por hapin nuk e shpejtoi.

Kish në mendje orët e këndshme që kishin kaluar në festën e ditëlindjes së Teftës, mendonte nëntëmbëdhjetë vjetët e saj e gjëra të tjera, e ndjente veten pak të lodhur.

Ngjiti ngadalë dhe e menduar shkallët e apartamentit të saj. Kur po trokiste në derë, i shkoi ndër mend se pas një ore e gjysmë duhej të nisej për në fabrikë që të merrte turnin e natës.

Derën e hapi e ëma.

— Ç'u bëre, moj bijë? — i tha.

— Mbetëm me muhabet, nënë.

— Mirë. Po ke për të shkuar në punë.

Vali nuk foli. Hoqi pallton e shallin dhe i vari. E ëma tha:

— Darkën e ke gati.

— Nuk më hahet dhe aq...

— Të hash, të hash! Posi!

Vali u shtrua në tryezë. Filloi të hajë si me pahir. Pastaj, dëshira për të ngrënë iu shtua. Zuri të ndjehej më mirë. Ajo farë dhëmbjeje në kokë i kish ikur. Por, duke ngrënë, përsëri mendohej; përsëri kaq gjëra të ndryshme po i kalonin nëpër kokë.

E ëma po e shikonte me bishtin e syrit.

— A, është ftohtë jashtë? — e pyeti.

— Është shumë.

— Ç'ke? Mos nuk mund?

— E, ashtu... Kam një farë lodhje...

Mbaroi së ngrëni, u shtri në divan. Mendimet nuk i ndaheshin. E ngrohta e dhomës po i jepte kënaqësi. Pa orën që ish mbi bufe. Kish kaluar nga dhjeta. Për njëzet-njëzet e pesë minuta duhej të nisej. Fabrika mbante afro gjysmë ore larg. Më njëmbëdhjetë fillonte turni. Por ajo e ndjente veten të plogët. Kish dëshirë ta linin ashtu atje në divan, me mendimet e saj, të çlodhej e të ëndërronte. Të rrinte atje, këtë donte vetëm.

Jashtë kish zënë erë. Fërshëllima e saj vinte e mprehtë.

Ora kish vajtur dhjetë e njëzet. Edhe dhjetë minuta mbeteshin që Vali të nisej. Por, çudi, ajo përtonte shumë të ngrivej! Tani, edhe sytë po i rëndoheshin për gjumë. Sa mirë sikur të flinte! Jashtë frynte, bënnte ftohtë! Dhe fabrika ish gjysmë ore larg! Sikur të mos vente atë natë në punë, ç'bëhej? Nuk bëhej kiamet! Ja, ta zemë se ish sëmurur. Nuk do të vente në punë, pa fjalë. Ja, kështu...

Dëgjoi nënën:

— Vali, të vajti ora...

Vajza heshti pak; pastaj, tha:

— Nuk e ndjej veten mirë. Them të mos vete sonte.

Eëma e vështroi e menduar.

— Je e sëmurë? — pyeti dhe shtoi: — Të vura re qëpari.

— Nuk e ndjej veten mirë — përsëriti vajza.

— Po të mos jesh në gjendje, atëherë, doemos, nuk ke si vete... Çfarë do të të bëj?... Pi një aspirinë.

— Nuk dua gjë. Do të bie të fle.

Dhe Vali u ngrit, u zhvesh dhe ra në shtrat

Një copë herë ndenji e shtrirë në kurriz, me sy hapur, të ngulur në tavanin e dhomës që e kish mbuluar errësira. Një rreze dite hynte nga rruga nëpër dritare dhe zbehte një rrip të tavanit, por Vali nuk shikonte gjë. Ajo ish si e humbur. Gjumi i-bashkoi qepallat e saj të gjata.

... U zgjua pas mesit të natës. Me të vërtetë nuk ndjehej mirë. Kish një farë rëndësie në kraharor. Qafa sikur i kish dërsirë. Mbulesat sikur i zinin frymën. U kthyte në krah; mori frymë disi më lehtë. Pas pak përsëri nuk u ndje e qetë; u vërvit në krahun tjetër.

Koka sikur i ziente. Mendja i fluturoi në fabrikë. Nëpër errësirë iu vijëzua salla e gjatë e repartit, me maqinat ku vërtiteshin me shpejtësi boshtet e mbushura me fillin e bardhë të pambukut. Pranë maqinave vozitnin shoqet e saj; Drita, Zana, Bardhylja... Ato

u binin rreth e rrrotull maqinave, vështronin mos kë-  
putej ndonjë fill, mos qëndronin boshtet...

Vetëm në një maqinë, boshtet nuk vërtiteshin.  
Ish një maqinë e gjatë si të tjerat, por që qëndronte  
si e trishtuar. Ajo dukej e ngathët, e plogët, pa jetë...  
Ish maqina e saj. Po, vetëm maqina e saj nuk punonte.

Valit iu bë një kotkë në grykë. Djersë të tjera e  
mbuluan. Shtrati iu duk i padurueshëm. Deshi të ngri-  
hej, të shkonte pranë maqinës së saj, t'i shkelte kop-  
sën e kyçit, të vinte në lëvizje ato boshte, që ishin  
ngurosur në vend. Po, po, të shkonte pranë maqinës  
së saj dhe t'i jepte jetë!

Por ku të vente në atë orë?! Si ish e mundur?  
Çfarë mund të thoshnin të tjerët? Si do t'u justifiko-  
hej ajo?

Jo, kjo gjë nuk bëhej!

Gjithë shtrati u ndez si flakë që e përcëlloi Valin  
tërë natën. Ndaj të gdhirë, e kapitur, humbi në gjumë.  
Por vetëm pakëz, ndonjë gjysmë ore. Pastaj u  
ngrit si e llahtarisor, pa agimin e ftohtë, që ish der-  
dhur në dhomë, hodhi me rrëmbim mbulesat dhe u  
ndodh në këmbë.


Thëllimi, në rrugë, sikur e fshikulloi, por edhe si-  
kur ja mbështolli gjithë trupin me freski. Qielli ish i  
kthjellët. Një cipë e hollë dhe e thatë dëbore mbulon-  
te tckën. Ndonjë njeri dukej aty-këtu. Ora sapo kish  
kaluar nga pesa.

Vali nxitoi, me duart futur në pallto, me çantën  
shkuar në krahun e majtë. Era me ngricë i lëmontë  
dhe i lëvizte pak flokët e zez. Ajo nxitonë, nxitonë,  
donte të arrinte sa më parë në fabrikë.

Hyri në korridorin e gjatë të fabrikës. Afshi i ka-  
loriferit, era e njohur, që vinte nga maqinat dhe re-  
partet e ndryshme, i krijuan një kënaqësi. Ajo e ndjeu  
veten në vendin e saj.

Një mekanik, që po kalonte në korridor, e për-  
shëndeti dhe i tha:

— Pse kaq herët, Vali? Ora nuk ka vaitur pesë  
e gjysmë.



— Ashtu? Do dhe gjysmë ore që të ndërrohet turni? Do ta kem orën përpëra — ja bëri Vali.

Me t'u afruar te dera e repartit, zhurma e maqinave, që dridhnin fillin, të vërtiturat e boshteve, u dëgjuan shkoqur. Ajo shtyu dorën dhe u ndodh nën dritën e llambave neon, në mes të rrahjeve të forta të punës, të jetës së përditshme.

Së pari, sytë i vajtén drejt maqinës së saj. E pa ashtu të heshtur; pastaj vuri re Zanën, që punonte në maqinën pranë me kokë të ulur.

Vali eci pér të takuar Gjergjin, mjeshterin e prodhimit, që ish edhe anëtar i komitetit profesional.

Duke kaluar afér Bardhyles, ajo i thirri:

— Vali, ku je?! Si e ke punën?

— Ashtu... — u përgjegj Vali me drojtje dhe iku tutje, pa e zgjatur.

Gjergjin e gjeti në zyrën e vogël të repartit. Ky e pa vajzën drejt në sy dhe i foli i pari:

— Mirë mëngjezi, Vali! Si je? Mos je gjë e sëmurë?

— ...Disi... — filloj të thotë vajza.

Tjetri i preu fjalën:

— Pse erdhe, atëhere?

Vali u duk më e vendosur.

— Dëgjo, shoku Gjergji, — tha. — Nuk pata năo-një gjë me rëndësi mbrëmë. Nuk e di se si u ndodha... Ishim në festën e ditëlindjes së një shoqeje... Një farë lodhjeje... Pastaj, të ftohit... nata... më bënë të plogët, më shtynë të marr një vendim jo të nder-shëm... Nënës i thashë se isha e sëmurë... Ajo do të vinte t'ju lajmëronte sot... Por këtë përçapje time të shtrembër nuk e durova dot! Erdha, shoku Gjergji, të punoj turnin e mëngjezit, të vë në vend atë që nuk e bëra mbrëmë.

Tjetri po e dëgjonte i menduar. Fytyra e tij dukej e qetë, por sytë diçka shprehnin.

I tha vajzës:

— Por, sonte, ti ke përsëri turnin e natës...

— E kam dhe do ta bëj.

— Do të punosh dy turne në një ditë?

— Po, do të punoj. Meqë Bukuria mungon këto ditë, një shoqe mund të punojë në maqinën e saj.

Gjergji po e kuptonte vajzën.

— Mirë — tha. — Bëj si ke menduar.

— Po filloj — vazhdoi Vali dhe u nis drejt maqinës së vet. Ajo veshi bluzën ngjyrëmavi, lidhi shaminë e bardhë në kokë dhe nisi nga puna.

Turni i natës mbaroi. Punëtoret e ditës erdhën dhe zunë nga puna.

Vali u përgjigjej shkurtimisht përshëndetjeve të tyre. Ajo i vinte rrrotull maqinës dhe kontrollonte boshitet një për një. Ato vërtiteshin, dhe në kokën e vajzës vërtitej një mendim: «Do të bëj më shumë se norma edhe tani, edhe sonte... Në mbledhjen e grupit profesional, do t'ua them të vërtetën...»

Neonet, në repart, ishin shuar. Nga dritat e mëdha, hynte drita e bardhë e ditës së re.

## ZHGËNJIMI

Sytë e saj ishin ngulur te skena dhe nuk lëviznin. Dukej sikur nuk merrte frymë. Një farë qetësie i kish mbuluar të gjitha tiparet dhe ja tregonte si të mpira. Por, prapëseprapë, kjo qetësi nuk e fshihte atë që i provonte zemra në atë çast. Vështrimi i saj si i përgjumur, dy buzët e kuqe pak të mbledhura, koka e anuar lehtë mbi supin e majtë dhe duart e mbërthyera fort me njëra-tjetrën tregonin se çdo fije e zemrës së saj ish e nderë.

Neta dukej sikur kish humbur e tëra në botën e asaj drame tronditëse, që po zhvillohej në skenë. Por nuk ish vetëm ajo në një gjendje të tillë. Në sallën prej gjashtëqind e ca vendesh, të mbushur plot, nuk ndihej as miza. Të gjithë sikur ishin të nemitur. Vëtëm si u mbyll sipari dhe si kaloi ndonjë minutë, shpërthyen duartrokite të forta e të paprera. Dritat nuk u ndezën menjëherë. Perdja u hap përsëri dhe aktorët u paraqitën këtë herë të radhitur e me kokë të ulur, duke falënderuar për duartrokite e nxehta.

Edhe kur u ndriçua salla dhe njerëzit filluan të dilnin për pushimin para aktit të fundit, Neta u ngrit më pas nga të gjithë. Atë e solli në vete zëri i shoqes së saj:

— Dalim pak...

\* \* \*

Neta Bitri ndodhej në Tiranë që prej dy ditësh. Kur e kishin lajmëruar të nisej pér në kryeqytet, se do të bënte pjesë në një ekip inxhinierësh, që do të shkonin në disa miniera të Shqipërisë pér të parë punën dhe pér të përfituar nga përvoja e tyre, ajo kish ndjerë një gëzim të madh. Kjo i kish rënë në sy edhe të shoqit, i cili i kish thënë me buzëqeshje:

— Aa! Sikur nuk më pëlqen të gëzohesh kaq shumë që do të largohesh nga shtëpia!...

Neta i qe hedhur atij në qafë dhe e kish qortuar:  
— I lig! Ç'janë këto fjalë! Do të t'i heq veshët!

Pastaj e kish puthur në faqe, në sy e në buzë.

Ajo po vente në Tiranë në një kohë tamam sikur ta kish kërkuar vetë. Sa herë i kish shkuar ndër mend një gjë e tillë! Madje kish menduar të kërkonte nga dy ditë leje pér të ikur, sa pér të parë shfaqjen e re të teatrit.

Pér këtë shfaqje po bëhej fjalë kudo që prej një javë. Drama trajtonte një temë me rëndësi dhe ish shkruar fuqishëm. Neta e kish lexuar dhe e njihte brendinë e saj. Por ajo që i kish nxitur më shumë këershërinë, ish vënja e mirë në skenë, siç thoshnin. Sidomos lavdërohej shumë aktori, që luante rolin kryesor. Flitej se ai qëndronte në lartësinë e pjesës. Disa që e kishin parë, shpreheshin kështu: «Të mahnit me interpretimin e tij!»

Neta ish e dhënë pas teatrit si ndonjë fëmijë pas lodrës që i pëlqen më shumë. Që në shkollën shtatëvjeçare, pastaj në gjimnaz e gjer në institut, ajo kish marrë pjesë në grupet teatrale dhe kish dalë kaq e kaq herë në skenë. Asaj i jepnin rolet më të rëndësishme. Dhe ajo dinte të luante me vërtetësi e plot ndjenjë. Të gjithë e çmonin pér këtë.

Kur ish në institut, ndonjë e trazonte.

— E ç'të duhet ty të bëhesh gjeologe? Ti ke një talent gjenial! Le këtu ndër ne, po ti mund të çuditësh

botën edhe jashtë! Ti je një Aleksandër Moisi i dytë, por me ndryshimin që je femër!

Ndonjë shoqe i thoshte me seriozitet:

— Ah, moj budallaçkë, të hanë brirët të shkosh e të futesh nëpër galeritë e minierave! Si gjeologe as që do të të zëri njeri për bishti. Por, si artiste, mund të bëhesh me të vërtetë e madhe.

Të dyja këto vërejtje Neta i priste me mospërfilleje. Ajo, ndonjëherë, nuk dyshonte se shoqja e saj mund të kish pakëz të drejtë, por kurrë nuk kish menduar ta bënte teatrin profesion. Sado që kish një zemër të butë, shpirti i saj nuk mund të kënaqej me një jetë që do të rrëthohej nga mure prej pëlhure. Ajo donte të luftonte me jetën, t'i punonte mendja ditë e natë për të zbuluar diçka, për t'i rrëmbyer natyrës të fshehtat dhe pasuritë. Këto dy veti, që duken të kundërtta me njëra-tjetrën, përbënин karakterin e saj.

Prandaj Neta kish vendosur të bëhej gjeologe.

Herë-herë, i pëlgente t'u përgjigjej të tjerëve:

— Miniera dhe teatri nuk janë larg njëra-tjetrës. Në teatër ke të bësh me zemrën tënde dhe të atyre që të shikojnë. Po dhe në minierë je... në zemër të natyrës, atje ku ruhen vlera shumë të mëdha. Pra, që të dy zanatet janë shumë të vështira por aq një-rezore!

Nga kjo filozofi e saj, të cilën ajo e shprehte si me të qeshur, të linte të nënkuptoje njëkohësisht një pohim disi të çuditshëm, por dhe të vërtetë. Kësh-tu ua mbyllte gojën të tjerëve dhe largohej lehtë-lehtë, duke murmuritur nëpër dhëmbë melodinë e një këngë.

Disa e quanin «gjinkallë», duke e krahasuar me vajzën e një filmi, që ish shfaqur kohët e fundit. Neta gjithmonë ish tërë gaz. Ajo nuk e prishte gjakun kurrë. Fjalët i kish në majë të gjuhës dhe ua pa-guante dhjetë për një atyre, që guxonin t'i binin në qafë.

Por ajo që i habitit të gjithë, ish lajmi se Neta kish rënë në dashuri me një student të institutit mjekësor. Sotir Bitrin e njihnin si një djale të qetë e të shtruar. Siç thoshnin, ai ndryshonte si nata me ditën nga gjeologja jonë e ardhshme. Si ish e mundur t'i hynin në zemër njëri-tjetrit? «S'ma merr mendja të përfundojë mirë kjo dashuri... E ku u puqen atyre karakteret!», ja bënин të tjerët poshtë e përpjetë.

Mirëpo nuk kish dalë ashtu. Ndonjë muaj përpara provimeve të fundit, Sotiri dhe Neta kishin bërrë celebrimin. Mjekun e ri e kishin emëruar në qytetir e tij të lindjes, prej nga ish edhe Neta. Të dy së bashku, ashtu të lumtur, ishin nisur një ditë korriku për në jug. Që atëherë kish kaluar gati një vit, por, gjer tanë nuk kish asnjë shenjë që mund të dyshoje se «a do t'u piqeshin karakteret».

\* \* \*

Shfaqja ish në të mbaruar. Neta ndjehej shumë e kënaqur. Aktorët i kishin lënë përshtypje të mira. Dhe mbi të gjithë, ajo çmonte atë që luante rolin kryesor. Kishin pasur shumë të drejtë ata që ja kishin lavdëruar. Dukej qartë aftësia e tij. Ai të mbërrthente e të bënte për vete. Harroje se ndodheshe në sallën e teatrit; të dukej sikur ishe përpara një ske-ne të vërtetë të jetës. Ai luante me shkathtësi e me lehtësi të madhe, në një mënyrë shumë të natyrshme. Ai dhe nja dy të tjerë mishëronin tipa të gjallë të një shoqërie. Subjekti i pjesës dilte në pah me tërë fuqinë e tij. Qëllimet e fshehta, dredhitë, lajkat, pastaj dhuna e shëmtuar, pasqyroheshin me hollësirat më të mprehta. Të gjitha këto të rritnin në shpirt urrojjen më të madhe për njerëzit pa cipë, që janë gati të kryejnë poshtërsitë më të ndyra për të plotësuar qëllimet vetjake, për të arritur lavdinë e pamerrituar.

Por, në mes të të gjithë këtyre, shkëlqente fytyra e heroit të pjesës. Sa i pastër që dilte ai! Asnjë grackë nuk e mashtonte dot.

Kur aktori theksoi fjalët, që shprehnin karakterin e tij të lartë, Neta, pa u përbajtur, duartrokiti fort, sa shumë veta në sallë kthyen kryet drejt saj.

Asaj i qe dukur se këtu qëndronte thelbi i pjesës. Mendimi i shkrimitarit ish spikatur me ngjyrat më të ndritshme. Ato fjalë e fisnikeronin jashtëzakonisht karakterin e heroit. Po, në këtë skenë, edhe zotësia e aktorit dallohej më shumë.

Netës iu kujtua një arësyetim i saj mbi aftësinë e aktorëve, për të cilën kish lexuar diçka në një libër. A është e mundur që në rol të mos bëjë pjesë edhe një thërrime nga zemra e aktorit? A mundet që ky të jetë krejt i shkëputur nga personazhi dhe të arrijë ta paraqitë këtë me gjallërinë e duhur? «Ai që luan duhet të shkrihet me heroin e dramës», mendonte Neta. Në skenë, nuk duhet të dallojmë dy njerëz: aktorin dhe personazhin. Kjo është e pamundur. Atje duhet të shikojmë jetën dhe fytyrat e njerëzve, që ka skalitur autori i veprës. Vetëm atëherë mund të themi se kemi të bëjmë me një aktor të madh, se ai ka mundur të luajë me mjeshtëri të plotë.

Të gjitha këto i buçisnin. Netës në kokë pas shfaqjes. Kur arritëm në shtëpinë e shoqes, ajo i tha asaj:

— Më pëlqeu shumë Petrit Lani...

— E vura re. Ti vetëm tek ai ishe përqëndruar.

— ...Mendoj se do të bëhet një artist me gjithë kuptimin e fjalës. Nuk i mungojnë cilësitë...

— Kështu duket. Është i ri, s'ka shumë kohë që ka ardhur nga shkolla e lartë e teatrit, por, të dy-tri herët që ka dalë në skenë gjer tanë, është dalluar mjaft.

Neta i dëgjoi këto shpjegime. Ajo ish mbështetur në kanapenë, që ndodhej pranë dritarës së dho-

mës dhe po vërtitte në duar një kone të vogël prej qelqi që e kish marrë nga tryesa. Një tugë e flokëve të saj të verdhë i kish shkarë mbi sy dhe i hieshonte fytyrën, që i dukej edhe më e bardhë në dritën e fortë të llambës elektrike.

Dukej sikur kish rënë në ëndërrime.

Por, pas pak, iu drejtua shoqes:

— Ti, Vjollcë, ndofta ke dëgjuar për të dhe e njeh Petritin edhe si njeri. Por unë, nuk di se si, në fund të shfaqjes, pata mbresën se në fytyrën e tij si Petrit aktor, e jo personazh, po shikoja të vizatuar gjithë tiparet fisnike, ashtu si na dilte edhe gjatë rolit.

Vjollca e vështroi Netën me bishtin e syrit dhe buzëqeshi, por nuk guxoi t'i thotë gjë.

Tjetra vazhdoi:

— Duhet të ketë një zemër të pastër e të fortë që dilte aq fuqishëm në rolin e tij. Ai nuk tërroqi vemendjen e të gjithëve? A s'më the dhe ti, tek po vinim në shtëpi, se me këtë pjesë ai ka fituar zemrën e të gjithëve edhe si Petrit?

Vjollca mbylli kanatin e dollapit, ku futi diçka dhe erdhi e u ul pranë shoqes së saj në kanape. Këto fjalë i zbulonin gjëra të rëndësishme.

— E kam me tërë mend — vijoi Neta, sé cilës i kish rënë në sy vështrimi kureshtar i shoqes. Petriti duhet të jetë njeri i mirë, i përzemërt dhe i drejtë, i zgjuar e jo dinak. Po... kështu duhet...

— E pse, vallë? Ç'gjë të siguron për këtë?

— Ç'gjë më siguron?! E sigurt... e sigurt... s'mund të jem... Jo. S'mund të flas me bindje, ta merr mendja. Por... mënyra e saktë me të cilën luannte rolin e një njeriu të ndershëm e të dëlirë më krijoj parafytyrimin se edhe në jetën e tij vetijake i tillë duhet të jetë. Pikëpamja ime mund të duket e çuditshme, por unë mendoj se ai që ka një zemër të pastër, e kupton më mirë dhe di ta paraqesë me vërtetësi edhe zemrën e pastër të një tjetri.

— A thua se kështu ndodh në teatër?

— Ndofta po, ndofta jo. Por më duket se pikë-pamja më e pranueshme është ajo që thotë se aktori luan më shumë në saje të ndjenjave të tij se sa të arësyetimeve. A mund të hidhet poshtë kjo? Kurre-sesi. Në qoftë se aktori nuk e ndjen karakterin, që do të japë, ai nuk mund ta pasqyrojë këtë plotësisht në skenë. Mund të na e nxjerrë me anën e fjalëve apo të veprimeve, që janë përcaktuar në dramë, por një karakter i tillë do të ish i ndërtuar vetëm sipas idesë së autorit të veprës, e jo i dalë me mish e kocka në skenë. Të gjithë shikojmë, të gjithë kup-tojmë e shikojmë se akëcili është i këtillë apo i atillë, por të gjithë nuk bëhem dot artistë vetëm me kaq dhe as që kemi fuqinë më të vogël që ta mishë-rojhmë atë në fytyrën tonë.

— Si shumë thellë na fute — tha Vjollca duke qeshur. — Ti më ngjan se s'paske hequr dorë nga librat mbi teatrin, megjithëse ke një vit e ca që je bërë gjeologe. Madje, paske filluar të na nxjerrësh edhe teori të tua.

Neta ja dha gazit, i hodhi krahun shoqes në qafë dhe shtrëngoi faqen mbi afë të Vjollcës.

— Ti e di që teatri më ka pëlqyer kurdoherë — shtoi ajo. S'kam për të hequr dorë kurrë prej tij. Ai më ushqen, i jep shpirtit tim fuqi të mëdha. Është një gjë aq e këndshme sa edhe e rëndësishme.

— S'jam kundra as unë — iu përgjegj Vjollca.

— Dhe as mund të të këshilloj të heqësh dorë. Përkundrazi, gjykimet e tua më gëzojnë shumë dhe më mësojnë gjëra që nuk i di.

— Mos u tall! — ja bëri Neta si e zemëruar. — Ndryshe s'do të të flas më.

— Jo, jo, vazhdo! — ndërhyri Vjollca. — E kam me gjithë mend. Folë, Netkë.

— T'i thashë të gjitha. S'kam më.

— Kam unë për të bërë një pyetje. A do të më përgjigjesh?

— Ah, ç'je ti! Ç'je ti! — i tundi kokën Neta. — Dhe ti s'ke hequr dorë nga ngacmimet e tua. Ke mbetur po ajo që ishje në institut: Vjollca ironike kokë e këmbë. Vetëm që je bërë më Vjollcë në të pamët. Je shëndoshur dhe je zbuluar më shumë. Sytë dhe vetullat e tua nuk besoj t'i ketë tjetërkush në Tiranë.

— Léri këto, po më shpjego edhe një herë. Në fillim the se Petriti duhet të ketë vetë një zemër të pastër, pa e ka luajtur aq mirë rolin e tij. Kështu?

— Po.

— Kjo të jetë?

— Një gjë e tillë ka të bëjë shumë, sipas mendimit tim. Po të jetë kështu, ai ja del më mirë rolit në krye, s'ka për të gjetur vështirësi. Luan në mënyrë të natyrshme, se gjithshka ja ndjen zemra lehtë.

— Atëherë, sipas mendimit tënd, edhe ata që luajnë rolin e njerëzve të ligj — të personazheve negative, siç i quajnë — duhet të jenë edhe vetë të tillë? Ë?

— Shtiesh sikur nuk kupton, apo kërkon të më trazosh akoma, nuk e di — tha Neta. — Sidoqoftë, kjo është një pyetje e rëndësishme që mund ta bënte kushdo. Prandaj do të të përgjigjem, dashke a s'dashke të më dëgjosh. Nuk jam e mendimit se personazhi negativ kërkon edhe një aktor negativ. Një gjë e tillë as mund të ndodhë. Është fare qesharake ta mendosh. Përkundrazi, e dashur Vjollcë, që t'ja dalë mbanë rolit të një tipi të keq, aktori i saktë duhet të ketë një zemër shumë të ndjeshme e shumë të mirë. Po, po! Ai që e urren të ligën, ka vullnet dhe fuqi të na e nxjerrë para syve me tërë shëmtimin e saj. Të paktën, do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për t'ja arritur. A mos, vallë, mund të ndahet detyra nga qëllimi?...

Vjollca po e dëgjonte shoqen e saj dhe dukej e menduar; por, ajo më shumë sodiste vështrimin e qetë e të dhirë të Netës, se sa mendonte për arësyetimet e saj. Ajo vinte re se kish pranë shoqen që e njihet dhe

e donte aq shumë. Ish gjithnjë po ajo Netë, që kish folur kurdoherë e me këdo me zemër të hapur, pa drojtje e pa dredhi. Mendimet e saj dukeshin shpeshtë çuditshme, por ato përmbanin, zakonisht, një të vërtetë të pamohueshme. Prandaj, edhe tani, Vjollca ndjehej e gëzuar dhe e kënaqur.

Ndenjën duke folur gjer pas mesit të natës. Biseda e tyre kaloi në gjëra të tjera, në miq e njerëz të njuhur, në punët e përditshme, në të rejat e modës.

## 2

Ditët filluan të rriddhnin me punë në minierat, ku duhej të shkonte ekipi në të cilin bënte pjesë Neta. Teknikët dhe inxhinierët hynin nëpër galeritë, takohen me shokët e tyre të punës, studjonin metodat e tyre, bënin mbledhje dhe shkëmbenin mendime.

Të gjitha këto Neta po i ndiqte me kujdes; sidomos ajo vërente vrullin me të cilin punonin njerëzit kudo, vullnetin dhe gjallërinë e tyre. Asaj i dukej se kudo po takohej me po ata njerëz, sikur ishin të njëjtët minatorë në të gjitha minierat. Ata përngjisnin me punëtorët e minierës, ku punonte vetë.

Neta ish plot gjësim. Jeta, çdo ditë, i përforconte bindjet e saj: sa të përzemërt e sa të mirë ishin njërit e thjeshtë! Ata punonin me vendosmëri, pa u loddur. Shembulli i tyre i jepte krahë, e përtërinte, i mbushte kraharorin me një frymë të pastër, që e bënte të ndjehej e lehtë, e gatshme pér t'u ndeshur me çdo vështirësi.

Një mbasdite, në minierën e qymyrgurit, ku ndodhej ekipi, erdhi një grup aktorësh nga kryeqyteti. Ata do të jepnin shfaqe pér punëtorët. Në programin e tyre kishin dy pjesë me nga një akt.

Autobusi i vogël qëndroi përpëra klubit të minierës. Që lart, u zbritën dekoret, të cilat u shpunë në skenë. Megafoni i qendrës së zërit filloj të lajmërojë se

shfaqja ish caktuar për në orën shtatë.

Lajmi u përhap shpejt e shpejt gjer thellë në galleritë. Neta e mori vesh tek ish me punë në një sektor kërkimi. Ky lajm asaj i pëlqeu dhe e bëri kureshtare.

Turni e la punën në orën gjashtë. Neta dolli nga miniera pak më vonë. Në sheshin para klubit, ajo pa një grumbull punëtorësh dhe nëpunësish. Duke kaluar pranë vitrinës së agitacionit, i zuri syri një afishe për shfaqjen teatrale. Lexoi titujt e pjesëve, pastaj vështrimi i shkau poshtë, ku ishin shënuar emrat e personazheve dhe të aktorëve. Sikur u çudit, kur pa atje emrin Petrit Lani. Si padashur, e lexoi edhe një herë dhe u bind se nuk ish gabuar.

Shkoi drejt grumbullit të njerëzve. Minatorët kishin rrethuar miqtë e ardhur nga kryeqyteti. Midis dy palëve po zhvillohej një bisedë mbi shfaqjen reth punës në minierë. Dikush nga punëtorët hidhte ndonjë shaka me të cilën qeshnin të gjithë.

Kur u afrua gjeologja, disa u hapën që ajo të dilte përpara. Një nga inxhinierët e ekipit u tha aktorëve, duke u treguar Netën:

— Kemi edhe midis nesh një njohëse të mirë të teatrit dhe një kritik me kompetencë.

Neta deshi t'ja kthente atij me një thumb të njëllojtë, por u përbajt, kur vështrimi i saj u kryqëzua me atë të Petrit Lanit, i cili po qëndronte dy hapa më tej. Sytë e zez të aktorit po e shikonin me kujdes. Fytyra e tij kish një çehrë pak të zbetë, por të këndshme. Mustaqet e tij të holla e në ngjyrë të errët, ash tu si flokët e tij të dredhur, i hijeshonin buzën e sipërme. Dora e tij e majtë kish mbetur gjysmë e ngri tur, dhe mbante të varur një zinxhir të hollë e të shkurtër, të lyer me ar.

Neta u përshtëndosh me miqtë. Në fund, ajo i dha dorën Petritit. Ky u përkul pakëz, uli kokën dhe tha lehtazi:

— Lani:..

Gruaja e re ndjeu dorën e saj të shtrëngohet në pëllëmbën e ngrohtë të aktorit.

Fjalët ishin prerë. Neta kish përshtypjen sikur të gjithë po prisnin të fliste ajo. Dhe menjëherë asaj ju zhduk ajo farë tronditjeje e fillimit. I lindi dëshira për të çelur një bisedë të gjallë rrëth shfaqjes dhe teatrit.

— Besoj se do të na kënaqni me shfaqjen tuaj — iu drejtua ajo aktorëve.

— Këtë e presim të na e thoni ju — në fund u përgjegj njëri prej tyre.

Neta vështroi me bishtin e syrit Petrit Lanin. Ky po buzëqeshte dhe po e shikonte me vërejtje. Ajo vijoi:

— Gati të gjithëve ju pashë në shfaqjen e fundit. Kain prej saj përshtypjet më të mira.

Pastaj, ajo shtoi, duke iu drejtuar Petritit:

— Më pëlqeu, veçanërisht, interpretimi juaj. Kini me të vërtetë talent...

Tjetri, si vërtiti një herë zinxhirin e vogël, ja ktheu si me mirënjobe:

— Falem nderit për koplimentin tuaj. Por kam frikë se mos më lavdëroni si tepër... — përfundoi, duke buzëqeshur gjithnjë, ndërsa bebet e syve i drithnin nga një shprehje e pakuptueshme.

Biseda mund të vazhdonte më, por ish afruar ora e shfaqjes dhe njerëzit po hynin në klub. Aktorët u drejtuan në prapaskenë.

Petriti mbeti më pas. Ai kish rol në pjesën e dytë. Hyri në sallë bashkë me Netën, duke e pyetur atë se prej nga ish, sa kohë kish që ndodhej në këtë minierë, ku i kish kryer studimet, ç'njérëz kish në familje... Ajo iu përgjegj të gjitha pyetjeve të tij me dashamirësi.

Në sallë, ai qëndroi në një karrigë pranë saj.

— Mund të ulem? — e pyeti, mbasi kish ndenjur.

— Do dhe një orë gjersa të më vijë radha. Kënaqem

shumë kur takoj njerëz të cilëve u pëlqen teatri dhe e kuptojnë.

Neta nuk kish asnjë kundërshtim. Përkundrazi, e gjente shumë të përshtatshëm rastin për tu njojur e për të këmbyer dy fjalë me njeriun, që i kish tërhequr vëmendjen dhe për të cilin kish shprehur aq mendime, duke folur me Vjollcën, atë natë pas sifaqjes. Pastaj, djaloshi po tregohej mjaft i sjellshëm dhe dukej të ish i zgjuar.

Ata kishin zënë vend në një nga radhët e mesit të sallës. Kjo ish e thjeshtë, e ndërtuar rishtas bashkë me klubin. Të binte menjëherë në sy perdja e kuge e skenës. Në muret, anash, vareshin disa parulla të shkruara në xham dhe fotografi të ndryshme.

Dëgjohej një zhurmë fjalësh që veshi nuk t'i kapte dot. Nga një kënd i sallës shkrepte ndonjë e qeshur. Dikush thërriste shokun të vente të ulej pranë tij.

Petriti zuri t'i fliste Netës për pjesën me një akt, që do të luhej. I tregoi brendinë, i tha edhe emrat e aktorëve, që kishin rol. Pastaj, shpjegoi pjesën tjetër, ku luante vetë.

Neta i tha se bënин shumë mirë që venin për të dhënë shfaqje në qendra pune. Ish e mendimit që të venin sa më dendur, se punëtorët e largët nuk kishin mundësi të shkonin shpesh në qytet. Afî i tha se atë vit, programi i tyre për të vajtur në bazë ish më i gjérë.

U fikën dritat. Neta e përqëndroi vëmendjen te skena. Trupin e kish zgjatur pak përpara. Flokët e saj të mbledhur linin të dallohej një qafë e gjatë dhe e bardhë si shkumë.

Petriti e vuri re me një vështrim të têrthortë dhe pëshpëriti:

— Do të rrini edhe shumë ditë në minierë?

Neta iu përgjegj shkurt:

— Jo. Mbarova këtu.

Pastaj, asnjeri nuk hapi gojë, por ndoqën shfaqjen gjer në fund, në heshtje, të mbështetur sup më sup.

— Më falni — i tha ai dhe u ngrit, kur u mbyll perdjë. — Kam radhën.

U largua me një buzëqeshje të zakonshme.

U takuan përsëri pas mbarimit të shfaqjes. Neta po bisedonte me një nga shokët e ekipit në do të kish vend në autobus që të zbrisnin edhe ata në qytet. Petriti ndërhyri menjëherë:

— Vend kemi edhe për tre-katër veta. Mund të vini!

— Sa mirë! — thirri Neta. — Unë duhej të kisha shkuar qëkuri. Më pret shoqja ime në shtëpi. Ajo është vetëm. Kushedi sa do të jetë shqetësuar që u vonusa!

Qëndruam të tre në shesh, gjersa të ngarkoheshin dekoret. Nata ish e kthjellët. Tutje dridheshin dritat e qytetit. Ato dukeshin si pasqyrimi i yjve mbi një ligen me sipërfaqe të rrudhur nga freskia e natës.

Netës i shkuan mornica në trup.

— Eëf! — ja bëri. Sa freskohet këtej, me tu ngrysur! Jemi në gusht; ditën ndjen vapë, kurse tanë të dridhet trupi! Kjo ndodh edhe brenda në qytet. Netët e Tiranës nuk i gjen asgjékundi. Sa të bukura që janë! Sa më pëlqejnë!

— Kushedi q'kujtime duhet të kini prej tyre... — ja ktheu Petriti, duke dashur ta ngacmojë.

— Po, kam kujtime të mira — pohoi ajo, pa u munduar që të dredhojë.

U nisën. Neta ish ulur në një ndenjëse pranë shokut të saj. Petriti kish zënë vend përpëra, i kthyer përgjysmë nga ajo. Maqina kish marrë të tatëpjetën me shpejtësi.

— U bëmë shkaktarë që të zbrisni vonë në qytet — ja filloi Petriti.

Neta qeshi.

— Është e vërtetë — tha ajo, — por jo kot...

— A! Për të tilla gjëra, për teatrin, Neta nuk mërzitet të rrijë edhe gjer në miengjes — ja bëri inxhi-

nieri. — Sa e zellshme është pas profesionit të saj, aq është e dhënë edhe pas teatrit.

— Pse, ty s'të pëlqen teatri? — iu drejtua gjeologja shokut të saj. — Nuk ja ndjen nevojën?

— Si jo! — tha tjetri. — Por...

— ... por je ca llafazan... — e ndërpree ajo.

Qeshën të tre. Qeshën me ta edhe aktorët e tjerë që ndodheshin pranë.

Pas kësaj ndërmjet të gjithave u ndez një bisedë rrëth teatrit dhe pjesëve që kishin në repertor. Neta zuri përsëri në gojë dramën e fundit dhe foli për fuqinë e subjektit dhe të interpretimit; ajo theksoi se sa shumë ndikon skena në edukimin e njerëzve.

— Ja se q'janë teatri dhe artisti — vijoi Neta, duke vështruar në sy shokun e saj. — Një aktor i shquar ka thënë: «Artisti e bind spektatorin me anën e fuqisë dhe të thellësisë së mendimit, ai tërheq vëmendjen dhe fiton nderimin e tij në saje të madhështisë së qëllimit që ndjek.» Pra, qëllimi i teatrit dhe i artistit është shumë më i lartë nga sa mund të pandehë ndokush, shoku Vangjel, — përfundoi ajo, duke iu drejtuar përsëri inxhinierit.

Kjo bisedë vazhdoi gjersa iu afroan lagjeve të para të qytetit. Në mbarim të saj, inxhinieri i tha Netës:

— Gjithë këtë leksion më duket se e mbajte enkas për mua. Falemnderit.

Autobusi qëndroi në sheshin kryesor të kryeqytetit. Kur filluan të zbresin nga maqina, ora e madhe po binte njëmbëdhjetë.

Shtëpia e Vjollcës ish në lagjen e re, të Tiranës. Vangjeli i kërkoi ndjesë Netës se nuk do të mund ta shoqëronte, mbasi do të shkonte gjer në Kombinatin e tekstilit, ku banonte vëllai i tij. Rasti ish i volitshëm, meqë autobusi e kish rrugën andej.

— Mos u shqetësoni — i tha Petriti. — E shoqëroj unë. Në lagjen e re, e kam shtëpinë dhe vetë.

Në qetësinë e natës, bulevardi kryesor kish një pamje edhe më madhështore. Dukej më i gjatë, më i gjerë e më i bukur. Kalimtarët ishin të rrallë.

Neta dhe Petriti ecën një copë herë në heshtje. Në krah të djathtë të tij, ajo po shkonte si e menduar. Koka e saj, e anuar pak në të majtë, nuk ja kalonte shumë supit të tij. Trupi i djaloshit ish i gjatë e dukej i lidhur nën puloverin me mëngë të përveshura, kurse fustani i saj veror tregonte një shtat të njomë me mes të hollë.

Kur arritën përpara parkut të rinisë, ai u mat që të kalonin përmes tij. Por Neta i tha:

— Andej, nga rruga gjatë Lanës...

Në kthesën e rrugës, në një qoshe të errët të parkut, në një bankë, ata vunë re dy veta, vajzë e djali, që rrinin pranë e pranë të pushtuar. Pastaj, fytyrat e dashnorëve u afruan edhe më shumë dhe mbetën të palëvizura në një puthje të gjatë.

Neta, padashur, qeshi me gjysmë zëri. Ai i pëshpëriti në vesh:

— Dashuria... Janë të lumtur...

— Ku dihet... — u përgjegj Neta, pa qenë as vetë fort e qartë se çfarë nënkuptojet me këto fjallë të saj.

— Patjetër! — theksoi ai. Dashuria të bën të lumtur. Dashuria është gjithshka. Pa dashuri, jeta s'ka asnë vlerë.

— Mendime interesante këto, dhe që fshehin diçka të vërtetë — tha Neta. — Ndonëse nuk jini ju i pari që po i shprehni. Janë thënë e stërhënë gjatë gjithë shekujve. Dhe sigurisht që do të thuhen akoma... Kjo s'prish punë. Por...

— Por çfarë?...

— ...Ndryshon brendia prej njërit brez te tjetri, domethënja e këtyre fjallëve.

— Domethënja e tyre është fare e thjeshtë dhe e kuptueshme — nxitoi të shpjegohet Petriti, — s'është nevoja t'u shtohet gjë më shumë. Ky është realiteti i plotë.

— Kurse mua nuk më duket një gjë aq e thjeshtë. Përkundrazi, është diçka shumë e koklavitur dhe e një-anshme. Prandaj njeriu duhet të jetë i kujdeshëm.

— Dashuria nuk të pyet. Një shok më ka folur për një proverb francez që thotë: «Zemra ka arësyet e saj, të cilat arësyjeja nuk i njeh.» Dhe dashuria është pjetëllë e zemrës e jo e trurit. Prandaj ajo hidhet në veprime shumë të guximshme, të cilat mendja nuk do t'i lejonte.

Neta nuk e përbajti dot gazin e saj dhe iu përgjegj Petritit:

— Ndofta kini të drejtë. Por me këto që thoni po më dilni një farë romantiku i vjetër, kurse në dramën, ku ju pashë, m'u dukët krejt ndryshe: një njeri realist...

— Ah, atje ashtu ish roli im! ..

Neta i ndali këmbët përpara një banese me tri kate.

— Arritëm — tha.

— Kaq afër e paskeni shtëpinë! — u habit Petriti.

— Kishim filluar një bisedë të rëndësishme... Sa keq që do të ndahemi kaq shpejt!

— Vërtet ish një bisedë e këndshme — pohoi grua-ja. — Por, shikoni lart — vazhdoi ajo, duke i treguar tjetrit një dritare të ndriçuar në katin e dytë. — Shoqja ime s'ka fjetur. Kushedi me sa shqetësim po më pret. S'dua ta mundoj më. Më falni. Natën e mirë!

— Mirë u pafshim — ja ktheu ai. — Thatë se do të qëndroni edhe disa ditë në Tiranë... Besoj të takohemi...

— Mendoj se po. Dëshiroj të shikoj shfaqjen e re që do të jepni në krye të javës tjetër.

Dhe Neta humbi në shkallët e errëta të banesës. Petriti mbeti te porta, me kokën pak të ngritur dhe me sytë gjysmë të mbyllur, duke dëgjuar të trokiturat e sandaleve të Netës, që po ngjitte me shkathtësi shkallët e gurta. Ai po mendonte:

— «Sa e bukur që është! Sa e lezetshme!»

Pastaj, mori rrugën në të majtë dhe u largua me duart në xhepet e pantallonave.

Vjollca, me të hapur derën, thirri:

— Oi! Ç'u bëre! Më shtire në merak! Unë e dija se do të vije herët.

Neta i zuri asaj tē dy duart dhe ja puthi.

— Më fal, Vjollckë! Jam fajtore. Ç't'i bësh mikrobit tim!..

I hodhi krahun shoqes së saj dhe shkuan e u ulën tē dyja në divan. Neta fillooi tē tregojë me gjallëri arësyen e vonesës. Në fund, i foli për Petritin.

— Di tē bisedojojë e tē sillet mirë. Ka kulturë teatralë. Dëgjova prej tij disa mendime tē mprehta. Mendoj se ka për tē pasur një tē ardhme tē shkëlqyer. Edhe si njeri nuk m'u duk hundëpërpjetë. Kjo ka shumë rëndësi për karrierën e tij. Vetëm mbi një temë tjetër nuk u pajtuan mendimet tona. Ai s'kish tē drejtë. Arësyetimet e tij ishin tepër vetjake.

Ajo vazhdoi, sikur tē fliste me vete:

— Ah, dashuria, dashuria!.. S'është një problem i rëndësishëm. Sa tē mira e tē këqia sjell ajo! Ç'trajtim tē ndryshëm gjen në zemrën e njërit e tē tjetrit!

Vjollca po e kundronte shoqen e saj me vetulla tē mbledhura. U hodh dhe e pyeti:

— Për ç'dashuri është fjala?!

— Për dashurinë në përgjithësi. Për këtë biseduam me Petritin. Por nuk u morëm vesh. Ai ngulmonte në pikëpamjet e tia, unë në tē miat. Them se ai gabohet, mirëpo kushedi!..

Vjollca nuk po merrte vesh gjë. Sytë e saj tē ndritshëm u mjegulluan nga një hije dyshimi. Mendja i shkoi diku larg, sikur donte tē hetonte përfytyrimin e turbullt, që u kriuja nga ato që po dëgjonte. Por, sa u mat tē hapte gojën. Neta brofi në këmbë.

— Hajde, Vjollcë, tē keqen! Më ka grirë uria! Të ka mbetur gjë? Çfarëdo që tē kesh! Edhe buka thate mjalte do tē më duket! Shpejt, veç, se nesër kam punë në Ministri që në pikë tē mëngjesit.

E hoqi Vjollcën për dore dhe shkuan në kuzhinë.

— Edhe unë s'kam ngrënë — tha kjo. — Të prita ty. Hajde, tē preqatitim diçka tē çastit.

Dhe i hynë punës tē dyja për darkën e tyre.

Mbledhja në Ministri do të fillonte në orën shtatë e gjysmë. Qëllimi i saj ish të shqyrtoheshin përfundimet e punës dhe vërejtjet që kish ekipi i inxhinierëve dhe gjeologëve. Pas kësaj, do të nxirreshin detyrat.

Kur i doli gjumi Netës, rrezet e diellit kishin hyrë në dhomën e saj dhe po luanin te muri në krye të kre vatit. Ajo flak çarçafin dhe u ndodh poshtë shtratit. Vrapoi në pjesën matanë, puthi në faqe Vjollcën, që po pregetitë mëngjesin dhe shkoi u hodhi syve dy grushte ujë të freskët. Pastaj, u vesh shpejt e shpejt, gëlltiti me një frymë filxhanin me qumësht dhe i tha shoqes së saj:

— Ika, Vjollcë, se më vajti ora! Ti je më nge këta muaj, gjersa të hapen shkollat. Kurse unë, shiko si duhet të nxitoj!... Ditën e mirë. Hë, se mos të të shtie prapë në merak se kush e di kur na mbaron mbledhja, prandaj ti ha bukë, po të të marrë uria. Unë mund ta ha drekën në restorant.

Ajo iku duke hequr derën me fuqi.

Rugës iu kujtua se duhej të therriste në telefon Sotirin. U kthyte në postë dhe shkroi menjëherë lajm thirrjen. I tha nëpunëses të shënonte orën 18, duke menduar se gjer atëhere ajo duhej të ish e lirë nga çdo punë. Nëpunësja mori fletëthirrjen, shënoi orën dhe datën 19 gusht 1958.

Kur arriti në Ministri, mbledhja ish gati në të filluar.

— Megjithatë — i thanë — u tregove e përpiktë.

\* \* \*

Tërë mëngjesin e asaj dite, Petrit Lani qe në teatër. Kishin provat e përgjithshme të pjesës së re. Ai kish vajtur me kohë, ish veshur dhe kish bërë maki jazhin. Por, nja dy aktorë erdhën me vonesë. Petriti iu drejtua atyre me rrëmbim:

— Ç'u bëtë! Kështu e respektoni orarin?

Njëri syresh nuk foli, por tjetri ja priti:

— Që kur qenke bërë kaq i rregullt ti?! Na kërkoke edhe hesap, pale!...

Petriti deshi ta mprehte me të, por e mbajti veten se tjetri hyri në kabinën e tij dhe shtyu derën.

Pjesa ish e gjatë, me pesë akte. Në aktin e tretë, provat u ndërprenë nga ndérhyrja e regjizorit, një burrë i shkurtër e i trashë. Ai dukej i pakënaqur dhe gjakprishur. Hipi në skenë që t'u jepte aktorëve udhëzimet.

Kjo ndërprerje nuk i pëlqeu Petritit. Ai shikoi orën e dorës: ish njëmbëdhjetë e gjysmë. I erdhi inat dhe deshi t'i thoshte regjizorit: «Jemi në provat e përgjithshme. Mos na pengoni. Në fund, bëni vërejtjet tuaja».

Por regjizori nuk i la kohë të hapte gojë. Filloi me njëherë të theksonte dobësitetë që i kishin rënë në sy.

Petriti ish i shqetësuar. Në dy aktet e fundit të pjesës, nuk e përqëndronte dot veten mirë. Gjatë pushimeve, ai vozitte poshtë e përpjetë në prapaskenë, ndizte e shuanë cigaren, vështronë dendur orën që i dukej sikur po ikte me vrap ndërsa provat s'kishin të mbaruar. Foli me një shok të tij, duke shfryrë tërë dufin kundër regjizorit:

— Njeri i çuditshëm! Do të hidhet përpjetë për gjënë më të vogël! Biçim më vete!...

Provat e kësaj shfaqjeje sikur ja hëngrën shpirtin. Minutat iu dukën muaj.

Kur u myll perdja për të fundit herë, Petriti pa përsëri orën. Agrepet e saj tregonin dy pa një çerek.

— Bobo! — ja bëri dhe rendi që të ndërrrohet. Shokët e tij u habitën, kur e panë që këceu ashtu dhe u zhduk në çast. Njëri tha:

— Ç'pati ky! Sikur i hyri zekthi!

Petriti fshiu shpejt e shpejt makijazhin, nga i cili i mbeti ndonjë njollë e kuqe në fytyrë, shtrëngoi rripin e pantallonave dhe doli jashtë, duke veshur xhaketën në të ikur e sipër.

Ai mori rrugën me linkth. Në orën dy pa tri mi-

nuta, u ndodh përpëra Ministrisë së industrisë e të minierave.

Me gjysmë fryme, pyeti portierin në ish atje gjeologja Neta Bitri. Tjetri ngriti supet dhe i dha të kuptonte se nuk e njihte fare këtë emër.

Petriti mbeti si i hutuar. Nuk dinte ç'të bënte. Zuri të mendohej. Iu kujtua një inxhinier, që punonte në atë Ministri, me të cilin ai ish njojur dikur. Deshi t'i shkonte në zyrë për ta pyetur. Mirëpo edhe nga kjo nuk doli gjë: portieri i shpjegoi se inxhinieri kish shkuar me leje.

Në atë çast, u dëgjua një zhurmë nëpër shkallë. Nëpunësit po dilnin nga zyrat.

Petrinit sikur iu ngjall një shpresë. Qëndroi pranë xhamillëkut të portierit dhe çakariti sytë, që të mos i shpëtonte ajo që kërkonte.

Dy nga dy e tre nga tre, burra, gra, njerëz të rinj e moshëtyer, po zbrisnin duke biseduar ose duke qeshur. Disa syresh i hidhniq ndonjë vështrim të kotë Petritit dhe largoheshin me një farë mospërfilljeje.

Neta nuk po dukej. Shumica e nëpunësve kish dalë. Pak veta kishin mbetur në fund. Petritit i shkoi nëpër mend të pyeste ndonjërin prej tyre mos kish dijeni pér Netën. Ndali dy tre veta. Por asnjeri nuk ish në gjendje t'i jepte ndonjë sqarim. Prapa të tjerëve, erdhi një burrë me mustaqe e vetulla të dendura e të zeza. Ai kish dëgjuar se ç'kërkonte djaloshi dhe i tha:

— Shoqja Bitri është në mbledhje. S'kanë mbaruar.

Petriti falenderoi dhe mori frymë thellë. Ndezi një cigare, doli jashtë dhe qëndroi të priste përpëra Ministrisë.

Kaluan minutat njëra pas tjetrës, pesë, dhjetë, pësëmbëdhjetë. Ai e mbaroi cigaren dhe e shkeli me këmbë. Nxori zinxhirin e vogël të lyer me ar dhe filloj ta vërvitë me gisht, duke vërvshëllyer njëkohësisht melodinë e një këngë.

Por Neta nuk dukej të dilte.

Petriti shkoi përsëri te portieri dhe zuri të bisedojë e ta pyesë atë për shumë gjëra të ndryshme e të kota.

Ora e qytetit ra dy e gjysmë, pastaj tre e, më në fund, tre e gjysmë. Tingujt e orës sikur po e qëllonin Petritin në kokë si një çekan. Ish mërzitur dhe zemëruar pa masë. Ç'bëhej kështu! Si nuk po mbaronte ajo dreq mbledhje! Që kur kish filluar, e sa do të mbante?

Ai kish vendosur të mos largohej që andej gjersa të dilte Neta, por, ja, ora po vente katër, dhe atij i duhej të shkonte në mbledhjen, ku do të bëhej kritika e provës së përgjithshme të pjesës së re. Nuk ish e mundur të mungonte. Djall o punë!

Nxori stilografin dhe një copë letër. Mbas u mendua pakëz, filloi të shkruajë. I lutej gjeologes që, po të kish kohë të lirë dhe kënaqësi, të takoheshin në orën shtatë në sheshin «Skënderbej» dhe të venin për të parë një film të ri. E palosi letrën dhe ja la portierit.

— Kur të dalin — i tha — ja jep shoqes Neta Bitri.

Pas kësaj, ai u drejtua në ëmbëltoren e afërt që të hante gjë, para se të shkonte në mbledhje.

Po të kish qëndruar edhe disa minuta, do ta takonte Netën. Kjo mori letrën nga portieri, e lexoi dhe mendoi: «Mirë do të ish të venim në kinema sonte, po ç'ë do! Pikërisht në orën shtatë vazhdon mbledhja jonë.»

Qeshi nën buzë dhe shtoi me vete:

«Sot jemi bërë burokratë. S'ke ç'i bën!»

Mbledhja e filluar më shtatë e gjysmë të mëngjesit, nuk kish vazhduar më shumë se gjysmë ore. Ajo ish pezulluar dhe kish rifilluar në dymbëdhjetë. Mbeteshin disa gjëra të vogla për të cilat duhej bërë një takim prej ndonjë ore.

Neta nuk dinte nga t'ja mbante. Në atë kohë të vonë të mbasditës, uria i ish thyer, lëre, pastaj, që as mund të gjente ndonjë restorant të hapur.

Vendosi të blente ca fiq e ca pjeshka në dyqanin e

lagjes dhe të vente te Vjollca. Kjo duhej të ish në shtëpi. Ndofta dhe e kish pritur për drekë.

Vjollcën e gjeti brenda dhe ndenji me të gjersa afroi koha për të shkuar në postë e për të biseduar me Sotirin në telefon.

Dolën të dyja. Të zëna për krahu e përshkruan rrugën duke folur gjëra të rastit. Neta ja kalonte pakëz në gjatës: Vjollcës. Por kjo vinte më e plotë, me llërë e pulpë të rrumbullakta. Rrugës, ndonjë udhëtar kthehej i shikonte, i tërhequr, siç duket, prej bukurisë së ndryshme që kish secila nga këto femra, njëra flokëverdhë e tjetra zeshkane.

Posta ish plot me njerëz. Disa ishin ulur në frona, të tjerë, të mbështetur pas murit, një grumbull ish mble-dhur në dritaren, ku dorëzoheshin dëftesat e lajmthirrjeve. Herë-herë, hapej megafoni dhe dëgjohej zëri i në-punëses K... me Gjirokastrën, A... me Shkodrën ... S.... me Peshkopinë...

Neta ndjente një farë padurimi dhe një kënaqësi se do të fliste me të shoqin. Ish e dyta herë që po e thërriste atë në telefon, që kur kish ardhur në Tiranë, aty e dy javë. Mirëpo kishin kaluar mbi dhjetë ditë që radhën e parë, dhe kjo i dukej asaj një kohë shumë e gjatë.

— Kushedi ç'do të punojë Sotiri, do të më hedhë ndonjë thumb... i tha ajo Vjollcës.

— Oj, mos kini vallë ndonjë shekull pa biseduar?

— ja bëri Vjollca. — Ti i dérgove dhe një telegram. Nga ta kérkoje në telefon, nga miniera?

— Kur të marrë vesh se do të rri edhe dy ditë për të parë shfaqjen, s'ka për t'i ardhur mirë.

Në atë çast, u hap megafoni përsëri dhe Neta dëgjoi emrin e saj. Ajo vrapi drejt kabinës së telefonit.

Që nga ditarja e nëpunëses, Vjollca po e shikonte shoqen e saj tek po bisedonte në kabinën përballë. Ajo kish një pamje të çelur, dukej se fliste me gjallëri dhe bënte lëvizje me njëren dorë. Njëherë, ja dha një të qeshure të madhe, e cila vazhdoi gjer në fund të bisedës.

Kishin kaluar tri minuta, dhe nëpunësja që kish linjnë e telefonit e lajmëroi disa herë Netën që të lar gohej. Por kjo nuk po ndahej. Më në fund, tjetra ja preu lidhjen dhe i foli Netës me zemërim, kur kjo doli nga kabina.

Vjollca i tha shoqes së saj:

— Shumë e zgjatët. Ju sikur jini fejuar rishtas! C'thoshte Sotiri?

— Më priti me këmbët e para kur i tregova se kam marrë një dy ditë leje për të parë shfaqjen. Më tha se do të hakmerret kundër meje... — dhe Neta qeshi përsëri me gjithë zemër.

Dolën në bulevard që të bënin një shëtitje gjersatë vente ora shtatë. Koha ish e vrenjtur. Tërë atë ditë re të errëta ishin davaritur në qzell. Tani, ato ishin dendësuar dhe kishin mbërritur mbi qytet. Thellë nga veriu, vinin ca bubullima.

Përshkuan bulevardin «20 Nëntori», pastaj rrugën e «Barikadave», morën poshtë rrugës së «Dibrës» dhe hynë në «Mapo». U vërtitin këtu një copëherë, duke vështruar vitrinat, duke pyetur për stofat dhe këpucët.

Neta deshi të blente dicka për të shoqin. Ajo zgjodhi një kravatë dhe një palë çorape.

Kur u ndodhën përsëri në rrugë, pika të mëdha shiu kishin filluar të binin aty-këtu. Neta pa orën e dorës. Ish shtatë pa dhjetë.

— Nxitojmë — i tha ajo Vjollcës. — M'u afrua ora e mbledhjes; po është rrezik të na zërë dhe ndonjë rreshbesh i mirë.

Shpejtuan hapat dhe u ndanë në qoshen e fundit. Por Neta nuk kish bërë shumë rrugë, kur përpara saj doli Petrit Lani.

— Mirë mbrëma — ja bëri ai. — Po shkoni për në vendin e takimit?

— Jo — tha Neta. Do të vija me gjithë qejf, por kam mbledhje në Ministri, pikërisht tani më shtatë. Atje po shkoj.

— Ç'është kështu! — tha me keqardhje Petriti.

Tërë ditën, sot, u mbyllët në mbledhje! Unë apo bleva biletat për në kinema — dhe i tregoi Netës dy copë letra që po i mbante në dorë.

— Më vjen keq, po s'ke ç'i bën. Kështu më ngjau sot...

— Po do të vonoheni shumë? — pyeti ai.

— Një orë, ndofta më shumë...

Petriti shtrëngoi grushtin në të cilin kish biletat. Neta i tha:

— Më falni, duhej të shpejtoj. Tunjatjeta.

Tjetri mezi murmuriti diçka nëpër dhëmbë, qëndroi në vend i menduar, pastaj shtrëngoi më fort grushtin dhe hodhi në tokë biletat e kruspullosura.

\* \* \*

Shiu i rrëmbyer shpërtheu menjëherë. Sumbullat e mëdha binin me zhurmë mbi asfalt dhe shpérndanin spërka në të gjitha anët. Njerëzit u futën në dyqane dhe nën strehë. Por ajri ish gjithnjë i ngrohtë dhe lagështia e tij sikur t'i ngjitte rrrobat pas mishit.

Këtë ndjeu edhe Neta, kur u ndodh në rrugë, pas mbarimit të mbledhjes. Ish ngrysur fare. Shiu apo kish pushuar, prandaj jashtë nuk të zinte syri shumë veta. Qielli, i rënduar nga retë, paralajmëronte shtërgatë. Diku larg, shkrepëtinte.

Vetëvetiu, dhe për të dalë më shkurt në shtëpinë e shoqes së saj, Neta mori drejtimin nëpër lulishten e qytetit. Në atë çast, nga qoshja e ndërtësës së Ministrisë, rrëshqiti një hije njeriu, që e ndoqi Netën pas. Për disa metra eci në gjurmat e gruas, por, më tej, bëri në anën e poshtme të lulishtes, kapërceu pezulin e saj, që ish rrethuar me gjelbërime dhe humbi nëpër udhëzat e errëta.

Neta po shkonte kokëlur. Ajo nuk vuri re njeriun që, në një kënd të ndriçuar të lulishtes, i preu rrugën dhe i foli:

— Tani mbaruat?

Disi e trembur nga ky zë i papritur, Neta mbajti këmbët dhe ngriti kryet. Por e mblodhi veten shpejt.

— Ju qenkeni! — tha me habi, duke njojur Petritin. Më kallët frikën!

Tjetri qeshi dhe shtoi:

— Më falni. Nuk desha...

— Ku veni kështu?

— Ja... këtej... për tek ju...

— Për tek unë?

— Si të them!.. Desha t'ju takoja... Por, jo, ndodhi rastësisht...

Neta mendoi ta ngacmojë pak:

— Mos kini ndërmend të vemi në këtë orë në kinema?

— Jo, tani është vonë. Po...

— Po çfarë? — e pyeti ajo.

— Desha t'ju them diçka...

Neta po vështronë me kujdes fytyrën e Petritit, që ish ndriçuar përgjysmë nga llamba elektrike, nën të cilën kishin qendruar. Pamja e kësaj fytyre e shtiu atë në dyshime.

— Neta!.. — filloj të belbëzojë Petriti dhe bëri një hap drejt saj.

Gruaja nuk lëvizi nga vendi, por i nguli edhe më shumë sytë.

— Neta! — vazhdoi ai. Ju dashuroj marrëzisht! Jam bërë robi juaj!

Neta nuk e përbajti dot një buzëqeshje të lehtë dhe filloj të ecë.

— Qëndroni! — i thirri ai.

Pa u ndalur, ajo i tha:

— Më çuditni fort! Nuk e prisja një gjë të tillë!.. Ju dashuroj! ju dashuroj! — ngulmoi Petriti si me ankth, duke baritur në krah të Netës.

— A jeni i bindur për këto që thoni? — pyeti gruaja.

— Singerisht, ju them!

— Çudi! Po juva përsëris: nuk mund ta besoj...



S'duhet të jetë e vërtetë. Ju i dini pikëpamjet e mia mbi dashurinë. Jua thashë mbrëmë. . .

— Zemra ime rreh vetëm për ju!

— ... Dashuria nuk është diçka e thjeshtë — vazhdoi Neta, sikur të fliste me veten e saj. — Ajo nuk duhet të ndizet e të shuhet si një flakë kashte.

Kishin arritur në një pjesë fare të errët të lulishtes; pak më tej, dukej rruga që shpinte në lagjen e re të qytetit.

Petriti, që kish mbetur si i nemitur, e vuri re këtë. Ai nuk hapi gojë, por hodhi krahun e djathtë dhe e pushtoi Netën për shpatullash. E tërhoqi ca që ta afronte në kraharorin e tij.

Gruaja bëri që të shqitej dhe klithi:

— C'janë këto! Lëshomëni!

Por Petriti po e mbante të shtrënguar dhe po afronte buzët e tij në të sajat. Neta u përpëlit një herë dhe i vuri dorën mbi kraharor që ta largonte. Ai po anohej mbi të gjithnjë e më shumë. Atëherë gruaja përmblodhi fuqitë e saj dhe i vëzhitit një shuplakë në fytyrë me pëllëmbën e majtë. Petriti sikur u hutua. Neta i uli krahet dhe u shkëput prej tij.

Pastaj, iu kthyte me inat:

— Këtë quani dashuri!

— Ju... — deshi të fliste ai.

— E di ç'mund të thoni! — ja preu Neta. — Më dashuruat! Që kur kështu?! Brenda një dite? Dhe dashurinë tuaj e shprehët menjëherë në këtë mënyrë! Ju e mia? Jo, kjo nuk është dashuri, por... — t'jua them shkoqur — një shpërthim i epsheve tuaj!

Heshti ca, pastaj vazhdoi më e qetë:

— Një tjetër njeri kam përpara meje sonte. Ndryshe ju përfytyroja, nga sa ju pashë në skenë. Por atje paskeni qenë vetëm në rol, kurse në jetë luani ndryshe... Sa keq! Nuk pandehja që ti përgënjeshtronit në këtë mënyrë përshtypjet e mia të mira. Lamtumi!

Neta doli nga lulishtja, duke rendur lehtazi dhe mori poshtë për në shtëpi.

\* \* \*

— ... ja, kjo më ndodhi — mbaroi rrëfimin e saj Neta.

Ajo heshti. Vjollca dhe i shoqi, Minushi, që ishte kthyer nga shërbimi e po rrinin së bashku rrëth tryezës, mbetën dhe ata pa folur. Që të tre dukeshin të rënë në mendime. Kjo mbajti disa minuta. Pastaj, Vjollca zuri të thotë me zë të ulët:

— Kam faj edhe unë në këtë mes, Netë. Duhej të ta kisha bërë të njohur atë që natën e parë, pas shfaqjes. Ai ka lënë një grua... Këtë duhej ta kisha treguar. Por, në ato pak raste që biseduam bashkë, humba pas fjalëve dhe më doli nga mendja. Madje, mendova se mos... .

Neta qeshi dhe tha:

— Të kuptoj se ku e ke fjalën. Edhe mua më shkoi ndër mend se ti mund të mendoje që unë, ndofta, isha dashuruar pas tij. Dëgjon, Minush?

Minushi e vështroi Netën drejt me sytë e tij të medhenj:

— Nga Vjollca mora vesh disa pikëpamje të tuat mbi ato që duhet të karakterizojnë aktorin e mirë. C'mendon tashti, pas këtyre që ngjajnë? A duhet të jetë ashtu?

— Nuk di, nuk di — nxitoi t'i përgjigjet Neta. — Por unë tashti kam arritur në këtë përfundim: aktori nuk mund ta edukojë publikun vetëm me rolin që i jepet të luajë në skenën e teatrit. Ai mund ta edukojë atë dhe të fitojë besimin e dashurinë e tij edhe me rolin që luan në skenën e jetës.

Neta u ngrit.

— Më falni — tha — dua të rregulloj plaçkat e të bie. Nesër do të nisem.

— Po sikur do të rrije edhe dy ditë për shfaqjen? — e pyeti atë Minushi.

— Jo, jo, do të shkoj. M'u ndërrua mendja.

— Mirëpo ti s'ke prerë biletë pér autobusin... — i tha Vjollca.

— S'ka gjë. Do të gjej në Elbasan. Nuk rri dot!

... Të nesërmen, Vjollca e përçolli shoqen e saj në stacionin e trenit. Ndenji me të në vagon, duke bise-duar, gjersa u dëgjua fyelli i parë i lokomotivës. Pastaj, zbriti dhe qëndroi poshtë. Treni u nis ngadalë. Neta kish dalë në dritare dhe po e përshëndette Vjollcën, duke tundur dorën. Ndërsa tjetra po mendonte:

«Sa e çuditshme që më duket! Ka mbetur po ajo që ka qenë në institut: me një zemër të madhe e të ku-lluar...»

## **PASQYRA E LËNDËS**

Letër që përtej detit .....	3
Drejt qafës së malit .....	19
Prapa kafazeve .....	43
Brumi i zjarrtë .....	95
Vajza me shenjë në faqe .....	107
Kur zbardhi dita përsëri .....	120
Zhgënjimi. ....	128